

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Europiane dhe të sigurisë - 18

ÇËSHTJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË

EUROPEAN AND SECURITY AFFAIRS

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi botues:**Kryetar:**

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Anëtarë të Bordit, Rrjeti i Menaxhimit të Sigurisë:

Arian Dyrmishi, MA

Agron Sojati, MA

Gjergji Vurmo, MA

Mariola Qesaraku, MA

Besnik Baka, MA

Elona Dhëmbo, Kandidate për Dr

Edlira Peço, Kandidate për Dr

Besar Likmeta

Genc Kojdheli, MA

Eurona Leka, MA

Geron Kamberi, MA

Konsulentë:

Artan Karini – Kandidat për Dr., Universiteti i Manchester (UK)

Arshi Cela, Dr

Redaktor përgjegjës:

Elira Hroni – MA

Ndihmuan në përgatitje:

Besiana Kuçi

Egest Gjokutaj

Marsida Bandilli

Denisa Kamberi

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s** dhe **Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI Think tank Fund**

PËRMBAJTJA

Ilir Kalemaj

Sa larg është Shqipëria në përmbushjen e parametrave mjedisorë të specifikuar nga acquis mjedisore dhe konventat ndërkombëtare në fushën e mjedisit? 7

Eranda Gjomema

Sigurimi i energjisë dhe ruajtja e mjedisit: dy anët e së njëjtës medalje? 23

Alexandra Nastase

Roli i Një Shoqërie Civile të Organizuar në Trajtimin e Sigurisë Mjedisore 31

Alizadeh, E. dhe Pishgahi, Fard, Z.

Pozicionimi i Rrezeve Mjedisore në Krijimin e Modeleve të Ndryshme të Integritit Rajonal 45

R. Daniel Kelemen dhe David Vogel

Tregtimi i vendeve: Roli i Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian në Politikën Ndërkombëtare të Mjedisit 57

Rita Floyd

Debati për sigurinë mjedisore dhe rëndësia e tij për ndryshimet klimaterike 80

Abstracts 100

Ilir Kalemaj

SA LARG ËSHTË SHQIPËRIA NË PËRMBUSHJEN E PARAMETRAVE MJEDISORË TË SPECIFIKUAR NGA ACQUIS MJEDISORE DHE KONVENTAT NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MJEDISIT?

Hyrje

Gjendja e mjedisit dhe prirjet aktuale shfaqin një pengesë reale për anëtarësimin e Shqipërisë në BE në të ardhmen. Hyrja e Bullgarisë dhe Rumanisë në BE dhe problemet me të cilat u ballafaquan ato, me gjendjen e tyre mjedisore përpara dhe pas hyrjes, tregojnë një tendencë të krahasueshme edhe për Shqipërinë, për shkak të ngjashmërisë së problemeve dhe sfondit kulturor të shteteve që përmendëm më sipër. Procesi i minimizimit të degradimit të mjedisit të shkaktuar nga regjimi komunist dhe periudha e tranzicionit, sollën kosto të larta dhe të rënda të cilat u shfaqën edhe pas hyrjes së dy vendeve në BE. Sfida nuk konsistonte vetëm në përfshirjen e direktivave, rregulloreve dhe vendimeve të BE në legjislacionin kombëtar, por ishte në zbatimin tejet të kushtueshëm të këtyre ligjeve.

Shqipëria ka pasur një histori të ngjashme në situatën mjedisore. Ajo ka pika të nxehta të ndotura të shpërndara në mbarë vendin-një trashëgimi e regjimit komunist 45 vjeçar, nëpërmjet zhvillimit të industrisë së rëndë ndotëse e cila nuk i kushtoi vëmendje mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit. Një studim i kryer në Shqipëri nga UNDP, në Maj të vitit 2010, vuri në pah që ekzistojnë ende nëntë pika të nxehta në të gjithë Shqipërinë, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme.¹ Përveç dëmtimit të mjedisit të shkaktuar gjatë periudhës së komunizmit, mjedisi në Shqipëri ka vuajtur rëndë edhe gjatë 20 viteve të fundit, me një tendencë për degradim të mëtejshëm dhe me disa fusha mjedisore në përkeqësim të konsiderueshëm. Ndërkohë

¹ UNDP Albania, *Vlerësimi i nëntë pikave prioritare në Shqipëri dhe përgatitja e planit të veprimit të rehabilitimit*: <http://www.undp.org/al/index.php?page=detail&id=138>

që Shqipëria ka aplikuar për anëtarësim dhe synon të jetë anëtare e BE-së në të ardhmen e afërt, ajo është duke mbetur prapa me kriteret mjedisore të cilat mund të jenë një barrierë serioze dhe e kushtueshme për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit në të ardhmen.

Përshtatshmëria e korpusit ligjor mjedisor shqiptar me acqui communautaire, është një proces fundamental dhe integral i procesit të anëtarësimit të Shqipërisë dhe i duhet kushtuar vëmendja e duhur. Thelbi i këtij punimi është të trajtojë problematikën mjedisore në vend, të përshkruajë procesin e inkorporimit të acqui mjedisore dhe të nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse në lidhje me këtë.

E drejta mjedisore shqiptare

Vendi ynë ka tashmë një kuadër ligjor të plotë për mbrojtjen e mjedisit në tërësi dhe të komponentëve të tij përbërës, i cili përbëhet nga akti ligjor më i lartë, që është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi Penal, Ligje të Parlamentit, vendime të Këshillit të Ministrave, Urdhra, Udhëzime, Rregullore, si dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare dy apo shumëpalëshe në të cilat Shqipëria ka aderuar apo i ka nënshkruar.

Përsa i përket ligjeve, në fushën e mjedisit ato janë të shumtë. Këto ligje mbrojnë mjedisin në tërësi dhe pjesë të veçanta përbërëse të tij.

Me gjithë këtë gamë të gjerë ligjesh të mbrojtjes së mjedisit ky legjislacion vazhdon të jetë në një proces aktiv plotësimesh dhe përmirësimesh. Në strategjinë e mjedisit të miratuar nga Qeveria Shqiptare dhe në Planin Kombëtar të veprimit për zbatimin e saj, plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit mjedisor është identifikuar si prioritet i rëndësishëm. Për zbatimin e tij punohet vazhdimisht dhe hartimi i draftligjeve dhe i akteve nënligjore është kthyer në një proces aktiv.

Edhe për të ardhmen plotësimi i përmirësimit të legjislacionit mjedisor do të vazhdojë të mbetet proces prioritar me objektiva e synime të identifikuar. Konceptimi dhe hartimi i çdo akti normativ realizohet duke u përpjekur të përballojë me nivel bashkëkohor:

- problemet dhe nevojat që ngre praktika shqiptare për mbrojtjen e mjedisit;
- të jetë në akord me ritmet e zhvillimit të shoqërisë;
- t'i hapi rrugë parimit të Zhvillimit të qëndrueshëm;
- të lehtësojë zbatimin e gjerë të parimit *ndotësi paguan*;

- t'i garantojë hapësirë veprimi implementimit të Teknologjive Ekologjikisht të Pastra;
- të krijojë mundësi reale që publiku të ushtrojë të drejtën për të marrë pjesë në vendim-marrjen e organeve shtetërore, si dhe të drejtën për padi në gjykatë kur dëmtohet mjedisi;
- të mbajë nivele e raporte të pranueshme me zhvillimin e legjislacionit të fushave të tjera;
- të shmangë maksimalisht përsëritjet, kundërthëniet e mbipalosjet eventuale me ligje të tjera;
- të implementojë kërkesat që burojnë nga Konventat, protokollet e marrëveshjet ku Shqipëria është palë;
- të realizojë përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet e BE.

Sigurisht që miratimi i draftligjeve do të sjellë plotësim të ndjeshëm në legjislacionin mjedisor, por kurrsesi nuk mund të thuhet se me to, ky legjislacion bëhet i plotë dhe procesi i hartimit të ligjeve të reja do të ndalet. Duke ditur se ligji mjedisor është fleksibël gjithnjë në lëvizje, ai i nënshtrohet një plotësimi të vazhdueshëm.

Pjesë të rëndësishme në legjislacionin mjedisor janë edhe Konventat Ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë. Marrëveshjet mund të jenë dy apo shumëpalëshe. Kështu ekziston një Memorandum Mirëkuptimi midis Ministrisë Maqedonase të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të R. Sh. nënshkruar në shtator të vitit 2000, për ruajtjen dhe mbrojtjen e Liqenit të Ohrit dhe të mjedisit ndërkufitar nga ndotjet dhe dëmtimet në zbatim të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe sipas legjislacionit të secilës palë.

Në muajin shkurt të vitit 2001 u nënshkrua një protokoll bashkëpunimi midis Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të R. Sh. dhe Ministrisë së Mjedisit të Malit të Zi. Ky protokoll i hapi rrugën nënshkrimit të një memorandumit mirëkuptimi për mbrojtjen e mjediseve ndërkufitare.

Gjithashtu Shqipëria është palë në një sërë Konventash të tjera si:

Konventa për “Mbrojtjen e Mesdheut nga Ndotja” (Konventa e Barcelonës)

Konventa për “Mbrojtjen e Përdorimit të Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkufitare”

Konventa për “Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror në Europë”

Konventa për “Vlerësimin e Ndikimeve në Mjedis në kontekstin Ndërkufitar”

Konventa për “Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale”
Konventa “Kwadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimaterike”

Konventa për “Të Drejtën e Publikut për Informacion, për Pjesëmarrje në Vendim-marrje dhe të Drejtën për t’ju drejtuar Gjykatës; për çështje që lidhen me mjedisin” (Aarhus).

Statusi i ligjit ndërkombëtar mjedisor në legjislacionin e brendshëm

Duke iu referuar nenit 122, të Kushtetutës do të konstatojmë se në Republikën e Shqipërisë “çdo marrëveshje ndërkombëtare përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të .”

Këto parime kushtetuese janë të zbatueshme pa dyshim edhe për legjislacionin mjedisor. Kështu në ligjin nr. 764, datë 21.01.1993 “Për mbrojtjen e Mjedisit” tashmë i shfuqizuar, thuhej se marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e mjedisit në të cilat Republika e Shqipërisë është palë janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Republika e Shqipërisë respekton dhe zbaton aktet ndërkombëtare në të cilat nuk është palë.

E drejta mjedisore e Komunitetit European, përbërja

Në përbërje të së drejtës mjedisore të Komunitetit European janë edhe burimet e legjislacionit kombëtar: Kushtetutat Kombëtare, akte ligjore dhe nënligjore, kodet, marrëveshjet dypalëshe.

a. Traktatet

Për shkak të shtrirjes që morën problemet mjedisore, ato u ngritën në nivel rajonal vetëm pas hartimit të traktateve të para të Komunitetit European. çështja e kompetencave të Komunitetit në fushën mjedisore u përcaktua në Aktin Unik European të vitit 1986.

Mbrojtja e mjedisit u bë pjesë e politikave të Komunitetit në vitin 1972 si rezultat i Konferencës së Parisit ku u mbledhën krerët e shteteve dhe të qeverive, e cila u mbajt pas Konferencës së Stockholmit mbi Mjedisin Njerëzor. Takimi i Parisit hartoi një Deklaratë e cila shpalli se:

Zhvillimi ekonomik në vetvete nuk është një fund. Qëllimi i tij parësor do të jetë të reduktojë pabarazitë në kushtet e jetesës. Ai do të qëndrojë përkrah të gjithë partnerëve të tjerë social. Kjo do të çojë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe të standardit të jetesës. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së mjedisit, me qëllim që progresi të vendoset në shërbim të të gjithë njerëzve.

Akti Unik European përcakton parimet e veprimit në mjedis, i amenduar me traktatin e Maastricht-it parimet janë:

- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit.
- Kontributi për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve
- Përdorimi i kujdesshëm dhe racional i burimeve natyrore.
- Ndërkombëtarizimi i masave që rregullojnë problemet mjedisore.

Ky nen sanksionon se veprimet e Komunitetit janë hartuar për të garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, bazuar në parimin e parandalimit të dëmtimeve dhe ndotjeve duke marrë masa konkrete të zbatueshme dhe në parimin që “ndotësi paguan”.

Planet e veprimit mbi mjedisin, të Komunitetit duhen zbatuar në të dhënat teknike dhe shkencore mbi gjendjen e mjedisit në rajone të ndryshme. Këto plane veprimi duhen ndërmarrë në nivel rajonal dhe jo lokal në ato raste kur arritja e objektivit realizohet më mirë.

b. Rregulloret

Rregulloret e Komunitetit janë akte të mirëfillta ligjore, të detyrueshme në të gjitha elementët e tyre, dhe drejtpërdrejtë të aplikueshme në të gjitha shtetet anëtare. Rregullorja vendos të drejtat dhe detyrimet në mënyrë të përcaktuar pa ndërhyrë në ligjin kombëtar. Përgjithësisht rregulloret në fushën e mjedisit mund të adoptohen vetëm kur subjekti ka lidhje tregtie me shtetet anëtare të Komunitetit p.sh. rregullorja 348/81 vendos një rregull të përbashkët për importimin e balenave.

c. Direktivat

Direktivat janë norma të cilat detyrojnë shtetin i cili i përshtat (adopton), t'i aplikojë në mënyrë të përpiktë, nën kontrollin shtetëror kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

d. Planet e veprimit

Legjislacioni i hartuar në zbatim të Politikave Mjedisore të Komunitetit përmbledhet në Planet e Veprimit. Një plan veprimi detajon mënyrën e zbatimit të një politike të caktuar në një territor të caktuar. Kështu një plan veprimi mund të jetë rajonal ose lokal. Pesë plane veprimi:

Plani i parë i veprimit është i vitit 1973.

Plani i dytë i veprimit është i vitit 1977.

Plani i tretë i veprimit është i vitit 1983.

Plani i katërt i veprimit është i vitit 1987.

Plani i pestë i veprimit i cili titullohet "Drejt Qëndrueshmërisë Një program Politikash dhe Veprimesh për Mjedisin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm" që mbulon 1993-2000.

Plani i parë i veprimit mbi mjedisin (1973), deklaroi se detyrimi për të vendosur një zhvillim të qëndrueshëm të aktivitetit nuk mund të kuptohet (konceptohet) pa një fushatë për të luftuar ndotjen dhe zhurmat, për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mbrojtjen e mjedisit, përmirësimi i cilësisë së jetës dhe mbrojtja e mjedisit natyror janë detyrimet primare të Komunitetit.

Në zbatim të këtyre detyrimeve, politikat do të :

- parandalojnë, pakësojnë dhe me sa munden do të eliminojnë ndotjen dhe zhurmat.

- Sigurojnë kontrollin e zhurmave dhe do të ndalojnë shfrytëzimin e dëmshëm të burimeve natyrore, i cili dëmton ekuilibrin ekologjik.

- Orientojnë zhvillimin në përputhje me detyrimet primare, si dhe në mënyrë të veçantë në përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës.

- Kushtojnë një vëmendje më të madhe në çështje mjedisore në përdorimin e tokës dhe në planifikimet territoriale.

- Synojnë arritjen e zgjidhjeve të përbashkëta për çështjet mjedisore me Shtetet që nuk janë anëtarë të Komunitetit (ekstrakomunitare)

Planet e veprimit në këto vitet e fundit janë përqendruar në të drejtën e publikut për të marrë informacion zyrtar për çështjet që i përkasin mjedisit dhe në të drejtën e individëve dhe grupeve të ndryshme për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre në rrugë administrative sipas procedurave përkatëse.

Vendi që zënë normat mjedisore në procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me normat dhe standardet e Komunitetit European.

Përafrimi është një proces i cili përfshin të gjithë legjislacionin e një vendi të caktuar dhe konsiderohet si parakusht për të aderuar në Bashkimin European. Korpusi ligjor i BE-së quhet ndryshe *acqui communautaire* dhe përmban më tepër se 80.000 norma ligjore të cilat janë sine qua non për t'u bërë pjesë e së drejtës së brendshme të një vendi kandidat dhe që synon të

hyjnë në familjen evropiane si anëtar me të drejta të plota. Ky është procesi normat dhe rregullat e të cilit tashmë janë të përcaktuara. Ky lloj procesi ka mënyra, afate, kontrolle etj. Procesi fillon me një miratim paraprak në parim nga Këshilli i Europës për të miratuar në të ardhmen marrëveshjen e asociimit. Brenda një afati të caktuar (jo më shumë se një vit), vendi konkret duhet të hartojë draftmarrëveshjen e asociimit. Pas nënshkrimit të saj hartohet programi i përafrimit të legjislationit. Ky program prezanton përparësitë që i cakton vetë vendi (cilat ligje do të miratohen të parat), përcakton ritmet teknikat që do të përdoren, strukturat që do të realizojnë përafrimin. Gjithashtu, ky program parashikon mënyrat se si do të monitorojë Këshilli i Europës procesin. Për të gjithë këto elementë, KE paraqet sugjerimet e veta.

Legjislationi mjedisor ka vendin e tij në direktivat e Bashkimit Europian. Ky pozicion karakterizohet nga fakti që ai është pak i komplikuar, pasi ndaj tij, veç vendeve që përpiqen të aderojnë në Bashkimin Europian, është i obliguar vetë komuniteti. Kjo ndodh pasi nocioni mjedis dhe mbrojtja e tij është i pranishëm në të gjitha direktivat e tjera.

a. Rrethana e parë është pra, fakti që mjedisi është i lidhur me të gjitha direktivat e tjera.

b Rrethana e dytë është se qëndrimi i prerë për detyrimet e vendeve anëtare janë me kosto shumë të lartë. Të mos harrojmë faktin se Europa u bashkua pas një zhvillimi të madh industrial. Nënshtrimi ndaj normave kufizuese do të thotë privim nga të mirat materiale, ulje e standardit të jetesës etj.

c. Rrethana e tretë është se direktivat për mjedisin, konceptohen vetëm nën zhvillimin e shkencës, nën optikat dhe alternativat se nga do të eci njerëzimi. Kështu vendosen në balancë ekzistenca me zhvillimin e teknologjisë, primitivizmi me modernizmin.

Karakteristikat bazë të Ligjit Mjedor

Ligji mjedor ka disa aspekte karakteristike. Së pari rregullat e natyrës të shkruara në shkencat biologjike, fizike dhe kimike janë themelore për ligjin mjedor. Ekziston një numër i vogël disiplinash ligjore të cilat kërkojnë njohuri shkencore. Pjesa më e madhe e fushave ligjore orvaten të rregullojnë marrëdhënie të ndryshueshme njerëzore dhe shpesh të paparashikueshme. Në ndryshim me këtë pjesë të legjislationit, ligji mjedor përdor shkencën për të parashikuar dhe rregulluar pasojat e sjelljes

dhe veprimtarisë së njeriut ndaj fenomeneve natyrore. Nevoja e ligjit mjedisor për të marrë në konsideratë "ligjet e natyrës", pashmangshmërisht çon drejt një përafrimi ndërdisiplinor të problemeve mjedisore.

Hartuesit e ligjeve dhe juristët mjedisorë, në punën e tyre duhet të bazohen në rezultatet e ekspertizave shkencore. Vetë shkencëtarët nga ana e tyre, duhet të shkëmbejnë mes tyre njohuritë sipas fushave përkatëse. Për shembull, në fushën e ngrohjes globale, shkencëtarët që studiojnë atmosferën janë të trajnuar në degën e meteorologjisë dhe kimisë, përgatisin modele të ndryshme klimaterike, por pas punës së tyre gjithçka varet nga biologët dhe ekologjistët që ta analizojnë impaktin e këtyre ndryshimeve mbi biotopet dhe sistemet ekologjike.

Ekspertiza shkencore kërkohet jo vetëm për të komunikuar nivelin bashkëkohor të njohjes, por për të parashikuar dhe vlerësuar rrezikshmërinë në zonat e pasigurta.

Në të kaluarën shumë ndërmarrje ndërtuan oxhaqe shumë të larta për nxjerrjen e tymrave që mund të dalin gjatë proceseve teknologjike. Ata bazonin veprimet e tyre në idenë që ndotja e ajrit mund të reduktohet me anë të përhapjes së tymit në distanca të mëdha.

Në ditët e sotme është bërë e ditur se zgjidhja e gjetur me anë të këtyre oxhaqeve të lartë, së pari shërben për të transferuar ndotjen nga zonat e instaluara pranë tokës në ato të instaluara në distanca të mëdha duke prodhuar kështu ndotje përgjatë një amplitude të madhe duke sjellë të ashtuquajturat shira acide.

Karakteristikë për afrimin mes tyre të disiplinave të shumta është e domosdoshme të vendosen masa integruese për të shmangur transportimin e ndotjes nga një përbërës i mjedisit në një tjetër p.sh. duke pastruar ajrin të mos shkaktojme një ndotje të mundshme në ujë.

Kjo sepse komponentët e biosferës, të cilët së bashku formojnë atë që ne e quajmë mjedis, janë të lidhur reciprokisht me njëri tjetrin. Për këtë arsye duhet patur kujdes dhe i duhet kushtuar vëmendje e madhe studimit të shkaqeve, pasojave, synimeve dhe politikave që duhen ndjekur që në përpjekjet për të eliminuar një dëm të mos shkaktojme një më të madh.

Duke rishikuar me kujdes komponentët e mjedisit dhe lidhjet e ndërsjellta mes tyre, del në pah një karakteristikë tjetër e mjedisit. Ai është dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm. Kjo karakteristikë kërkon që ligjet dhe politikat mjedisore të jenë fleksibël, përballë mundësisë së ndryshimeve të papritura e të

menjëhershme, për t'iu përgjigjur në kohë rrethanave dhe kushteve të reja që mund të krijohen.

Por në të njëjtën kohë, madje në mënyrë paradoksale legjislacioni mjedisor duhet të jetë largpamës duke ruajtur jetën dhe ekuilibrat ekologjik, drejt një të ardhme të parashikueshme.

Pakthyeshmëria e dëmit mjedisor është elementi i tretë që ndikon mbi legjislatorin. Ligjbërësit dhe zyrtarët e tjerë janë të detyruar të pranojnë faktin se dëmi në mjedis mund të jetë permanent, siç është rasti i zhdukjes së specieve, erozionit që shkaktohet nga prerja masive e pemëve, djegiet e pyjeve, ndotja e ujërave, e ajrit, dëmtimet e florës, faunës, dëmtimit pa kthim të biodiversitetit e kështu me radhë.

Kjo të çon drejt fokusimit të disa masave parandaluese në rregullimet ligjore tradicionale, në rastet e shkeljeve ligjore.

Në fakt parandalimi është i domosdoshëm edhe për ato dëme të cilat konsiderohen të riparueshme sepse rehabilitimi dhe riparimi mund të jenë të kushtueshëm.

Në përmbledhje ligji mjedisor ka tre karakteristika bazë:

1. është ndërdisiplinor
2. është i pakthyeshëm
3. është dinamik

Këto karakteristika të cilat derivojnë nga vetë mjedisi reflektohen në ligjin mjedisor European. Ky ligj përbëhet nga normat kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, norma të cilat rregullojnë aktivitetin njerëzor që kërcënon përkeqësimin e vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit.

Megjithatë përmbajtja e ligjit kombëtar fokusohet drejt prioritetëve të vendit apo rajonit në të cilin do të aplikohet duke synuar ruajtjen e vlerave kombëtare dhe specifikat përkatëse.

Përsa i përket legjislacionit mjedisor shqiptar ai ka disa karakteristika të cilat përputhen edhe me ato të ligjit european në përgjithësi. Për të përcaktuar këto karakteristika nisemi nga fakti veçanërisht i rëndësishëm që tashmë Shqipëria ka legjislacionin e saj mjedisor. Ky legjislacion karakterizohet nga fakti që :

1. Është krejt i ri, i krijuar në dhjetë vjeçarin e fundit;
2. Është përgjithësisht i përqasur me standardet e Bashkimit European (sipas kërkesave të acqui communitaire)
3. Përbëhet nga të gjitha llojet e akteve normative, nga Kushtetuta e Republikës, nga ligje të veçanta për mjedisin, nga Vendime të Qeverisë, nga Urdhra e Udhëzime të Ministrave, nga Rregullore specifike, nga norma standarde etj.
4. Vazhdon të jetë në një proces aktiv plotësimesh e përmirësimesh.

Informacioni për gjendjen e mjedisit

E drejta e informimit në Republikën e Shqipërisë është parim kushtetues. Në nenin 23 të Kushtetutës thuhet:

“E drejta e informimit është e garantuar”

Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

Sipas Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në nenin 56 të saj thuhet se:

“Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”.

Informacioni për gjendjen përfshin:

a. Të dhëna për gjendjen e elementëve e të faktorëve të mjedisit.
b. Të dhëna për rezultatet e veprimeve që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ndotje a dëmtim të mjedisit dhe elementëve e faktorëve të tij.

c. Të dhëna për veprimtarinë e ndërmarrë për mbrojtjen e mjedisit.

d. Të dhëna për gjendjen dhe shfrytëzimin e burimeve biologjike dhe minerare.

Informacioni shoqërohet me shpjegime rreth pasojave negative të mundshme me veprim të vonuar mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe me rekomandime për mënyrën e veprimit të shtetasve në raste të parashikimit të pasojave negative.

Informacioni për gjendjen e mjedisit, i paraqitur nga institucionet e specializuara merret dhe grumbullohet nga Ministria e Mjedisit dhe agjencitë e saj rajonale, ministritë e institucionet e tjera qendrore dhe këshillat e komunave, bashkive ose qarqeve, sipas njësive territoriale përkatëse.

Vetë personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar të paraqesin informacionin për shkarkimet sasiore e cilësore të lëndëve që ndikojnë në mjedis, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Informacioni i grumbulluar nga organet përkatëse publikohen nëpërmjet mjeteve të informimit publik ose mjeteve të tjera të përshtatshme, në një formë të kuptueshme për shtetasit, informacion i cili përmban të dhëna për ndryshimin e gjendjes së mjedisit.

Organet shtetërore përkatëse si dhe personat juridikë dhe fizikë, janë të detyruar të informojnë popullsinë për ndryshimet mjedisore negative të ndodhura, sapo të vërejnë ndotje apo dëmtim të mjedisit, si dhe masat e marra për kufizimin e mënjanimin e tyre dhe kërkesat për mënyrën e veprimit të shtetasve për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e tyre.

Të gjithë personat juridikë e fizikë informojnë blerësit dhe konsumatorët në kohën e shitjes a të kryerjes së shërbimeve që

janë të rrezikshme, dhe për efektet ose ndikimet negative të mundshme për mjedisin e shëndetin.

Po në zbatim të ligjit në kompetencat e Ministrit të Mjedisit renditet dhe përgatitja çdo dy vjet e raportit për gjendjen e mjedisit dhe paraqitja e tij për shqyrtim Këshillit të Ministrave.

Po kështu ndër detyrat e Ministrisë së Mjedisit renditet dhe promovimi, edukimi dhe pjesëmarrja e publikut në veprimtaritë që synojnë mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht në njohjen me gjendjen e mjedisit, hartimin e programeve dhe të planeve për mjedisin dhe në kryerjen e detyrave të organeve qendrore e lokale për mbrojtjen e mjedisit.

Në zbatim të së drejtës Kushtetuese për të pasur informacion për mjedisin është sanksionuar me ligj se çdo personi i garantohet e drejta për të pasur informacion për mjedisin nga institucionet e specializuara për mjedisin dhe e drejta për të ndikuar në marrjen e vendimeve për mjedisin. Pjesëmarrja e publikut mund të realizohet nga individë të veçantë përmes organizatave joqeveritare të mbrojtjes së mjedisit.

Çdo person fizik e juridik ose organ shtetëror, në rast të kërcënimit, ndotjes a dëmtimit të mjedisit, ka të drejtë të njoftojë dhe kërkojë nga organet kompetente për Mbrojtjen e Mjedisit dhe nga personat e tjera fizikë a juridikë përgjegjës për ndërprerjen e veprimtarisë së paligjshme.

Sipas ligjit bazë të mbrojtjes së mjedisit ndër masat shtrënguese është parashikuar se përbëjnë kundravajtje administrative:

dh) Mosnjohimi i popullsisë nga personat juridikë e fizikë për shkaktimin e ndotjes ose dëmtimit të mjedisit prej tyre, për masat e marra për kufizimin ose mënjanimin dhe për mënyrën e veprimit të shtetasve.

e) mospajisja e blerësve ose konsumatorëve me informacionin përkatës për mallrat dhe shërbimet që janë të rrezikshme dhe për efektet ose ndikimet negative të mundshme.

Një arritje e rëndësishme në fushën e informimit të publikut është edhe nënshkrimi i **Konventës së Aarhusit** "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion për mjedisin, pjesëmarrjen në vendim marrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin", e cila u adoptua në 30 tetor të 2001 në qytetin danez të Aarhusit. Kjo u bë në kuadër të konferencës së katërt ministrale si pjesë e procesit "Politika Mjedisore për Europën" dhe ka hyrë në fuqi më 20 Tetor 2001.² Konventa e Aarhusit është gjithashtu vlerësuar si "Konventa e demokracisë në fushën e mjedisit."³

² Shih për më tepër: <http://ec.europa.eu/environment/aarhus/>

³ Strategjia dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri. Ministria e Mjedisit. 2005.

Tre të drejtat bazë të parashikuara në Konventën e Aarhusit janë:

1. E drejta e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor;
2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
3. E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit.⁴

Në zbatim të kësaj Konvente, është përcaktuar detyrimi ligjor për njoftimin e publikut dhe të organizatave jofitimprurëse për gjendjen e mjedisit nëpërmjet publikimit të të dhënave nga organet shtetërore dhe nga personat fizikë dhe juridikë.

Veç të drejtës për tu informuar, në ligj është e garantuar pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen e organeve të mjedisit. Kushdo ka të drejtën të ankohet tek organet shtetërore të mjedisit për çdo veprimtari që përdor, kërcënon, dëmton dhe ndot mjedisin dhe të kërkojë mbylljen e saj në rast rreziku.

Gjithashtu parashikohen qartazi dhe pa ekuivokë e drejta për referendume lokale, si dhe garantohet pjesëmarrja publike në vendim-marrjen që prek probleme që lidhen direkt apo indirekt me mjedisin.⁵ Për më tepër këto të drejta, sidomos ajo e detyrimit ligjor për garantimin e informacionit qytetarit dhe marrjes së mendimit të tyre në procese të vendim-marrjes lokale apo të përgjithshme, garantohen edhe nga Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të 28 Janarit 2003 për rastin e parë dhe Direktiva 2003/35/EC e 26 Majit 2003 për rastin e dytë.

Të dyja këto konventa parashikojnë akses të qartë dhe të garantuar përpara drejtësisë dhe ku qytetarët dhe grupet e interesit mund të ankohen për implementimin jo adekuat apo çdo lloj konflikti ligjor që mund të lind mes vendit që i ka inkorporuar në sistemin ligjor këto direktiva të BE-së. Si vend aplikant për kandidat në Bashkimin Evropian, Shqipërisë i duhet t'i bëjë pjesë e detyrueshme të së drejtës së brendshme dhe t'i zbatojë me përpikëri këto detyrime që rrjedhin nga kuadri ligjor evropian.

⁴ *Ibid*

⁵ <http://ec.europa.eu/environment/aarhus/>

Mbyllja

Ky punim lindi si nevojë për një analizë të hollësishme dhe të detajuar të kuadrit ndërkombëtar, veçanërisht atij evropian për mjedisin dhe mbrojtjen e tij. E rëndësishme të kuptohet si rrjedhojë e kësaj analize është përafrimi i legjislacionit shqiptar me kuadrin evropian në këtë fushë përherë e më të rëndësishme dhe sensitive, veçanërisht pas rrezikut tashmë të evidentuar të ngrohjes globale dhe rreziqeve të tjera që i vijnë mjedisit si rrjedhojë e veprimtarisë njerëzore dhe që duhen rregulluar me ligj. Ky rregullim bëhet nëpërmjet parashikimeve ta qarta të sanksioneve në rast shkelje, si dhe mekanizmave të gjyqësorit të cilat mundësojnë procese të tilla implementimi.

Në radhë të parë, eseja trajtoi dinamikën e zhvillimit të së drejtës mjedisore në Evropë dhe më gjerë, duke iu referuar gjithashtu edhe traktateve dhe konventave të famshme ndërkombëtare, të tilla si Protokollin e Kiotos, ai i Montrealit, Konventa e Aarhusit, Samiti i Rio-s, ai i Kopenhagenit etj. Në thelb të kësaj qasje analitike, ishte vëzhgimi i trajtores progresive që ka patur e drejta mjedisore, e cila korelon me zhvillimin e ndjeshmërisë më të madhe ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me forma të ndryshme të ndotjes mjedisore, ngrohjes globale dhe problemeve të tjera që lidhen me ambientin e një bote që të gjithë e ndajmë dhe qytetarë të shqetësuar të së cilës të gjithë jemi.

Nga ana tjetër, në studim u trajtua edhe lidhja e ngushtë e së drejtës ndërkombëtare me të drejtën nacionale. U trajtuan burimet e së drejtës publike ndërkombëtare, u ravijëzuan qartazi ato që përbëjnë parimet kryesore të kësaj të drejte dhe u nënvizua lidhja që kishin me të drejtën e brendshme. Si pjesë e rëndësishme e së drejtës publike dhe duke iu referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ne dimë që traktatet, konventat dhe forma të tjera burimore të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare kanë prioritet mbi legjislacionin e një vendi pjesëmarrës në organizata ku janë miratuar këto konventa dhe traktate. Përrjashtim bën vetëm Kushtetuta si akti më i lartë burimor në të drejtën e një vendi, konkretisht në vendin tonë.

Për më tepër u vu re se Kushtetuta, kuadri i përgjithshëm ligjor dhe e drejta evropiane mjedisore kanë mjaft pika konvergjence, qoftë edhe me një vështrim sipërfaqësor dhe në pamje të parë. Këtu hyjnë norma të tilla ligjore, si e drejta për informim (duke përfshirë edhe të drejtën për informim për problemet mjedisore), ku ka një nen të veçantë që flet për këtë në Kushtetutë. Si shembuj të tjerë mund të përmendim të drejtën

për pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje, sidomos në këshillat lokalë, e drejta për referendume të cilat mund të kërkojnë me anë të peticioneve që përmbajnë 20.000 firma, legjislacioni i mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit dhe norma të ngjashme ligjore të cilat i ndeshim në konventat ndërkombëtare.

Për më tepër, Shqipëria ka nënshkruar dhe më pas ratifikuar dhe botuar në fletoren zyrtare, konventa dhe traktate të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, duke tentuar përsosjen e rregullimit ligjor dhe kodifikimit të së drejtës mjedisore. Ndër konventat dhe traktatet më të rëndësishme të adoptuara nga Shqipëria, mund të përmendim *inter alia*, Protokollin e Kiotos, Konventa e Stockholmit, Axhendën 21, Konventën e Aarhusit etj.

Parë në këtë dritë, inkorporimi gradual i legjislacionit bashkëkohor në fushën e mbrojtjes së mjedisit gjen shprehje të një logjike evolutive në të drejtën e brendshme, duke filluar me Ligjin 7501 të vitit 1991 për Tokën, ndryshuar në mënyrë konsekuative pesë herë deri në vitin 2004 nga legjislatori, Ligji 7664 i vitit 1993 për Mbrojtjen e Ambientit, Ligji i 1994-ës për Faunën e Egër dhe Gjuetinë, Ligji 8906, i 2002-shit për Zonat e Mbrojtura, Ligji 8897 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe ligje të tjerë të ngjashëm, tregojnë se e drejta mjedisore në Shqipëri ka progresuar me të njëjtën logjikë zhvillimi të vënë re në të drejtën ndërkombëtare dhe në hap me të.

Në vitin 2001 vendet e Bashkimit Evropian premtuan 400 milionë dollarë për klimën. Takimi i para disa javësh i Këshillit Evropian e vuri në mënyrë eksplicite luftën ndaj ngrohjes globale si prioritet. Udhëheqësit botërorë po shqyrtojnë aktualisht mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për të kufizuar ndikimin e ndryshimit të klimës në Kopenhagen. Edhe Presidenti amerikan Obama duket shumë më i predispozuar se paraardhësi i vet në përpjekjet për të ndihmuar luftën ndaj ngrohjes globale, zhvillimit ekonomik ekologjik (eko-eko) dhe të qëndrueshëm. Samiti i Kopenhagenit që pritet të mbahet shumë shpejt mendohet të ketë një efekt të krahasueshëm dhe ndoshta impakt më të madh se Protokollin e Kiotos.

Infrastruktura ligjore pritet të pësojë ndryshime të rëndësishme, ku masat mbrojtëse ndaj klimës dhe ambientit në përgjithësi do përforcohen me forcën përkatëse të sanksioneve. Kjo mund të sjellë një evolucion domethënës në të drejtën mjedisore ndërkombëtare dhe për rrjedhojë pesha specifike në legjislacionet kombëtare të shteteve ka për t'u rritur dhe reflektuar gjithnjë e më tepër dinamikën e zhvillimeve aktiviste në mbrojtjen e mjedisit. Është *conditio sine qua non* që Shqipëria t'u

bashkëngjitet duke ecur me të njëjtin hap këtyre ndryshimeve në të drejtën mjedisore ndërkombëtare, duke ratifikuar me shpejtësi normat e reja rregulluese në këtë sektor. Ekonomi më zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë është vetëm ajo që merr parasysh dinamikën e kohës ku jetojmë, vendos prioritetet e qarta, ndër të cilat kryesore është mbrojtja e shëndetit të shtetasve të vet, ku primare ngelet lufta kundër ndotjeve të ndryshme mjedisore.

Rekomandime

Disa rekomandime që mund të parashtrohen në përfundim të këtij punimi si strategji e mundshme dhe plan veprimi mund të jenë:

- Kërkesa për formulimin e qartë dhe të plotë të një kuadri ligjor që shmang kontradiktat me legjislacionin ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Ky është një proces i natyrshëm që do vijë edhe si rrjedhojë e inkorporimit të plotë të *acqui communautaire* në të drejtën e brendshme të vendit tonë.
- Përparësitë, synimet dhe objektivat ku do të arrihet me zbatimin e kërkesave të kuadrit ligjor evropian;
- Fushat dhe drejtimitet themelore ku do të kryhen veprimtaritë zbatuese;
- Të angazhuarit në nivel kombëtar dhe lokal, përfshi organet publike, OJF-të mjedisore, organizatat e biznesit, mediet dhe të interesuar të tjerë.
- Detyrat konkrete, të menjëhershme, afatmesme e afatgjata që do të përballohen nga secili prej të angazhuarve për politikë-bërjen, përsosjen e kuadrit ligjor dhe implementimin e tij.

Gjithashtu, në këtë strategji dhe plan-veprimin e ardhshëm, duhet të bëhen përpjekje për të përcaktuar:

- Indikatorët në bazë të të cilëve do të monitorohen të gjitha veprimtaritë zbatuese për kërkesat që parashtrohen për strategjinë e ardhshme;
- Dokumentet e standardizuara, në të cilat do të pasqyrohen veprimtaritë zbatuese;
- Organizmin që monitoron (një OJF mjedisore kombëtare) apo entin publik të pavarur të rregulluar me ligj për zbatimin e Planit të Veprimit në nivel kombëtar;
- Kostot dhe fondet që nevojiten për mbështetjen dhe për mbulimin e veprimtarive zbatuese.

Bibliografi e selektuar

CLOSING THE GAP Assessing and Improving Environmental Policy Implementation in Albania. Agenda Institute (2009)

Bulgaria's Quest to Meet the Environmental Acquis. European Stability Initiative (2008)

EBRD. Albania Country Strategy (2004)

European Commission. Stabilisation and Association Report 2008- Albania- COM (2008) final

EC, Albania Progress Report 2009.

Commission Staff working Document-Analytical Report accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament and the Council: Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union 2010

Handbook on the implementation of EC Environmental Legislation

Albanian Ministry of Environment, National Strategy on Environment Sector, October 2007.

Albanian Ministry of Environment, Inter-sectorial Strategy on Environment 2007

EC, Handbook for Implementation of EU Environmental Legislation, Draft November 1999.

Directive 2003/4/EC of the European Parliament and of the Council of 28 January 2003 on **public access to environmental information** and repealing Council Directive 90/313/EEC

Guidance document for member States' reporting under Article 9 of Directive 2003/4

Directive 2003/35/EC of the European Parliament and of the Council of 26 May 2003 providing for **public participation** in respect of the drawing up of certain plans and programmes relating to the environment and amending with regard to public participation and access to justice Council Directives 85/337/EEC and 96/61/EC

Strategy and Action Plan for Implementation of Aarhus Convention in Albania. Ministry of Environment. 2005.

Dabelko, G.D. 1996. "Ideas and the Evolution of Environmental Security Conceptions." Paper presented at the International Studies Association Annual Meeting, San Diego, CA, April 1996.

Kobtzeff, Oleg. 2000. "Environmental Security and Civil Society", in- Gardner, Hall, (ed.) Central and South-central Europe in Transition, Westport, Connecticut: Praeger, 2000, pp. 219-296.

Eranda Gjomema

SIGURIMI I ENERGJISË DHE RUAJTJA E MJEDISIT: DY ANËT E SË NJËTËS MEDALJE?

Që nga mbarimi i luftës së ftohtë si dhe rënies së komunizmit, nevoja për sigurimin e furnizimit me burime energjitike ka pësuar një rritje në kërkesë. Ndryshimi i balancës gjeostrategjike e shoqëruar gjithashtu nga qëndrimi i shteteve eksportuese të energjisë, ka rritur ndjeshëm shqetësimet e shteteve importuese. Mjafton të përmendim rastin e ndërprerjes së furnizimit me gazin Rus që u ndodhi vendeve të Bashkimit Europian (BE) në dimrat e viteve 2006-2009¹, për të ngritur dyshimet se Rusia e përdorte gazin si një armë të fuqishme me qëllim që të arrinte pikë-synimet e politikës së saj të jashtme. Këto ngjarje kanë nxitur politikë-bërësit e vendeve të BE-së të ndërmarrin masat e duhura për diversifikimin e sigurimit të furnizimit me burime energjitike. Në Kartën e Gjelbër (*Green Paper*) të vitit 2000 Komisioni Europian (KE) paralajmëroi për rrezikun e vartësisë së Europës ndaj energjisë së importuar, gjë e cila mund të shkonte nga 50% në 70% në vitet 2020-2030.² Dokumenti vijues, Karta e Gjelbër e vitit 2006 identifikon tre objektiva për një energji së pari të qëndrueshme, së dyti konkurrenente dhe së treti të siguruar nga burime të tjera energjitike.³ Pra, qëllimi kryesor i propozuar në këto dokumente është shmangia e rreziqeve që kanosen prej vartësisë ndaj energjisë së importuar.

¹ Per një studio të detajuar mbi efektin e të ashtuquajturave « Krizat e Gazit » konsulto : Stern, J. 2006. *The Russian-Ukrainian Gas Crisis of January 2006* Oxford Institute for Energy Studies <http://www.avim.org.tr/icerik/energy-gas.pdf>, si dhe Kovacevic, A. 2009. *The Impact of the Russia-Ukraine Gas Crisis in South Eastern Europe* Oxford Institute for Energy Studies <http://www.oxfordenergy.org/pdfs/NG29.pdf>.

² European Commission. COM(2000) 769, November 2000 Green Paper « Toward a European Strategy for the Security of Energy Supply » http://ec.europa.eu/energy/green-paper-energy-supply/doc/green_paper_energy_supply_en.pdf.

³ European Commission, COM(2006) 105 final, March 2006 Green Paper “A European Strategy for Sustainable, Competitive and Secure Energy” http://europa.eu/documents/comm/green_papers/pdf/com2006_105_en.pdf.

Ndërkohë, një nga rreziqet që përmendet shpesh jo vetëm nga politik-bërësit por edhe nga akademikët, organizatat joqeveritare dhe ekspertë të ndryshëm— dhe që ka lidhje të drejtpërdrejta me sigurimin e energjisë— është çështja mjedisore. Në kohët e teknologjisë moderne perceptimi i rrezikut dhe sigurisë ka dalë nga kornizat e çështjeve ekskluzivisht të brendshme të një shteti dhe ka marrë një trajtë sa gjithëpërfshirëse aq edhe të papërcaktueshme. E thënë ndryshe, në rastin e energjisë dhe mjedisit, rreziku mund të vijë nga sulmet terroriste të rrugëtimit dhe burimeve energjitike, nga aksidentet si për shembull rasti i Cernobilit në vitin 1986, apo më afër, reaktori atomik në Fukushima të Japonisë në mars 2011 etj. Në këto rrethana, është jetike për një shtet hartimi i një strategjie të qartë për parandalimin dhe kapërcimin e krizave që mund të vijnë nga rreziqe të tilla.

Në shkallë kombëtare, siguri i furnizimit me burime energjitike ngre një pikëpyetje sa i përket (para) përgatitjes së shtetit shqiptar për të përballuar kriza energjitike të cilat mund të gjenerojnë në kriza mjedisore dhe për rrjedhojë të kenë një rrezik të shumëfishtë për qytetarët e vet. Qëllimi këtu nuk është të bëhet një vlerësim kost-efektiv i punës së qeverive bashkëkohore gjatë viteve të tranzicionit, pasi rezultatet e veprimtarisë së tyre janë ndërë dukshëm nga qytetari i thjeshtë shqiptar. Ajo ç'ka kërkohet të arrihet në këtë artikull është së pari një analizë e evoluimit të konceptit të sigurisë energjitike duke theksuar dimensionin mjedisor të këtij koncepti. Së dyti, të kontribuoj në zhvillimin e një debati të munguar në literaturë që çështje të tilla të mos ngelën të izoluara por të marrin përmasa gjithëpërfshirëse. E thënë ndryshe, është i domosdoshëm krijimi i një dialogu ndërinstitucional që do të siguronte një transparence në procesin e vendim-marrjes dhe hartimit të politikave energjitike sipas përvojës dhe standardeve të vendeve të zhvilluara.

Siguria energjitike: një koncept në ndryshim

Termi siguri energjitike ka një përdorim të gjerë në literaturë ndaj dhe gjetja e një konsensusi është e vështirë dhe e kushtëzuar gjithnjë e më tepër nga konteksti i përdorimit. Fillimisht ky term është përdorur në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe studimeve të sigurisë nga shkolla e Kopenhagen-it e përfaqësuar kryesisht nga Berry Buzan (1998). Kjo rrymë mendimi ka tejkaluar konturet e analizave tradicionale të çështjeve të sigurisë duke përfshirë kështu katër lloje

rreziqesh: politike, ekonomike, shoqërore, dhe mjedisore. Siguria energjitike është e domosdoshme për funksionimin e shteteve moderne dhe si rrjedhojë është e lidhur ngushtë me çështjen e sigurisë së nivelit të lartë politik (*high politics*).⁴ Por e parë në këndvështrimin e shkollës së Kopenhagenit sigurimi i energjisë kalon në nivelin e një politike gjithëpërfshirëse (*low politics*) dhe bëhet pjesë e debatit të përditshëm.

Një përkufizim i hershëm i energjisë vjen nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë dhe cilësohet si mundësimi i furnizimit me burime energjitike në mënyrë të përhershme kundrejt një kostoje të përballeshme (IEA, 2001 1a). Ky konceptim është sa i mangët aq edhe konfuz. Në dokumentin e samitit midis SHBA-ve dhe BE-së të vitit 2007, sigurimi i energjisë përkufizohej si mundësia për të siguruar furnizim të energjisë me kosto të përballeshme, të pastër, dhe burime energjitike të sigurta me qëllim të rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike globale dhe mbrojtjes së mjedisit.⁵ E thënë ndryshe, sigurimi i energjisë lidhet me katër faktorë: së pari, qasja ndaj burimeve natyrore; së dyti, faktori i koston që lidhet direkt me nivelin e zhvillimit ekonomik të çdo vendi; së treti, faktori i energjisë së pastër që ka të bëjë me çështjen e mjedisit; së fundmi, me sigurimin e burimeve energjitike që çon në implikimet gjeopolitike.⁶

Një tjetër përkufizim e lidh konceptin e sigurisë me vartësinë ndaj energjisë (*energy dependency*) e cila mund të shkaktohet nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm.⁷ Ndër faktorët e jashtëm përmenden: ndërprerja e burimeve energjitike, çështjet mjedisore, si dhe ndryshimi i gjeopolitikës së tregjeve të energjisë. Nga ana tjetër, faktorët e brendshëm janë: burimet natyrore të pamjaftueshme, zhvillimit teknologjik, si dhe sistemi i brendshëm

⁴ Matlary, H. J. (1997). *Energy Policy in the European Union* Basingstoke.

⁵ 2007 EU-US Summit Statement, Energy Security, Efficiency, and Climate Change http://eeas.europa.eu/us/sum04_07/joint_statement_energy_security.pdf.

⁶ Kryut et al. 2009. Indicators for Energy Security *Energy Policy* Vol 37, N r. 6, f. 2166 - 2181 http://www.sciencedirect.com/science?_ob=ArticleURL&_udi=B6V2W-4VV1BD3-6&_user=10&_coverDate=06%2F30%2F2009&_rdoc=1&_fmt=high&_orig=gateway&_origin=gateway&_sort=d&_docanchor=&view=c&_searchStrId=1704082131&_rerunOrigin=google&_acct=C000050221&_version=1&_urlVersion=0&_userid=10&md5=46b9063d54b1675aed62f2d26d853e82&searchtype=a.

⁷ Chevalier, J. 2006. Security of Energy Supply for the EU *European Energy Market Review* Vol. 1, Nr. 3, <http://www.eeinstitute.org/european-review-of-energy-market/EREM%203%20article%20Jean-Marie%20Chevalier.pdf>

energjitik. Duke ju referuar Chevalier (2006) ajo çka përbën diçka të re për skenarin energjitik botëror është e paparashikueshmja. Më konkretisht, autori përmend kategoritë e mëposhtme të këtij koncepti: mjedisi, gjeopolitika, rregullimet e çmimeve si dhe “e papritura”. Për efekt vendi, vetëm kategoria e parë do të shtjellohet këtu. Ndryshimi klimaterik përbën tashmë një realitet, por është e vështirë të vlerësohen rrjedhojat afatgjata dhe afatshkurtra të këtij fenomeni; aq më tepër të vlerësohet se çfarë hapash duhen ndërmarrë.⁸ Gjithsesi më i qartë është fakti se përdorimi i hidrokarbureve me kosto ambientaliste të ulëta duhet të jetë pikësnyimi i politikave energjitike.

Nga ana tjetër, Graeger (1996) shton se çështjet mjedisore duhet të bëhen pjesë e debatit të përditshëm politik.⁹ Komponentë të sigurisë dhe mjedisit përfshijnë përgatitjen ushtarake, teknike, instalimet industriale dhe aktivitete të tjera që mund të dëmtojnë mjedisin në një mënyrë të tillë që përbën rrezik të sigurisë së lartë. Në të njëjtën linjë, degradimi ose ndryshimi mjedisor mund të jenë njëkohësisht shkaku dhe pasoja e një konflikti. Ndaj mosrespektimi i mjedisit dhe keqmenaxhimi i burimeve mjedisore ka gjasa të çoj në mosmarrëveshje midis vendeve qofshin këta vende miqësore ndaj njeri-tjetrit.

Mendo globalisht, vepro lokalisht

Shqipëria është një vend që aspiron të integrohet në BE dhe si rrjedhojë qeveritë shqiptare kanë ndërmarrë hapa për inkuadrimit në traktatet me BE-në si dhe për afërsimin e legjislacionit me *acquis communautaire*. Në kuadër të këtij procesi Shqipëria së bashku me vendet e Ballkanit Perëndimor bën pjesë në Traktatin për Krijimin e një Komuniteti Energjitik i cili hyri në fuqi në 1 korrik 2006. Ky traktat ka si synim tre nivele atë kombëtar, rajonal dhe mbarë Europian.¹⁰ Në vija të përgjithshme, objektivat kryesore janë krijimi i një tregu rregullator me qëllim tërheqjen e investitorëve; krijimi i një hapësire për tregti; rritje të sigurisë energjitike; përmirësimi i gjendjes së mjedisit dhe zhvillimi i një tregu të energjisë elektrike dhe gazit i aftë të konkurroj në një hapësirë të gjerë gjeografike. Specifikisht, në planin afatshkurtër

⁸ Ibid.

⁹ Graeger, N. 1996. *Environmental Security Journal of Peace Research*, Vol.33, Nr.1 <http://www.jstor.org/stable/425137>.

¹⁰[COM (2011) 105 final: 2] http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Facts_and_Figures.

qëllimi është krijimi i tregjeve kombëtare të liberalizuara dhe transparente të afta për të tërhequr investime në gjeneratorë të ndryshëm prodhimi; në planin afatmesëm synon të krijoj tregje energjitike në të gjithë rajonin që do të mundësonin tregtinë e energjisë përtej kufijve; garantimin e furnizimit me burime energjitike duke marrë në konsideratë mjedisin dhe aspektet shoqërore. Në planin afatgjatë tregu rajonal pritet të jetë i integruar plotësisht në tregun e brendshëm energjistik të BE-së.¹¹

Në një komunikatë në Mars 2011 përmendet se Komisioni European do të rris rëndësinë lidhur me mjedisin dhe faktorët klimaterik në debatin për energjinë midis vendeve anëtare të traktatit.¹² Nevoja për të investuar në një gjeneratë të re kapaciteti me qëllim zëvendësimin e gjeneratorëve të vjetër ndotës është një domosdoshmëri sidomos duke marrë parasysh legjislacionin e BE-së për mjedisin. Kapaciteti i palëve nënshkruese për të implementuar veçoritë e direktivës 85/337/EEC, në vlerësimin e impaktit mjedisor, së bashku me dispozitat ligjore të artikullit 4 (2) të direktivës 79/409/EEC do të merret në konsideratë të veçantë nga KE-ja.¹³

Situata energjitike në Shqipëri reflekton tranzicionin e stërzgatur politik dhe ekonomik në vend. Sipas një studimi të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë të vitit 2008 sistemi energjistik është nën presion të vazhdueshëm të shumë faktorëve.¹⁴ Fill pas rënies së komunizmit Shqipëria trashëgoi një sistem të vjetër teknologjik si rrjedhojë e investimeve të pamjaftueshme dhe (mos) mirëmbajtjes. Rritja në mënyrë të vazhdueshme e kërkesës për energji si rezultat i transformimeve strukturore, si dhe rënia e burimeve vendase e rënduan më tepër sistemin. Përdorimi i gjerë i energjisë elektrike dhe mos pagesat e faturave të energjisë elektrike kanë çuar në kufizimin me furnizim të energjisë elektrike. Sipas Kovacevic (2009) ndërprerjet e energjisë elektrike sidomos në stinët kur kërkesa është e lartë ka pasoja serioze për energjinë vendase, zhvillimet ekonomike si dhe mirëqenien e popullsisë. Në vendet me vartësi të lartë nga prurjet e shirave të stinës një analizë e bazuar vetëm në kushtëzimin nga importi nuk është e mjaftueshme.¹⁵

¹¹ Ibid.

¹² COM 12 (2011) 105 Final
http://ec.europa.eu/energy/gas_electricity/community/doc/20110310_report_en.pdf.

¹³ Ibid.

¹⁴ International Energy Agency 2008. *Energy in the Western Balkans: Path to Reform and Reconstruction* <http://www.iea.org/textbase/nppdf/free/2008/Balkans2008.pdf>

¹⁵ Kovacevic, f.2.

Sistemi i furnizimit me energji elektrike është i bazuar në masën 90% nga kapaciteti prodhues i hidrocentraleve. Megjithëse një mënyrë e tillë e prodhimit të energjisë elektrike përbën ndotjen minimale të mjedisit, niveli i prodhimit është i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat e vendit. Për rrjedhojë furnizimi me energji elektrike në dekadat e fundit është mundësuar nga metoda të pa sofistikuara që kanë rritur ndjeshëm ndotjen e mjedisit. Megjithëse dy vitet e fundit ka patur prurje të mjaftueshme reshesh dhe si rezultat furnizimi i hidrocentraleve ka qenë optimal, përsëri kjo nuk zgjidh problemet afatgjata të sistemit. Përpos kësaj, çdo vërshim shirash stinor është shoqëruar me raste emergjente përmbytjesh ku rasti më flagrant ishte rreziku i përmbytjeve në masë në Shkodër në dimrat 2009 – 2010 të cilat vunë në dyshim dhe sigurinë e digave.¹⁶ Megjithëse nuk është bërë një studim rigoroz për pasojat për sigurinë mjedisore (dhe atë njerëzore) nga këto përmbytje, ato besohet të jenë të panumërta.

Duke ju referuar dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë një nga objektivat parësore është “rritja e sigurisë dhe besueshmërisë në furnizimin me energji në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti si në nivel kombëtar ashtu edhe atë rajonal”.¹⁷ Në këtë dokument parashtrohen dy skenarë, ai pasiv dhe ai aktiv për politikën energjitike:

“I pari supozon ruajtjen dhe zhvillimin e formës aktuale si në anën e furnizimit ashtu edhe në atë të kërkesës për energji për të gjithë sektorët ekonomike të vendit. Ai ruan vazhdimësinë e konsumit të energjisë elektrike si burimi dominues për ngrohje dhe ujë të ngruhtë në sektorët e banesave dhe atë të shërbimeve. Ky skenar merr parasysh masat që ka vendosur të ndërmarr qeveria, për një periudhë afat-shkurtër duke mos zbatuar me rigorozitet zbatimin e planit të veprimeve. Skenari tregon se moszbatimi i këtyre masave e çon në vështirësi të mëdha sektorin energjistik në tërësi dhe atë elektrik në veçanti me pasojat të mëdha ekonomike, rritje të deficitit tregtar energjistik për vendin si dhe rritje të tejskajshme të emetimeve të ndotësve në atmosferë. Skenari aktiv, mbështetet në vazhdueshmërinë e zhvillimit të sektorit energjistik shqiptar në përgjithësi dhe atij elektrik në veçanti, duke zbatuar me rigorozitet të lartë

¹⁶ Hoxha, F. “Siguria e digave varet nga mirembajtja e tyre” Interviste dt. 9 Dhjetor 2010, Gazeta Telegraf <http://www.gazetatelegraf.com/index.php/speciale/6916.html>.

¹⁷ Agjensia Kombëtare e Energjisë 2003, 2007 *Strategjia Kombëtare e Energjisë* http://www.akbn.gov.al/editor_files/file/content/Stategjia%20Kombetare%20e%20Energjisë.pdf.

Dokumentin e Politikës Elektroenergjitike (DPE) deri në vitet 2006-07. Gjithashtu Skenari Aktiv do të përshkruaj edhe masat shtesë që duhet të merren (përveç atyre të dhëna në DPE) për periudhën deri në vitin 2007 (sidomos për sektorët e tjerë, të cilët nuk analizohen në DPE) ashtu dhe për periudhën afatgjatë (2007-2015). Skenari do të përshkruaj në mënyrë sasiore çdo masë, që duhet marr në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe futjes së burimeve alternative në sistemin energjistik. Skenari tregon se zbatimi i këtyre masave do të bëjë të mundur që sistemi energjistik shqiptar të kthehet në një sektor mbështetës të zhvillimit të ekonomisë shqiptare dhe të rritjes së mirëqenies”.¹⁸

Në vijim, implementimi i kësaj strategjie, kërkon institucione të qëndrueshme dhe me kapacitetet e nevojshme profesionale, si dhe një kuadër ligjor që do të mundësojë përfshirjen e shpejtë të sektorit privat, qoftë ai vendas apo i huaj, duke sjellë në këtë sektor jo vetëm burime të reja investuese, por edhe një teknologji edhe më moderne dhe të përparuar.¹⁹ Megjithatë, studimi i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë vlerëson së kthimi i këtyre objektivave në punë konkrete ka qenë i vështirë dhe i vonuar pasi Shqipërisë i mungojnë burimet administrative dhe kapaciteti institucional për të dizenuar dhe vënë në zbatim këto plane. Por më shumë se kaq në Shqipëri mungon vullneti politik për zbatuar këto plane. Duke cituar një nga ekspertët e energjisë Gjergji Simakun, problemi energjistik në vend është çështje mungese politikash. Sipas tij “politikat energjitike duhet të kishin zënë vend të parat [...] përpara vetë furnizimit me energji elektrike të popullatës, kalimin e krizës, menaxhimin e krizës kur ne kemi patur çdo vit kriza”.²⁰ Qeveritë e tranzicionit, siç mund të kuptohet nga ky pasqyrim i thjeshtëzuar i sistemit energjistik në vend, kanë ndjekur politika energjitike *ad hoc* që mund të kenë menaxhuar situatën për momentin por që nuk i kanë dhënë kurrsesi zgjidhje thelbit të problemit të sistemit dhe aq më pak të adresojnë me masa konkrete dimensionin mjedisor të konceptit të sigurisë energjitike.

...në vend të konkluzionit

Nga sa u diskutua me sipër, koncepti i sigurisë energjitike është i lidhur ngushtë me faktorin e mjedisit dhe se politikat

¹⁸ Ibid f.15.

¹⁹ Ibid.

²⁰ Gjergji Simaku 2005. Auditorium : Kriza Energjitike ne Shqiperi Interviste BBC Albania http://www.bbc.co.uk/albanian/forum/2005/12/051130_audi_energycrisis_1.shtml

energjitike dhe sigurisë shpeshherë mund të kenë efekt negativ ndaj mjedisit. Konteksti i politikave energjitike në 20 vitet e fundit ka ndryshuar, ndaj për vende si Shqipëria me sistem energjistik të dobët, kërkohet një adaptim i shpejtë dhe me vizion të qartë e afatgjatë në hartimin e këtyre politikave. Analiza e tregut botëror të energjisë dhe sigurimit të saj tregon një numër të rëndësishëm faktorësh: situata energjitike në botë është e mbushur me paqartësi; faktori i mjedisit është i pandarë nga koncepti i sigurisë së furnizimit me burime; dhe se sigurimi i furnizimit me burime energjitike është një çështje që kërkon veprim kombëtar ndërinstitucional dhe gjithëpërfshirës.

Alexandra Nastase

ROLI I NJË SHOQËRIE CIVILE TË ORGANIZUAR NË TRAJTIMIN E SIGURISË MJEDISORE

Abstrakt:

Ndryshimi klimaterik është pjesë e sigurisë mjedisore dhe ai mund të kapet vetëm në nivelin global, me kontributin e çdo qytetari, qeverie, biznesi dhe shoqërie civile. Megjithatë, boshllëqet ndërmjet të gjithë këtyre aktorëve janë duke rënë si pasojë e përpjekjeve të vazhdueshme të shoqërisë civile.

Në vitet e fundit, shoqëria civile ka mbushur hapësirën midis qeverisë, biznesit dhe individëve. Për më tepër OJQ-të bashkëpunojnë ngushtësisht me organizatat ndërkombëtare si OKB, duke u përfshirë aktivisht në procesin e vendimmarrjes.

Ne ekzaminojmë rolin e shoqërisë civile në adresimin e sigurisë mjedisore dhe veçanërisht të ndryshimit klimaterik, që është shndërruar në prioritetin kryesor në axhendën ndërkombëtare politike dhe sociale. Ne do të analizojmë metodat dhe instrumentet e tij, duke nisur me kërkimin shkencor, ekspertizën dhe monitorimin e fushatave informuese si dhe lobimin dhe influencën mbi opinionin publik dhe vendimmarrësit.

Kuptimi i progresit të arritur si dhe kuptimi i rolit të shoqërisë civile në inkurajimin një përpjekje konfirmuese për zgjidhje reale mund të sigurojë një vizion të qëndrueshëm mbi atë që do të thotë realisht përgjegjësi globale.

Fjalët kyçe: *Ndryshimi klimaterik, Siguria Kombëtare, Përgjegjshmëria globale, Shoqëria civile.*

1. Hyrje

Ndryshimi klimaterik si një çështje globale

Njohja e sigurisë mjedisore si një subjekt kryesor në çështjet kombëtare dhe ndërkombëtare u zhvillua ngadalë. Në fillim të vitit 1983, shkolla e Kopenhagenit e Studimeve të Sigurisë e prezantoi sigurinë mjedisore si një nga pesë sektorët kryesorë të sigurisë kombëtare: ushtarake, ekonomike, sociale, politike dhe mjedisore. Gjithashtu, "literatura për sigurinë mjedisore ose ekologjike është përhapur që prej vitit 1987 kur Asambleja e Përgjithshme e OKB-së prezantoi për herë të parë konceptin".¹

Shqetësimet mjedisore shpesh i kalojnë kufijtë gjeografikë, duke u konsideruar si një nga çështjet më trans-nacionale në studimet e paqes, sigurisë rajonale dhe të drejtave të njeriut. Për shkak të kësaj domosdoshmërie të bashkëpunimit global, çështjet si ndryshimi klimaterik kanë zënë një vend të rëndësishëm në agjendën publike ndërkombëtare. Për shembull, aktiviteti industrial i një vendi do të influencojë në mënyrë direkte dhe të pashmangshme jo vetëm mjedisin e tij por edhe atë të vendeve të tjera.

Në nivel institucional, një moment i rëndësishëm në përpjekjet e vazhdueshme ndërkombëtare për të zvogëluar ndryshimin klimaterik ishte viti 1992 kur shtetet anëtare të OKB-së themeluan Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin Klimaterik (UNFCCC), e cila hyri në fuqi dy vjet më vonë. Ky është kuadri mbi bazën e së cilit u nënshkrua më pas edhe marrëveshja e parë ndërkombëtare ndërmjet shteteve anëtare të OKB-së në vitin 1997, Protokollin e Kyotos, dhe ky është kuadri në të cilin kanë zënë vend negociatat që atëherë.

Aktualisht, po bëhen përpjekje drejt nënshkrimit të një marrëveshje të re, por duke qenë se negociatat janë duke dështuar, duhet të gjenden zgjidhje novatore, mendje-hapura dhe efektive. Në këtë kontekst, aktorët e paanshëm duhet të ndërhyjnë dhe të ofrojnë një qasje koherente në trajtimin e këtij problemi në përfitim të individëve. Kështu që rëndësia e një shoqërie civile të organizuar- domethënë e organizatave jo-qeveritare- thekson procesin e ndërtimit të partneritetit ndërmjet qeverive kombëtare, qytetarëve dhe bizneseve të cilët janë të përfshirë në mënyrë direkte ose indirekte.

¹ Mathias Finger: *The Military, the Nation State and the environment in The Geopolitics Reader*, ed. Simon Dalby et al., London, New York: Routledge, 2001, fq 224

Me qëllim që të kuptojmë rolin e shoqërisë civile në trajtimin e ndryshimit klimaterik, ne do të fokusohemi fillimisht në identifikimin e OJQ-ve kryesore të përfshira në proces dhe praktikat e tyre më të mira. Duke mbajtur parasysh përgjegjësitë e realizuara nga këta aktorë, ne do të ekzaminojmë metodat dhe instrumentet që ata përdorin për të influencuar vendimmarrjen.

Për shkak të faktit se negociatat ndërkombëtare për marrëveshjen e ndryshimit klimaterik kanë zënë vend brenda UNFCCC, ne nuk mund të lëmë mënjanë analizën e dialogut ndërmjet OKB-së dhe OJQ-ve. Si vepruan OJQ-të gjatë samiteve ndërkombëtare? Si u prekën OJQ-të nga dështimi i negociatave?

Konkluzioni përmbledh gjetjet mbi rolin e shoqërisë civile në trajtimin e ndryshimit klimaterik, si një aspekt kryesor i sigurisë mjedisore. Gjithashtu, ai mund të çojë në një kuptim më të plotë të rëndësisë së këtij fenomeni si dhe të nevojës urgjente për një platformë komunikimi në të cilin mund të zërë vend ky dialog kompleks.

Kuadri i OKB-së dhe i OJQ-ve – Një vështrim modern në diplomaci

Kombet e Bashkuara, që prej themelimit, kanë hapur rrugën drejt bashkëpunimit dhe partneritetit me organizatat jo-qeveritare. Në një kuadër formal ose informal, OJQ-të, dhe në këtë rast veçanërisht OJQ-të mjedisore, kontribuojnë si eksperte në procesin vendimmarrës.

Procedura për frekuentimin e takimeve të OKB-së është jashtëzakonisht e thjeshtë dhe e aksesueshme për OJQ-të. Neni 7 i UNFCCC pohon se OKB mund të pranojë çdo trup ose agjenci, qoftë kjo kombëtare ose ndërkombëtare, qeveritare ose jo-qeveritare, “që është e kualifikuar në çështjet që mbulon Konventa, dhe e cila ka vënë në dijeni sekretariatit për dëshirën e saj për të qenë e pranishme në një seancë të konferencës së pjesëmarrësve si vëzhguese, sa kohë që një e treta e pjesëmarrësve nuk kundërshton.”²

Brenda UNFCCC, OJQ-të janë përgjegjëse për kuptimin e problemit përmes kërkimit shkencor, studimeve, dhe raporteve si dhe përmes ofrimit të zgjidhjeve dhe kjo procedurë ka pa dyshim arsye teknike, sociale dhe politike që janë veçanërisht

² Kombet e Bashkuara (OKB): *The United Nations Framework Convention on Climate Change (Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin Klimatik)*, 1992, fq. 10, aksesuar më: 24 Shkurt 2011, <http://unfccc.int/resource/docs/convkp/conveng.pdf>

karakteristikë e diplomacisë së shekullit të njëzet e një. Procesi i vendimmarrjes është më tepër transparent dhe individët, shoqëria civile dhe bizneset luajnë një rol për sa i takon të ardhmes së këtij planeti. Ky proces i ndarjes së përgjegjësive përfshin ndarjen e të drejtave për të vepruar në interes të një vizioni afat-gjatë.

Sipas manualit të ligjit ndërkombëtar, diplomacia e shumë-anshme është “një sistem i hapur i organeve, i përbërë nga shumë shtete të cilat veprojnë në arenën ndërkombëtare.” (Bonciog, 2000) Ky ekuacion nuk merr parasysh disa variabla si ndërhyrjen e OJQ-ve ose të bizneseve. Nëse teoria lejon qasjen tradicionale, praktika e diplomacisë moderne tregon se ne nuk mund t’i injorojmë më këta aktorë kryesorë.

Bizneset që punojnë afër me organizatat ndërkombëtare shpesh shihen me skepticizëm. Përgjithësisht, njerëzit konsiderojnë se lobimi i realizuar nga kompanitë është në shumicën e rasteve në dëm të konsumatorit, në ndjekje të synimit unik: maksimizimin e përfitimit dhe në një mënyrë unike: mitmarrjen. Në këtë artikull, ne jemi të interesuar veçanërisht për perceptimin publik në të cilin vërehet se ekziston mungesa e besimit.

Megjithatë, kompanitë luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e ndryshimit klimaterik. Prandaj mund të flasim për tre tipe të ndryshme kompanish.

Së pari, kemi kompanitë tradicionale që luftojnë papërgjegjshmërisht për të ruajtur gjendjen aktuale, duke mos konsideruar pasojat e ndryshimit klimaterik, për hir të përfitimit. Përmes lobimit, ato bëhen partnerë për hir të fuqisë më të madhe të influencës. Është i ashtuquajtur *lobimi i papastër*, si rreziqet që përfshijnë marrjen e burimeve të jashtme të karbonit për vende ose fusha që kanë një legjislacion lejues ose ndalimi i aktivitetit në disa vende, që do të prekë direkt ekonominë, veçanërisht tregun e punës.

Së dyti, ekzistojnë kompani që mbështesin zhvillimin dhe kalimin drejt standardeve dhe objektivave të reja globale. Ky komunitet nuk është as i dukshëm dhe as influencues, por OJQ-të po punojnë drejt tërheqjes së sa më shumë kompanive drejtuese në këtë drejtim me qëllim që të dërgohet një mesazh i qartë, më bindës për publikun dhe qeverinë, si një koalicion për marrëveshjen e ndryshimit klimaterik. Mbështetësit e zjarrtë të këtij objekti janë qeveritë e Greqisë, Suedisë, Mbretërisë së Bashkuar, Danimarkës, Spanjës, Portugalisë dhe Gjermanisë si dhe lista e kompanive të tjera po rritet në mënyrë optimiste.

Kategoria e tretë i përket kompanive të parëndësishme, të pavendosura të cilat nuk janë përfshirë së fundmi në debatet

publike mbi ndryshimin klimaterik dhe përshtatjen e strategjive. Gjithashtu, ato mund të binden më lehtësisht në mbështetjen e kauzës së OJQ-ve.

Në anën tjetër, OJQ-të, në këtë rast OJQ-të mjedisore kanë fituar mbështetjen e opinionit publik dhe besueshmërinë e nevojshme si dhe legjitimitetin për arritjen e suksesit në influencimin e vendimeve. Në 2010, pothuajse 2000 OJQ morën pjesë në Samitin e Kankunit (Meksikë), duke përfaqësuar të gjithë kontinentet dhe interesat e ndryshme: biznesin dhe industrinë, gratë dhe gjininë, OJQ-të e reja, qeveritë lokale dhe autoritetet bashkiake të cilat u përfshinë të gjitha në takim si konsultuese ose si lobuese. Kështu që, dokumentet zyrtare konfirmojnë se deklaratat u bënë në emër të gjithë këtyre aktorëve.³

Kjo ngjarje është e rëndësishme sepse i referohet një tjetër fytyrë të çështjeve të diplomacisë moderne në të cilën inkurajohen metoda novatore dhe pjesëmarrëse pavarësisht rregullimeve të ligjit ndërkombëtar që pohon se deklaratat mund të bëhen vetëm nga shtetet pjesëmarrëse në një konferencë ndërkombëtare.⁴

Një mundësi – Përfshirja e NATO-s në çështjet mjedisore ndërkombëtare

Pavarësisht traditës së saj të të vepruarit si një strukturë për marrëveshjet ndërkombëtare përmes UNFCCC dhe të trajtuarit të ndërhyrjes humanitare, Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saj nuk janë të përgatitura për të zbatuar programet që do të kishin një ndikim në reduktimin domethënës të pasojave direkte të ndryshimit klimaterik.

OKB-ja nuk e ka kapacitetin, njohurinë, kompetencat dhe gjithashtu ka humbur besueshmërinë e saj nga qeveritë, bizneset dhe OJQ-të, madje edhe individët kur bëhet fjalë për t'u marrë me ndryshimin klimaterik.

Në vitin 2010, NATO miratoi konceptin e ri strategjik dhe promovoi një këndvështrim më të freskuar dhe më gjithëpërfshirës mbi sigurinë e përbashkët ndërkombëtare. Mjedisi, shfaqet si një nga parimet kryesore sa kohë që "kufizimet kryesore mjedisore

³ Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin Klimatik: *Report of the Ad Hoc Working Group on Long-term Cooperative Action under the Convention (Raporti i Grupit të Punës Ad Hoc mbi veprimin e bashkëpunues afat-gjatë nën këtë Konventë, në seancën e 13-të, mbajtur në Kankun 29 Nëntor – 10 Dhjetor 2010, fq 4*, aksesuar më: 26 Shkurt 2011, <http://unfccc.int/resource/docs/2010/awglca13/eng/18.pdf>

⁴ Aurel Bonciog: *International Law (Ligji Ndërkombëtar)*, Bucharest : Romania de Maine, 1996

dhe burimore, duke përfshirë rreziqet e shëndetit, ndryshimit klimaterik, pamjaftueshmërinë e ujit dhe nevojave në rritje për energji do të formësojnë sigurinë mjedisore në të ardhmen në fusha të interesit të NATO-s si dhe do të kenë potencialin për të prekur në mënyrë domethënëse NATO-n.”⁵ Në këtë kontekst, NATO plotëson përpjekjet e OKB-së për të siguruar programe efçente për asistencë ndërkombëtare.

NATO shpjegoi përfshirjen e saj në procesin e zbutjes së ndikimit të ndryshimit klimaterik përmes faktit se “asnjë qeveri nuk mund të përballë vetme me ndryshimin klimaterik, ne duhet të synojmë për një cilësi të re të qeverisjes globale duke i hedhur një sy të shpejtë institucioneve tona.”⁶

Strategjia e NATO-s nuk është zhvilluar ende plotësisht, por funksionimi, përshtatja dhe konsultimi janë përcaktuar si veprimet më të rëndësishme.

Si ekspert në ndërhyrjen dhe trajnimin, NATO mund të përgatisë dhe të koordinojë operacione në këtë fushë dhe ne duhet ta njohim ushtrinë si përgjigjen e parë në raste të shkatërrimeve natyrore, që mund të thirret për të trajtuar në mënyrë direkte pasojat e ndryshimit klimaterik. Përshtatja është një masë e brendshme që synon të reduktojë gjurmën e forcave të NATO-s dhe konsultimet i referohen një bashkëpunimi më të fuqishëm dhe një dialogu të hapur ndërmjet institucioneve, organizatave jo-qeveritare dhe komunitetit të shkencëtarëve.

Në një këndvështrim afatgjatë, rëndësia e kësaj diplomacie dhe koalicioni transparent të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë ka kuptim vetëm nëse e shohim atë nga një perspektivë logjike dhe gjithëpërfshirëse: “Nëse ne duam një botë të sigurt, ekziston një luftë që duhet ta shmangim: lufta me planetin. Paqja dhe siguria: ky është misioni ynë.”⁷

Angazhimi i NATO-s ndaj çështjeve mjedisore përsërit perspektivën e përgjegjshmërisë qendrore globale dhe rrit besueshmërinë në efektshmërinë e një marrëveshje globale mbi ndryshimin klimaterik. Fakti i vetëm që NATO që perceptohet si një nga organizatat ndërkombëtare më të fuqishme dhe më me influencë, plotëson përpjekjet e bëra

⁵ NATO: *Strategic Concept for the Defence and Security of the Members of North Atlantic Treaty Organization. Adopted by Heads of State and Government in Lisbon: Active Engagement, Modern Defence*, 2010, fq. 11

⁶ Anders Fogh Rasmussen: *NATO and Climate Change*, (*NATO dhe Ndryshimi Klimatik*) Huffington Post, 15 Dhjetor 2009, aksesuar më: 15 Mars 2011, http://www.huffingtonpost.com/anders-fogh-rasmussen/nato-and-climate-change_b_392409.html,

⁷ NATO Climate Change- Copenhagen Spot, 2009

nga OKB, e cila e ka humbur besueshmërinë e saj në vitet e fundit, krijon një imazh më të mirë për çështjen në fjalë.

Identifikimi i aktorëve kryesorë, metodave dhe instrumenteve të tyre.

Organizatat jo-qeveritare janë përfshirë në mënyrë aktive në proceset lehtësuese qoftë në mënyrë individuale ose si pjesë përbërëse e koalicioneve të ndryshme.

Koalicionet janë formuar në raste të veçanta si për të prezantuar dhe për të mbështetur një pozicion të përbashkët në negociatat ndërkombëtare si edhe për të informuar grupet e interesit për sa i takon gjetjeve shkencore.

Koalicioni i Shoqërisë Civile mbi Ndryshimin Klimaterik prezantoi një raport të vitit 2007 – Raporti i Shoqërisë Civile mbi Ndryshimin Klimaterik i cili theksonte përkeqësimet e ndryshimeve klimaterike, mbi të cilat ata deklarojnë se mund të krijojë panik tek qytetarët dhe qeveritë.

Duke përfshirë gjashtëdhjetë organizata jo-qeveritare nga dyzetë vende, Koalicioni i Shoqërisë Civile thekson rëndësinë e të dhënave aktuale dhe relevante mbi ndryshimin klimaterik, sepse “kërcënimi është krijuar përmes reklamimit të zgjuar nga grupet mjedisore, po ashtu edhe nga gazetarët që e dinë se lajmet e këqija shiten. Shkencëtarët po kërkojnë fonde për kërkimet e tyre shkencore – dhe po vuajnë ndoshta nga paragjykimet ideologjike – edhe pse kanë qenë konspiratorët e lumtur duke shkruar artikuj dhe u shfaqur në media.”⁸

Duke qenë më tepër të interesuar në kërkimin shkencor dhe garantimin e zgjidhjeve relevante për situatën reale me të cilën po përballemi, ky koalicion ka rritur ndërgjegjësimin për informacionin e paragjykuar që qarkullon në media. Qëllimi i tij është të edukojë opinionin publik në lidhje me shqetësimin e ndryshimit klimaterik pavarësisht interesit politik dhe pavarësisht fushatave keq-informuese.

Organizatat partnere veprojnë kryesisht në mënyrë të pavarur, duke u përpjekur që të jenë aktorë të hapur në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Megjithatë, kur bëhet fjalë për samite si ai i Kankunit ata koordinojnë së bashku përpjekjet e tyre.

⁸ Koalicioni i Shoqërisë Civile mbi Ndryshimin Klimatik: *Civil Society Report on Climate Change*, London, 2007, fq. 1, aksesuar më 1 Mars 2011, http://www.cscoc.info/reports/report_20.pdf

Në samitin e Kankunit, mesa duket koalicioni më tepër influencues ishte Koalicioni i Ndryshimit Klimaterik (Koalicioni Klima).

Koalicioni Klimaterik përbëhet nga njëzetë e katër OJQ aktive, unione, qendra të kërkimit shkencor dhe grupe konsumatorësh dhe synon të krijojë një strukturë në të cilin qeveritë, kompanitë dhe individët mund të veprojnë për të kufizuar ngrohjen globale. Ky koalicion njihet ndryshe edhe si *Koalicioni Klima* duke qenë se ai ndodhet në Spanjë, anëtarët e kësaj lëvizje janë opinion bërës mbi ndryshimin klimaterik si: GreenPeace, WWF, Friends of the Earth dhe Oxfam janë vetëm më të dallueshmit. Linja e veprimit është e gjerë dhe i referohet politikave dhe praktikave në ndryshim si dhe ideve, qëndrimeve dhe sjelljeve ndikuese.

Metodat e përdorura nga ky koalicion janë mobilizimi social dhe presioni politik. Ai plotëson hapësirën midis interesave të individit (dhe në të njëjtën kohë të konsumatorit) dhe përfaqësuesve të komunitetit të kërkuesve shkencorë, të cilët punojnë së bashku për të ndikuar qeveritë.

Megjithëse rezultatet e samiteve ndërkombëtare për ndryshimin klimaterik ishin zhgënjyese, kapaciteti që tregoi shoqëria civile duke u përgjigjur shpejt u përdor në një mënyrë të zgjuar në avantazhin e tyre. OJQ-të duke vepruar si opinion-bërëse shpallën pozicionin e tyre: “Si do të shënohen në histori bisedimet klimaterike të Kopenhagenit? Vonesë, jo urgjencë. Qëndrim, jo lëshim. Dështim i pafalshëm dhe së fundi jo çështje me rëndësi.”⁹ Gjithashtu, pas Kopenhagenit, qeveritë erdhën në Kankun të shqetësuara dhe duke u përballur me presionin publik për të vepruar mbi ndryshimin klimaterik. U shpresua se Kankuni do të themelonte një platformë për progres dhe tanimë shtetet kanë një sens të ripërtërirë të vullnetit të mirë si dhe sensin e vendosmërisë.¹⁰

Përballë këtij pozicioni disavantazhues, OJQ-të nuk heqin asnjëherë dorë dhe përshtatën në mënyrë të vazhdueshme strategjitë e tyre. Shoqëria civile e organizuar ndërkombëtarisht po përgatit aktualisht pozicionin e saj për samitin e ardhshëm që do të zërë ven në Durban, Afrikë të Jugut në fund të vitit

⁹ Oxfam International: Oxfam's verdict- The Copenhagen climate change summit 2009, aksesuar më 17 Mars 2011, http://www.oxfam.org.uk/get_involved/campaign/climate_change/copenhagen.html

¹⁰ United Nations Non-Governmental Liaison Service: *Civil Society's response to the Cancun Agreements*, aksesuar më 27 Shkurt 2011, http://www.un-ngls.org/spip.php?page=article_s&id_article=3176

2011. Ata kanë besimin se kjo përpjekje do të çojë në krijimin e një marrëveshje ndërkombëtare. Kështu që, aktori kryesor është **Fushata Globale për Veprimin Klimaterik (GCCA)** që është një koalicion global me bazë në Montreal. Ai përfshin zhvillimet kryesore dhe organizatat jo-qeveritare mjedisore si Unioni i Shkencëtarëve, Froni i Grupit Ambientalist, Oxfam International, Greenpeace International, World Wildlife Fund, 350, Avaaz.

Disa nga organizatat që zakonisht janë pjesë e axhendës publike dhe që kanë sukses në prodhimin e lajmeve dhe në informimin efikas të opinionit publik janë Greenpeace, World Wildlife Fund ose Oxfam International. Kështu që këto organizata janë vështruar si *influentesit kryesorë*, prandaj dhe inventari i aktiviteteve të tyre duhet të jetë relevantë për të kuptuar rolin e tyre.

Greenpeace, një organizatë ndërkombëtare jo-qeveritare e pranishme në më tepër se 30 vende në të gjithë botën, është një lider i pakundërshtueshëm i shoqërisë civile për çështjet mjedisore. Projektet e saj kryesore mbi ndryshimin klimaterik janë: *(R)evolucioni i Energjisë*, i cili siguron një vizion dhe zgjidhje praktike mbi mënyrën e realizimit të kalimit drejt energjisë së rinovueshme dhe energjisë eficiente, *Cool IT*, mbi mënyrën sesi kompanitë e IT mund të përshtaten për të reduktuar gjurmën e karbonit dhe mbi mënyrën sesi ato mund të influencojnë vendimin final politik dhe programet e ndryshme kërkimore që rezultojnë në raporte klimaterike – prova shkencore mbi të cilat bazohen kërkesat.

Mbi të gjitha, Greenpeace kontribuon në zbehjen e ndryshimit klimaterik përmes kërkimit shkencor, ekspertizës dhe sigurimit të zgjidhjeve reale, eficiente, por edhe përmes krijimit të një platforme për bashkëpunim midis vendimmarrësve politikë (qeverive) dhe vendimmarrësve ekonomikë (kompanive).

Përveç lobimit, advokimit, sigurimit të zgjidhjeve dhe propozimit të politikave, **World Wildlife Fund** është duke punuar mbi fushata informuese në mënyrë që të përfshijë njerëzit në procesin e zbehjes së ndikimit të ndryshimit klimaterik, për të bindur liderët dhe për të formësuar politikën. Në partneritetin e saj strategjik dhe afat-gjatë me kompanitë, WWF synon të reduktojë kostot, të përgatisë për legjislacionin e ri dhe të eksplorojë mundësitë dhe tregjet e biznesit. Për momentin, në këtë program janë përfshirë agjentët ekonomik trans-nacionalë, Johnson & Johnson ose Sawaga Ekspres.

Gjithashtu, WWF po përfshihet gjithnjë e më tepër në punën organizuese dhe implementuese që ajo realizon në drejtim të përfitimit të specieve, habitatit dhe individëve.

Oxfam International është i fokusuar veçanërisht në dy drejtime: krijimin e presionit politik përmes aktivizimit, lobimit, peticioneve, duke bërë të mundur që individët të mbrojnë kauzën e tyre si dhe që të sigurojnë zgjidhje novatore përmes Seancave Dëgjimore për çështjet Klimatike ose Gjykimeve gjyqësore.

Gjykimet gjyqësore janë ngjarje që ofrojnë një platformë për shprehjen e lirë të njerëzve të cilët kanë vuajtur në mënyrë direkte nga pasojat e ndryshimit klimaterik. Këta njerëz, që vijnë nga vendet e varfra, kanë historitë e tyre reale dhe prekëse që mund t'i nxisin njerëzit e tjerë në të gjithë botën të bëhen më të përgjegjshëm.

Gjithashtu, në Tajlandë, Oxfam International është fokusuar mbi komunitetet e fermerëve të orizit dhe është duke përdorur teknikat novatore të fermave. Kjo ofron një burim domethënës të të ardhurave për shumë familje nga këto komunitete.

Ashtu siç edhe e kemi vërejtur, organizatat jo-qeveritare ndërmarrin role serioze, përplotësuese ose të veçanta, në varësi të qëllimit të tyre kryesor në një fushatë ose në një tjetër. Për një vizion më të gjerë, ne mund të rendisim OJQ-të që veprojnë për kuptimin e problemit, rritjen e ndërgjegjësimit, gjetjen e zgjidhjeve, mbushjen e hapësirave për garantimin e përgjegjshmërisë globale, duke ngritur zërin e tyre dhe duke vepruar për ndryshim.

Kuptimi i problemit

Ndikimi më i mirë që mund të kenë organizatat jo-qeveritare është përmes pushtetit të tyre të kualifikuar dhe përmes kapacitetit të tyre për të përkthyer një gjetje shkencore në terma të thjeshta në mënyrë të tillë që të kuptohet nga kushdo që është i interesuar për çështjen në fjalë. Kështu, OJQ-të ndihmojnë individët, kompanitë dhe qeveritë të kuptojnë shkaqet dhe pasojat e ndryshimit klimaterik. Ato ndërmarrin projekte të bazuara në kërkimin shkencor të cilat sjellin si rezultate studime, raporte, analiza dhe ekspertizë.

Rritja e ndërgjegjësimit

Shoqëria civile e organizuar është duke rritur ndërgjegjësimin edhe mbi çështje kritike dhe situata që duhet të ndryshojnë ose mundësi nga të cilat duhet përfituar. Kur ato identifikojnë një problem me një ndikim të mundshëm negativ mbi shoqërinë, ato e bëjnë atë publike dhe përpiqen ta zgjidhin atë ose pozicionohen

në drejtim të zgjidhjes së tij. Në të njëjtën kohë, energjia e rinovueshme është një shembull i mirë i asaj që domethënë mundësi e ndërgjegjësimit. Për shembull, Greenpeace, ka theksuar se adaptimi i energjisë së rinovueshme është një qasje e qëndrueshme e orientuar drejt së ardhmes. Qeveritë kanë filluar të kuptojnë se ekziston një prirje gjithnjë e në rritje në zëvendësimin e metodave tradicionale të prodhimit të energjisë.

Ofrimi i zgjidhjeve

Kërkimi shkencor dhe ekspertiza çojnë në ofrimin e zgjidhjeve për autoritetet qeveritare përmes zhvillimit të rekomandimeve të politikave, pjesëmarrjes në konsultime me qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare: si OKB-në ashtu edhe NATO-n.

Mbushja e hapësirave për përgjegjshmërinë globale

Pas dështimit të samitit të Kopenhagenit, si qeveritë ashtu edhe OKB e kuptuan rëndësinë e një koalicioni më të fortë midis aktorëve të ndryshëm pavarësisht qëllimit dhe aktivitetit të tyre individual. Ndarja e detyrimeve përfshin angazhimin drejt përgjegjshmërisë së përbashkët.

Negociatat për ndryshimin klimaterik kanë hapur një kapitull të ri për diplomacinë moderne, prandaj ekziston një nevojë urgjente për krijimin e një platforme mbi të cilën qeveritë, shoqëria civile dhe kompanitë mund të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë në një mënyrë të lirshme. OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm duke qenë se ato janë një lidhje e rëndësishme midis kompanive dhe qeverive, veçanërisht gjatë zhvillimit të samiteve.

Për më tepër, ashtu siç kemi parë edhe në përshkrimin e shkurtër të Greenpeace dhe WWF, programe shumë të dobishme ishin ato të cilat ishin të drejtuara veçanërisht tek kompanitë, që mund të përshtaten si projekte të Përgjegjësisë së Përbashkët Sociale.

Ofrimi i një Zëri

Organizatrat jo-qeveritare kanë pushtet legjitim vetëm nëse ato përfaqësojnë interesin e qytetarëve. Kështu që pushteti i influencës së qytetarëve mund të matet veçanërisht përmes peticioneve.

Disa OJQ ndalojnë këtu, disa të tjera shkojnë më tej dhe zbatojnë zgjidhjet dhe **veprojnë për ndryshim**. Duke kërkuar zgjidhje novatore për problemet e reja ose ato tradicionale, OJQ-të veprojnë dhe përpiqen për të revolucionarizuar procesin. OJQ-të më efikase dhe të besueshme janë ato që veprojnë në baza lokale, duke propozuar përshtatjen e politikave dhe përmes përqendrimit të pushtetit vendor veprojnë për të zgjidhur një problem të komunitetit.




Fig 1. Roli i shoqërisë civile në trajtimin e ndryshimit klimaterik

Konkluzione

Roli i veçantë që kanë ndërmarrë OJQ-të në procesin e gjatë të adresimit të problematikës së ndryshimit klimaterik është ai i *ndërlidhësit*. Ato kanë krijuar partneritete duke bashkuar grupet e interesit, veçanërisht qytetarët me qeveritë kombëtare dhe qendrat shkencore, kompanitë me autoritetet kombëtare.

OJQ-të realizojnë lidhjen e qendrave shkencore dhe qytetarëve duke bërë përpjekje në shpërndarjen e informacioneve relevante për publikun e gjerë, duke marrë vendimet e duhura dhe duke kuptuar rolin e tyre në zbehjen e procesit të ndryshimit klimaterik.

Gjithashtu, OJQ-të realizojnë lidhjen mes qeverive kombëtare dhe kompanive. Ekzistojnë disa biznese të ndjeshme ndaj mjedisit që mbështesin projektet e shoqërisë civile, dhe OJQ-të përfitojnë nga këto partneritete në mënyrë që të influencojnë vendimmarrësit.

Për më tepër ne duhet të theksojmë ndikimin pozitiv që pati në perceptimin publik miratimi i konceptit të ri strategjik të NATO-s, i cili përfshinte edhe çështjet e sigurisë mjedisore. NATO dhe OKB duke punuar së bashku në çështjet mjedisore kanë rritur besueshmërinë në luftën e përbashkët kundër ndryshimit klimaterik. Debatet e shumëfishta dhe informacioni shkencor kontradiktor të zhvilluara në një gjuhë të paarritshme nga qytetarët kanë rezultuar në fushata jo-informuese që kanë turbulluar qytetarët e të gjithë botës.

Negociatat e ndryshimit klimatik kanë hapur një kapitull të ri në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Diplomacia multilaterale përfshin dhe i jep një rëndësi kryesore aktorëve jo-qeveritarë, negociatat janë transparente dhe samitet janë duke u përpjekur gjerësisht në përfshirjen e të gjithë aktorëve. Për rrjedhojë, është krijuar një imazhi i një rryme të pashembullt të diplomacisë moderne, e nxitur veçanërisht nga rëndësia e samiteve të tilla globale të ndryshimit klimaterik.

Artikulli mund të vazhdojë me një analizë të të gjitha takimeve dhe negociatave deri më sot, deri kur një traktat i ri global do të nënshkruhet, duke rregulluar kësaj veprimi ndërkombëtar në sektorin e ndryshimit klimaterik. Gjithashtu, një retrospektivë e evoluimit të negociatave do të ofronte një retrospektivë të evoluimit të shoqërisë ndërkombëtare dhe çështjeve trans-nacionale të ndërthurura së bashku.

Bibliografia

Anders Fogh Rasmussen: *NATO and Climate Change*, Huffington Post, 15 Dhjetor 2009, aksesuar më: 15 Mars 2011, http://www.huffingtonpost.com/anders-fogh-rasmussen/nato-and-climate-change_b_392409.html,

American Institute for Contemporary German Studies. The Johns Hopkins University: *Environmental diplomacy. Conference Reports*, Washington, D.C., 18 Nëntor 1998

Aurel Bonciog: *International Law*, Bucharest : Romania de Maine, 1996

Berton Bolin: *A history of science and politics of climate change. The role of the intergovernmental panel on climate change*, Cambridge University Press, Cambridge, 2007

Civil Society Coalition on climate change: *Civil Society Report on Climate Change*, London, 2007, aksesuar më 1 Mars 2011, http://www.cscoc.info/reports/report_20.pdf

Climate Action Network International: *Cancun - Building Blocks. Essential Steps on the road to a fair, ambitious and binding deal*, Tetor 2010, aksesuar më: 16 Shkurt 2011 http://www.climate-network.org/sites/default/files/CAN_cancun_building_blocks_october2010_1.pdf

Climate Coalition- *24 social and environmental organizations join efforts to fight climate change*, aksesuar më: 14 Shkurt 2011, <http://cc2010.mx/assets/001/5230.pdf>

Marlies Glasius, Mary Kaldor and Helmut Anheier: *Global Civil Society 2005/6*, Sage Publications, 2006

Michele Betsill and Elisabeth Corell: *NGO Influence in International Environmental Negotiations: A Framework for Analysis, Global Environmental Politics*, 14 Nëntor 2001, aksesuar më: 14 Shkurt 2011,

<http://www.polisci.colostate.edu/fac/mb/NGO%20Influence.pdf>

NATO: *Strategic Concept for the Defence and Security of the Members of North Atlantic Treaty Organization. Adopted by Heads of State and Government in Lisbon: Active Engagement, Modern Defence*, 2010

Security and Climate CAN Corporation: *National security and the threat of climate change*, Virginia, 2007

Simon Dalby, Paul Routledge and Gearoid O'Thuatail: *The Geopolitics Reader*, London, New York: Routledge, 2001

Sustainable Development Foundation, A.C.: *The role of organized civil-society in modern diplomacy*, aksesuar më: 14 Shkurt 2011, <http://cc2010.mx/assets/001/5235.pdf>

UN Framework Convention on Climate Change: *Report of the Ad Hoc Working Group on Long-term Cooperative Action under the Convention on its thirteen session held in Cancun from 29 November to 10 December, 2010, p 4*, (*Raporti i Grupit të Punës Ad Hoc mbi veprimin e bashkëpunues afat-gjatë nën këtë Konventë, në seancën e 13-të, mbajtur në Kankun 29 Nëntor – 10 Dhjetor 2010*), aksesuar më: 26 Shkurt 2011, <http://unfccc.int/resource/docs/2010/awgla13/eng/18.pdf>

United Nations Non-Governmental Liaison Service: *Civil Society's response to the Cancun Agreements*, aksesuar më 27 Shkurt 2011, http://www.un-ngls.org/spip.php?page=article_s&id_article=3176

Walter Led Filho: *The Economic, Social, Political Elements of climate change*, Springer-Verlag Berlin Heidelberg, 2011

Alizadeh, E¹ dhe Pishgahi, Fard, Z²

POZICIONIMI I RREZIQEVE MJEDISORE NË KRIJIMIN E MODELEVE TË NDRYSHME TË INTEGRIMIT RAJONAL

Përmbledhje

Pas Luftës së Ftohtë koncepti i sigurisë ndërkombëtare i është nënshtruar modifikimit. Një ndër komponentët më të rëndësishëm të këtij transformimi, konsolidimi i “sigurisë mjedisore” një çështje në sigurinë ndërkombëtare, duhet të merret gjithashtu parasysh. Siguria e mjedisit merret me rreziqe që janë jo vetëm rezultatet e pa-qëllimshme të aktiviteteve ekonomike dhe shoqërore por që janë të ngadalta krahasuar me rreziqet ushtarake dhe si rrjedhojë hapësirat kohore për planifikimet e nevojshme politike për t’u përballur me to janë dukshëm më të gjera. Ky artikull gjithashtu rishikon statusin dhe rolin rreziqeve mjedisore në krijimin e integritetit rajonal duke përdorur metodën e analizave përmbajtësore dhe duke i vëzhguar ato. Rezultatet tregojnë se 33/4% e integritetit rajonal është krijuar si rrjedhojë e variablave jo-gjeografike dhe se rreziqet mjedisore ende nuk luajnë ndonjë rol në organizatat të tilla.

Termet kryesorë: siguria ndërkombëtare, siguria mjedisore, integriteti rajonal, mjedis i qëndrueshëm, Lufta e Ftohtë.

Hyrje

Shqetësimet rreth shkatërrimit të mjedisit dhe konflikteve shoqërore si shkak i ndryshimeve klimaterike i janë shtuar debatit aktual rreth sigurisë së planetit, militarizmit dhe sundimit mbi Tokë. Rreziku për konflikte ndërkombëtare së bashku me shtimin e presioneve dhe skarcitetit të burimeve mjedisore do të rritet

¹ Departamenti i Gjeografisë politike, Shkencës dhe Kërkimit, Universiteti Islamik Azad (IAU), Teheran , Iran

² Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Teheranit, Teheran, Iran

dhe do të de-stabilizojë qeveritë më shumë se kurrë (Homer, 1990). Literatura që lidhet me sigurinë mjedisore ose ekologjike është zgjeruar që prej vitit 1987 kur Kombet e Bashkuara prezantuan për herë të parë këtë koncept (Kakonen, 1990). Shqetësimet rreth çështjeve të politikës ndërkombëtare mjedisore u ngritën në Konferencën e Kombeve të Bashkuara të titulluar “Mjedisi dhe Zhvillimi” në takimin e Rio-s në vitin 1992 ku më se qindra organizata jo-qeveritare (OJQ) si dhe qindra qeveri dhe udhëheqësit e tyre u bashkuan për të luftuar rreziqet e ekologjisë globale. Shqetësimet rreth çështjeve mjedisore kanë një histori të gjatë duke qenë se rritja e industrializimit urban dhe e zhvillimit ka sjellë perspektiva të reja rreth tokës si një shënues në jetë (Dads, 2000). Shumë studiues që shqetësohen për probleme të tilla mjedisore, besojnë se shkatërrimi i Ozonit, ndryshimet klimaterike dhe erozioni mjedisor do të sjellin një trazirë politike në botë sepse shumica e këtyre çështjeve shkojnë përtej kufijve dhe nuk janë përgjegjësi e vetëm një qeverie (Shafer, 1998). Disa shkencëtarë nuk besojnë se ndryshimet dhe shkatërrimi mjedisor mund të shkaktojë konflikte ndërkombëtare. Më tej disa të tjerë, duke kritikuar Konferencën e Rio-s theksojnë se principet bazë që fokusohen tek një mjedis i qëndrueshëm janë paracaktuar prej vendeve Nordike dhe kompanive shumëkombëshe ndërkombëtare (Doyle, 1998).

Jetesa e shëndetshme e qenieve njerëzore varet nga aftësia e qeverive për të bashkëpunuar në luftën kundër ndotjes së mjedisit dhe nga pranimi i varësisë së fatit të ekologjisë lokale në sistemet e prodhimit mbi-kombëtare. Teoricienët që punojnë mbi globalizimin si dhe studiuesit që merren me çështje të Botës së Tretë këmbëngulin se problemet mjedisore janë bërë pjesë e pandashme e shqetësimeve për zonat e goditura nga varfëria, konsumin, zhvillimin dhe marrëdhëniet ndërmjet Veriut dhe Jugut (Mittleman, 1996).

Në raportin e publikuar prej Kombeve të Bashkuara në vitin 1998 mbi zhvillimin njerëzor, është përmendur se vendet e varfra kanë thithur 1.1% të të ardhurave botërore edhe pse ato përbëjnë vetëm 20% të popullsisë botërore. Ndërsa vendet veriore shqetësohen për ndryshimet në shtresën e ozonit, vendet jugore shqetësohen për popullsinë e tyre në rritje, mungesën e burimeve, nevojat njerëzore dhe për rritjen e varfërisë. Prandaj është e nevojshme që gjatë përcaktimit të çështjeve mjedisore të klasifikohen analizat dhe politikat e ndërmarra (Lipschultz, 2000).

Ernst Haas, themeluesi i teorisë së integritimit përkufizon sistemin rajonal në këtë mënyrë: *“një proces ku udhëheqësit*

politikë të disa vendeve janë të bindur dhe kanë vullnetin për të drejtuar besnikërinë, pritshmëritë dhe aktivitetet e tyre politike drejt një qendre të re, simbolet e së cilës kanë autoritet ligjor, ose e cila kërkon ushtrimin e këtij autoriteti, si dhe pikëpamjet përfaqësuese të njerëzve dhe kombeve.” Gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, bota ishte dëshmitare e formimit të shumë sistemeve të ndryshme rajonale të cilat kanë dhënë stabilitet politik dhe ekonomik në rajon si dhe kanë rritur balancën ndërmjet dy superfuqive pas Luftës së Ftohtë. Pra, vendet u detyruan të punonin së bashku për lumturinë dhe prosperitetin e tyre, si rrjedhojë, ky bashkëpunim zëvendësoi perandoritë e së shkuarës (Fellmann, 2001).

Artikujt 52, 53 dhe 54 të Kartës së OKB-së kanë pranuar sistemet rajonale dhe kanë ftuar shtetet që të formojnë sisteme rajonale për të nxitur paqen dhe sigurinë. Në prag të shekullit të 21-të, procesi i globalizimit është bërë kryesor dhe duket se fillimi i këtij shekulli po shënon një erë të re të ndërveprimit ekonomik ndërmjet kombeve. Brenda globalizimit po zhvillohet gjithashtu edhe një proces konvergjence që përfshin:

1) integrimin ekonomik nëpërmjet tregtisë, investimeve dhe lëvizjes së kapitalit;

2) konvergjencën e çështjeve politike;

3) teknologjinë e informacionit dhe informacionin, dhe

4) konvergjencën e mjediseve kulturore në këtë kategori.

Një situatë e tillë do të çojë drejt një lloji imperializmi mjedisor nëpërmjet të cilit vendet veriore kërkojnë të imponojnë kërkesat e tyre mbi vendet e jugut për të reformuar programet që ato po zhvillojnë ndërsa nga ana tjetër refuzojnë që të falin borxhet e këtyre të fundit dhe të transferojnë teknologji të re drejt tyre (Shiva, 1993).

Procesi i globalizimit, duke qenë se përfshin dimensione të ndryshme, do të shënojë ndikimet e tij në të gjitha fushat. Sfera e autoritetit të qeverive lokale po ulet në të gjithë botën dhe çështje të ndryshme po lëvizin drejt nivelit ndërkombëtar dhe prandaj duhet të administrohen domosdoshmërisht prej organizatave ndërkombëtare (Falk, 1995). Për shembull, zhvillimi njerëzor prek mjedisin ose zhvillimi i tregtisë ndikon investimet dhe qarkullimin e kapitalit. Qarkullimi ditur prej 30 miliardë dollarësh drejt investitorëve ka ndryshuar konceptin e kufijve. Globalizimi ndikon zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin edhe lidhje me ekonominë në dimensione të ndryshme. Globalizimi ndikon mbi trendin e rritjes ekonomike dhe në mënyrë të ngjashme edhe mjedisin. Efekte të tilla janë të favorshme në disa raste por të pa dëshirueshme në disa të tjera.

Globalizimi do të shpejtojë ndryshimet strukturore dhe do të transformojë strukturën e shteteve; si rrjedhojë, konsumimi i resurseve dhe nivelet e ndotjes do të rriten. Globalizimi mund të shkaktojë zhvillimin e teknologjisë dhe të investimeve por efekti i tij mbi mjedisin varet nga karakteristikat mjedisore të zonave dhe cilësive të tyre; dhe ky është faktori që vendos mjedisin në zona të tilla të globalizimit të ulet apo të përmirësohet. Globalizimi është shkaku i çekuilibrit të tregut dhe anormalitetit politik. Kjo në vazhdim formon sfondin për shkatërrimin e mjedisit dhe mund të drejtojë politikat e konsideruara më parë si të brendshme drejt politikave tërësisht të reja nëpërmjet ushtrimit të presionit për reforma. Pavarësisht rritjes ekonomike në rritje, si pasojë e globalizimit, në disa rajone dhe vende ai mund të shkaktojë kolapsin e disa industrive dhe sektorëve; kjo, nga ana tjetër, do të çojë drejt përkeqësimit të resurseve dhe eventualisht në përhapjen e varfërisë ndërmjet njerëzve të këtyre rajoneve dhe së fundmi drejt shkatërrimit të mjedisit (Baker, 2000).

Globalizimi mund të zhvillojë standardet globale të prodhimit. Zhvillimi i standardeve mjedisore dhe shtrirja e tregjeve të konsumit mund të sjellë një lloj rryme e cila mund të shkaktojë rritje të dukshme në standardet globale. Sigurisht, brenda rrjedhës së ngjarjeve, mundet që disa aktivitete të konkurrencës së paligjshme të shkaktojnë dëme ndaj konkurrencës së shëndetshme ose që disa standarde të dobëta të rezultojnë në një lloj konkurrence që çon në rënie. Globalizimi ekonomik do të ndryshojë lidhjet ndërmjet tregut dhe qeverisë. Ky proces ushtron presion mbi qeveritë dhe rrit rolin e tregjeve në interesat ekonomikë, shoqërorë dhe mjedisorë. Për më tepër, ai krijon kërkesa të reja globale për qeveritë që ato të bashkëpunojnë në fushën mjedisore. Kjo do të sjellë konvergjencë me veten dhe ndjekjen e objektivave vijuese: së pari përcaktimin e lidhjeve kryesore ndërmjet globalizimit dhe mjedisit; së dyti, përcaktimin e problemeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare shumëpalëshe në fusha si financa, investimet dhe të drejtat e pronësisë intelektuale që prekin qëndrueshmërinë e mjedisit; së treti, prioritet për rishikimin e politikave që prekin marrëveshjet ekonomike shumëpalëshe. Në këtë mënyrë ne jemi të aftë të analizojmë incentivat që luajnë rol në politikbërjen e tregtisë dhe investimeve, implikimet e të cilave ndikojnë mbi qëndrueshmërinë mjedisore (Kelly, 1994). Në fakt krijimi i integritit rajonal mund të ndihmojë vendosjen e një sistemi multipolar botëror; diçka që duket si e pa dëshiruar prej vendeve të fuqishme të cilat duan të kenë marrëdhënie bilaterale (Huntington, 1999).

Materialet dhe Metodat

Metodat e përdorura në këtë studim janë kërkimi në librari i cili u kompletua duke përdorur dokumentet e publikuara rreth integriteteve rajonale si dhe informacionin e kompjuterizuar rreth çështjeve dhe rreziqeve mjedisore. Gjithashtu, ky studim përdor një metodë analitiko-deskriptive e cila përfshin kryerjen e investigimit të bibliotekave dhe dokumenteve duke përdorur principet e gjeografisë dhe shkencave të tjera ku përfshihen: shkencat mjedisore dhe politike. Në vazhdim, programe si Excel dhe Encarta janë përdorur si edhe hartat dhe grafiket e nevojshme.

Rezultatet dhe diskutimi

Variablat që mund të jenë efektive në formimin e sistemeve rajonale janë të ndryshme. Hetten shkruan në studimin e tij të titulluar “New Regionalism, Security and Development” (Rajonalizmi i Ri, Siguria dhe Zhvillimi) se: *“Lindja e sistemeve rajonale mund të jetë e qëllimshme dhe mund të bazohet në planet e paracaktuara të qeverive, por në shumicën e rasteve, ajo është e pa-qëllimshme dhe vjen si rrjedhojë e kushteve të ndryshme ndërkombëtare.”*

Sipas tij, variablat ekonomikë, politikë, shoqërorë dhe veçanërisht ato të sigurisë janë efikase në realizimin e sistemeve rajonale dhe prandaj ai flet për sisteme rajonale të bazuara në formime të ndryshme duke përfshirë: sistemet rajonale me baza gjeografike, sistemet rajonale me baza shoqërore të cilat korrespondojnë me solidaritetin kulturor dhe shoqëror ndërmjet grupeve njerëzore që banojnë në të njëjtën zonë gjeografike, dhe së fundmi, sistemet rajonale të bazuara tek bashkëpunimi të cilat i kanë rrënjët në bashkëpunimin ndër-qeveritar në fusha të ndryshme kulturore, politike dhe ekonomike (Hetten, 1991). Në të ardhmen tendenca për forcimin e organizatave ekzistuese dhe krijimin e organizatave të reja rajonale do të vazhdojë duke qenë se do të ketë një rritje në volumin dhe numrin e aktiviteteve të tyre si dhe në rolin që luhet prej tyre.

Për të patur një panoramë më të plotë të variablave që influencojnë formimin e një sistemi rajonal të veçantë, përmenden pikat e mëposhtme: Variablat gjeografike: Kur flitet për gjeografinë, duhen konsideruar disa dimensione. Afërsia gjeografike është faktori më i rëndësishëm dhe më i zakonshëm në lindjen e sistemeve rajonale por ky faktor nuk duhet përmendur

si i izoluar. Në zonat në të cilat ka ndryshime rajonale dhe tensione politike situata mjedisore do të përkeqësohet nëse mjedisi mbahet nën presion. Ekzistenca e një faktori gjeografik që krijon interesa të përbashkëta ose interesa në konflikt me njëra-tjetrën mund të përgatitë terrenin për krijimin e një sistemi rajonal. Në këtë rast rreziqet mjedisore mund të konsiderohen si një prej faktorëve më të rëndësishëm në formësimin e sistemit rajonal. Pellgu i Mesdheut ka formuar një sistem Mesdhetar për shtetet bregdetare të tij që përfshin vende evropiane, aziatike dhe afrikanë; dhe Gjiri Persik luan një rol të ngjashëm për vendet e bregdetit të tij. Ky variabël është vlerësuar si dy pozitive (++) sa i përket rreziqeve mjedisore në këtë studim.

Variabli politik: këtu integrimi nënkupton integrimin e politikave. Me fjalë të tjera kjo përfshin një lloj veprimi/operacioni të koordinuar nga një grup vendesh të cilat ndjekin strategji të përbashkëta në politikat e tyre të jashtme dhe të brendshme. Sasia dhe shtrirja e strategjive të tilla të përbashkëta janë efektive për të matur nivelin e integritit. Qëndrueshmëria e brendshme e regjimeve demokratike kundrejt atyre autoritare është një nga variablat më efektive për krijimin e një sistemi rajonal. Rreziqet mjedisore në struktura të tilla zhvlerësohen për integrimin rajonal. Ky variabël është vlerësuar me shenjën minus (-) sa i përket rreziqeve mjedisore në këtë studim. Variabli i sigurisë: Nëse siguria përcaktohet si: "Koha kur vlerat jetësore të qenieve njerëzore nuk janë në rrezik." (Lipman, 1973), atëherë kërcënimi i këtyre vlerave nga një ose dy fuqi në rajon përgatit terrenin për polaritet në atë rajon çka në vazhdim sjell krijimin e përpjekjeve të mëtejshme për balancë. Megjithatë, Mohammad *Ayoub* në librin e tij të titulluar 'Regional Security in the Third World' (Siguria Rajonale në Botën e Tretë) flet për një dimension të dallueshëm ndërmjet kërcënimeve për sistemet e sigurisë rajonale në vendet perëndimore dhe atyre në botën e tretë, dhe thekson se: çdo rrezik drejt sigurisë perëndimore konsiderohet se vjen prej grupeve të jashtme të kundërshtarëve dhe jo prej minoriteteve ose prej veprimeve të ndërmarra brenda, ndërsa në vendet e botës së tretë, të gjitha veprimet dhe aktivitetet pavarësisht nëse vijnë prej forcave të huaja ose prej grupeve opozitare konsiderohen si anti-siguri, dhe prandaj, qeveria parandalon forcërisht lindjen e rrjedhave të tilla kundërshtuese.

Duhet pranuar se arritja e një sistemi të balancuar në rajonet e botës së tretë (jugu i sotëm) është shumë e komplikuar dhe se marrëdhëniet ndërmjet shteteve duhet të konsiderohen gjithashtu në lidhje me marrëdhëniet ndër-qeveritare për të qenë të aftë të analizohen shkaqet e sjelljeve. Ndoshta nëse siguria

prezantohet duke përdorur konceptet e Luftës së Ftohtë, rreziqet mjedisore mund të thuhet se nuk kanë vend në integritet të tilla, por megjithatë siguria mjedisore mund të konsiderohet si variabël në këtë model me konceptin e sigurisë të përdorur si në shekullin 21-të. Ky variabël është vlerësuar me shenjën minus (-) sa i përket rreziqeve mjedisore në këtë studim.

Variabli ekonomik: Nevojat ekonomike dhe ekzistenca e ekonomive të përbashkëta ose e atyre në konflikt me njëra-tjetrën janë ndër faktorët që formësojnë një sistem rajonal. Për shembull, domosdoshmëria e unitetit rreth çështjes së energjisë e cila është monopol i disa vendeve (si p.sh. APEC) ose konflikti i interesit në lidhje me një kategori ekonomike që bëhet një çështje e konkurrencës nga një grup vendesh (si p.sh. shfrytëzimi i naftës në Detin Kaspik) përgatit terrenin për një sistem rajonal. Nëse ekonomia shikohet vetëm në mënyrë sipërfaqësore, kërcënimet mjedisore duket se nuk kanë vend në një qasje të tillë; megjithatë, ekonomia duhet të ekzistojë bazuar mbi kriterin e sigurisë mjedisore nëse duam të kemi një mjedis të qëndrueshëm. Duhet theksuar gjithashtu se një rritje e hapur dhe e pa-penguar ekonomike mund të çojë në erozion mjedisor dhe të ulë aftësinë e qeverive dhe të organizatave jo qeveritare për të ulur humbjet mjedisore që rezultojnë prej kësaj (Deudney, 1990). Ky variabël është vlerësuar me shenjën minus (-) sa i përket rreziqeve mjedisore në këtë studim.

Variablat socio-kulturorë: Disa variabla si etniciteti, raca, marrëdhëniet historike, gjuha dhe feja mund të luajnë një rol në formimin e një sistemi rajonal. Për shembull, ekspansioni i gjuhës Arabe formon Ligën Arabe, ose vendet Myslimane formojnë Organizatën e Konferencës Islamike. Zakonisht rreziqet mjedisore të diskutuara këtu nuk luajnë ndonjë rol në modele të tilla të integritetit rajonal. Ky variabël është vlerësuar me shenjën minus (-) sa i përket rreziqeve mjedisore në këtë studim.

Variabli i fuqive të huaja: Fuqitë e huaja, sidomos superfuqitë interesat e të cilave nuk janë të kufizuara në qëllimin gjeografik dhe tek kufijtë e tyre lokalë janë efikase në lindjen, shkatërrimin, forcimin ose dobësimin e një sistemi rajonal bazuar në konsideratat e tyre ekonomike/të sigurisë. Zakonisht dihet se masat e marra prej Ushtrisë së Kuqe dhe Bashkimit Sovjetik kanë qenë dukshëm efikase në formimin e Evropës Lindore gjatë Luftës së Ftohtë. Zakonisht gjatë Luftës së Ftohtë, të studiuarit e sistemeve rajonale ka qenë kryesisht e mundshme nëpërmjet observimit të marrëdhënieve konkurruese të superfuqive, dhe dy superfuqitë globale ShBA dhe Rusia kanë luajtur një rol aktiv në çështjet rajonale. Zakonisht, rreziqet mjedisore nuk luajnë

rol të rëndësishëm në një model të tillë të integritit rajonal. Ky variabël është vlerësuar me shenjën minus (-) në modelin tonë të integritit rajonal në këtë studime. Të gjashtë variablat ose faktorët e përmendur janë formuar nëpërmjet kombinimit të dy ose tre prej variablave që lidhen me integrimin rajonal. Roli i secilit variabël në krijimin e integritimeve rajonale ilustron në Tabelën 1 dhe Figurën 1 më poshtë:

Tabela 1: Variablat e formimit të sistemeve rajonale


Zona e praktikuar	Totali i përdoruesve	Variablat që ndikojnë formimin	Vlerësimi i rrezikut mjedisor në formimin e	Simboli	Organizata
Evropa dhe Amerika e Veriut	19	Fuqitë e Huaja	—	NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
Evropa	15	Gjeografik-ekonomik	+	BE	Bashkimi Evropian
Evropa Juglindore	11	Ekonomik-gjeografik	+	OBEVDZ	Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik e Vendeve të Detit të Zi
Evropa Juglindore	11	Gjeografik	++	—	Komisioni i Danubit
Bashkimi Sovjetik	12	Ekonomik	+	BShP	Bashkimi i Shteteve të Pavarura
Amerika Kontinentale	36	Gjeografik	++	OShA	Organizata e Shteteve Amerikane
Amerika Qendrore	6	Gjeografik-ekonomik	+	TPAQ	Tregu i Përbashkët i Amerikës Qendrore
Amerika Latine	12	Socio-kulturor	—	AIAL	Asociacioni i Integritit të Amerikës Latine
Amerika e Jugut	5	Gjeografik	++	—	Komuniteti i Andeve
Amerika Qendrore dhe e Jugut	25	Gjeografik	++	AShK	Asociacioni i Shteteve të Karaibeve
Karaibet	18	Gjeografik	++	CARICOM	Komuniteti i Karaibeve
Azia Juglindore	10	Gjeografiko-ekonomik	+	OBE	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik
Oqeani Paqësor	21	Gjeografiko-ekonomik	+	BEAP	Bashkëpunimi Ekonomik i Azisë dhe Paqësorit

Azia Juglindore	10	Gjeografik	++	AShAL	Asocioni i Shteteve të Azisë Juglindore
Azia Jugore	7	Gjeografik	++	ABRAJ	Asocimi për Bashkëpunim Rajonal i Azisë së Jugut
Lindja e Mesme	22	Socio-Kulturor	—	—	Liga e Vendeve Arabe
Gjiri Persik	6	Gjeografik-siguria	+	KBGj	Këshilli i Bashkëpunimit i Gjirit
Amerika e Jugut	4	Gjeografiko-ekonomik	+	MERCOSUR	Tregu i Përbashkët i Jugut
Amerika Qendrore	8	Gjeografik	++	OKL	Organizata e Karaibeve Lindore
Lindja e Mesme	21	Socio-Kulturor	—	FAZhESH	Fondi Arab për Zhvillimin Ekonomik dhe Shoqëror
Afrika Veriore	5	Gjeografik	++	—	Bashkimi i Magrebit dhe Arabëve
Lindja e Mesme	21	Socio-Kulturor	—	BA	Bashkimi Afrikan
Republikat e Afrikës Qendrore	10	Gjeografiko-ekonomik	+	KEShAQ	Komuniteti Ekonomik i Shteteve të Afrikës Qendrore
Afrika Perëndimore	18	Gjeografiko-ekonomik	+	KShAP	Komuniteti i Shteteve të Afrikës Perëndimore
Afrika Perëndimore	8	Gjeografiko-ekonomik	+	BMAP	Bashkimi Monetar i Afrikës Perëndimore
Afrika Lindore dhe Jugore	20	Ekonomiko-gjeografik	+	TPALJ	Tregu i Përbashkët për Afrikën Lindore dhe Qendrore
Afrika Jugore	14	Gjeografik	++	KAJZh	Komuniteti Afrikan Jugor për Zhvillim
Republikat e Afrikës Qendrore	5	Gjeografik	++	—	Komisioni i Basenit të Liqenit Çad
Afrika Perëndimore	9	Gjeografik	++	—	Autoriteti i Basenit të Nigerit
Afrika Lindore	3	Gjeografik	++	—	Komuniteti i Afrikës Lindore
Poli i Jugut	39	Ekonomik	-	—	Traktati Antarktik
Euroazia dhe Amerika	55	Siguria	-	OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
Evropa dhe Kontinentet e tjera	31	Ekonomik	-	OBEZH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
Evropa	43	Gjeografik	++	—	Këshilli i Evropës
Evropa	10	Gjeografik	++	BEP	Bashkimi i Evropës Perëndimore
Evropa	4	Ekonomiko-gjeografik	+	EFTA	Asociacioni Evropian i Tregtisë së Lirë
Evropa	11	Gjeografik	++	—	Këshilli i Shteteve të Baltikut
Amerika Latine	28	Ekonomik, Socio-kulturor	-	SELA	Sistemi Ekonomik i Amerikës Latine
Paqësori i Jugut	16	Gjeografik	++	FP	Forumi i Ishujve të Paqësorit
Lindja e Mesme	10	Ekonomik, Socio-kulturor	-	OAPEC	Organizata e Vendeve Arabe Eksportuese të Naftës

Bota Islamike	57	Socio-Kulturore	-	OKI	Organizata e Konferencës Islamike
Amerika Latine	10	Ekonomik, Socio-kulturor	-	LANFTA	Asocacioni i Tregtisë së Lirë i Amerikës Latine
Amerika e Veriut	3	Ekonomiko-gjeografik	+	NAFTA	Asocacioni i Tregtisë së Lirë i Amerikës së Veriut
Oqeani Indian	19	Gjeografik	++	IROARC	

* Në rastet kur një variabël tjetër luan një rol në formësimin e organizatës rajonale së bashku me variablin gjeografik, roli i kërcënimeve mjedisore do të jetë i dobët, prandaj në tabelën e mësipërme një plus (+) është hequr nga vlerësimi i këtyre integritimeve.

Figura 1. Pozicionimi i Kërcënimeve Mjedisore në modele të ndryshme të krijimit të integritit rajonal



Konkluzione

Siç u tregua dhe nga tabela që ilustron ndarjen e organizatave rajonale aktive në botë, vetëm 19 organizata nga 45 kanë formuar bashkime rajonale për arsye gjeografike (42.2%). Në organizata rajonale të tilla, kërcënimet mjedisore mund të konsiderohen si faktorët më të rëndësishëm për formimin e organizatave rajonale. Përveç variablave gjeografikë dhe faktorëve të tjerë, njëmbëdhjetë organizata kanë qenë efektive në formimin e tyre (24.4%). Ndërveprimi i faktorëve jo gjeografikë dhe gjeografikë vazhdimisht zhvlerëson kërcënimet mjedisore ndërmjet vendeve anëtare në mënyrë të tillë që këto vende shpesh injorojnë kërcënimet mjedisore në bazë të interesave të tyre të sigurisë

ose atyre ekonomike. 15 organizata janë formuar gjithashtu për arsye të variablave jo gjeografike të cilat nuk luajnë ndonjë rol në kërcënimet mjedisore (33.4%).

Nëse hedhim një vështrim edhe datat e formimit të organizatave, ne do të shohim se shumica e organizatave në të cilat nuk ka variabla gjeografikë lidhen me periudhën e Luftës së Ftohtë dhe se ato kanë humbur vlerën e tyre ndërkombëtarisht gjatë viteve pas saj. Rëndësia e fuqisë ekonomike gjatë viteve të fundit dhe superioriteti i kësaj kundrejt fuqisë ushtarake tregojnë që sot nuk mund të pritët që integrimet rajonale të jenë të formuara kryesisht në bazë të variablave të përmendur më sipër. Për më tepër sot variablat ekonomikë mund të konsiderohen si më të rëndësishmet për shkaktimin e integritit rajonal. Pritet që në të ardhmen, bashkëpunimet rajonale me orientim ekonomik do të japin frytet e dëshiruara me kusht që ekonomia të ketë fokus kryesor një mjedis të qëndrueshëm; për më tepër, zhvillimi i qëndrueshëm i orientuar drejt njerëzve do të konsiderojë patjetër kërcënimet mjedisore si faktorin kryesor që kërcënon ekonominë. Në këtë rast ne mund të pretendojmë se variabli ekonomik jo vetëm që do të anashkalojë uljen e rëndësisë së sigurisë mjedisore në një integrim rajonal të caktuar por do të shkaktojë rritjen e nivelit të sigurisë mjedisore.

Bibliografia

Baker, A. (2000). The G7 as a Global Ginger Group: Plurilateralism and Four- Dimensional Diplomacy. *Global Governance: A Review of Multilateralism and International Organizations*.

Dads, K. (2005). *geopolitics in a changing world* publisher: Gorge knowledge.

Deudney, D. (1990). The case Against Linking Environmental Degradation and National Security Millennium 19.3. *Ëinter* 461-476.

Doyle, T. (1998). *Environment and politics* London: Routledge.

Falk, R. (1995). Appearing the UN at 50: The Looming Challenge. *journal of International Affairs*: 48(2)

Fellmann, J. (2001). *Human Geography: USA*: McGraw-Hill.

Goldston, J. (1995). The Coming Chinese Collapse. *Foreign Policy*, 99, 35-53.

Hetten, B. (1991). *The new regionalism*. USA: MC Graw Hill

Homer, T. (1990). *Environmental Change and Violent Conflict*. Emerging Issues occasional Paper Series. American Academy of Arts and Sciences. Cambridge, M.A. 1990.

Huntington, S. (1999). The Lonely Superpower. Foreign Affairs: 78(2).

Kakonen, J. (1990). The concept of security: from limited to Comprehensive. Paper presented at the 25th Annual International Peace Research Conference. Groningen, 3-7 July 1990. p.15.

Kelly, P. (1994). thinking Green: Essays on Environmentalism. Feminism. and Nonviolence. Berkeley: Parallax Press.

Lippman, W. (1973). US foreign policy. Boston: little Brown co.

Lipschultz, R. (2000). The state and social power in global Environmental politics. New York: Columbia university press.

Mittleman, J. (1996). Globalization: critical reflections. Boulder co: Lynne Rienner. Shafers, M.A. (1998). The territorial strategies of IGOs: implication for environment and Development. Global Government.

Shiva, V. (1993). The greening of global reach. in J. Childs and J. Cutler (eds) Global Visions: Beyond the New World order. Boston MA: south End Press.

R. Daniel Kelemen¹ dhe David Vogel²

TREGTIMI I VENDEVE: ROLI I SHTETEVE TË BASHKUARA DHE BASHKIMIT EUROPIAN NË POLITIKAT NDËRKOMBËTARE TË MJEDISIT

Kur çështjet mjedisore u shfaqën në agjendën ndërkombëtare nga fundi i viteve 1960 dhe fillimi i viteve 1970, Shtetet e Bashkuara ishin një nga mbështetëset më të fuqishme dhe të qëndrueshme të traktateve dhe marrëveshjeve mjedisore (Sands, 1994). Ato luajtën një rol udhëheqës në përgatitjet për Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Njerëzor dhe përkrahën shumicën e traktateve mjedisore të adoptuara gjatë viteve '70, si Konventën e Londrës mbi Shkarkimin në Det 1972, Konventën e Trashëgimisë Botërore 1972, Konventën mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara 1973 dhe Protokollin MARPOL mbi Ndotjen nga Anijet. Vendet anëtare të Bashkimit Europian më pas ratifikuan traktatet ndërkombëtare të krijuara në këtë periudhë, por lidershpi i SHBA-së ishte kryesor dhe vendet Europiane ishin, në shumë raste, pjesëtare ngurruese.³ Përsëri në 1980, Shtetet e Bashkuara luajtën një rol kryesor në negociatat që çuan drejt Protokollit të Montrealit mbi Substancat që Shterojnë Shtresën e Ozonit 1987, ndërkohë që vendet anëtare të BE-së (veçanërisht Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Italia) ishin mbështetëse ngurruese të këtij traktati të rëndësishëm ndërkombëtar.

Kohët e fundit, dinamikat politike të politikës ndërkombëtare mjedisore kanë ndryshuar. Që prej 1989, Shtetet e Bashkuara kanë ratifikuar vetëm dy marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare për mjedisin, ndërkohë që 12 marrëveshje të tilla janë nënshkruar dhe ratifikuar nga Bashkimi Europian dhe/

¹ Rutgers University, New Brunswick, NJ

² University of California, Berkeley

³ Emrat e mëparshëm të Bashkimit Europian ishin Komuniteti Ekonomik Europian (EEC) dhe Komuniteti Europian (EC). Edhe sot, Komuniteti Europian mbetet termi ligjor korrekt në lidhje me pjesëmarrjen e BE-së në traktatet mjedisore. Për të shmangur konfuzionin, ne përdorim termin Bashkimi Europian përgjatë artikullit.

ose shtetet anëtare të tij. Për më tepër, gjatë dy dekadave të fundit, Bashkimi Europian është shfaqur si propozuesi më i fuqishëm për zgjerimin e ligjit mjedisor ndërkombëtar (Sbragia & Damro, 1999). Ai luajti një rol kryesor në miratimin e Konventës së Bazel-it për Hedhjen e Mbetjeve të Rrezikshme 1989 dhe Konventës mbi Shumëllojshmërinë Biologjike 1992 (CBD), Protokollin e Kyotos për Ndryshimin Klimaterik 1997, Protokollin e Kartagjenës mbi Biosigurinë 2000 dhe Konventën e Stokholmit mbi Ndotësit e Qëndrueshëm Organik 2001 (POPs). Shtetet e Bashkuara, në të kundërt, nuk kanë ratifikuar asnjë nga këto marrëveshje ndërkombëtare. Udhëheqësit politik të BE-së ishin aktiv dhe të dukshëm në pjesën më të madhe të konferencave mjedisore të Kombeve të Bashkuara në Rio de Janeiro në 1992 dhe Johaneshburg në 2002, ndërsa Shtetet e Bashkuara u kritikuan ashpër për pozicionin e tyre ndaj iniciativave të politikës mjedisore globale në të dyja mbledhjet ndërkombëtare. Bashkimi Europian ka drejtuar përpjekjet për të "gjelbëruar" institucionet ndërkombëtare të tregtisë si Organizata Botërore e Tregtisë (WTO) dhe për të fituar mbarëbotërisht pranimin për një qasje "parandaluese" ndaj rregullimeve mjedisore, ndërkohë që Shtetet e Bashkuara i rezistuan gjatë këtyre iniciativave. Ky artikull kërkon të shpjegoj pse Bashkimi Europian ka zëvendësuar Shtetet e Bashkuara si udhëheqësin ndërkombëtar të mjedisit. Fokusi jonë mbi Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara është një reflektim i faktit që këto janë të vetmet entitete politike me kapacitetin për të ushtruar botërisht udhëheqjen në fushën e mjedisit (Vig & Faure, 2004). Ne jemi të vetëdijshëm që koncepti i lidhshimit global mjedisor është shumëfaqësh (Skodvin & Andresen, 2006; Young, 1991) dhe që Shtetet e Bashkuara e kanë mbajtur lidhshimin në disa fusha të rregullimeve mjedisore të brendshme (Weiner, 2004). Gjithsesi, ne argumentojmë se në lidhje me politikën ndërkombëtare mjedisore, ka ndodhur një ndryshim dramatik dhe sistematik nga lidhshimi i SHBA-së te ai i BE-së që prej fillimit të viteve 1990.

Një model i "politikës rregullatore" (DeSombre, 2005; Raustiala, 1997) që sintetizon efektet e politikës së brendshme dhe konkurrencës rregullatore ndërkombëtare jep shpjegimin më të fortë se pse Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian kanë tregtuar vendet në politikën ndërkombëtare mjedisore.

Politika e brendshme formëson pozicionin e qeverisë mbi çështje të politikës ndërkombëtare mjedisore nëpërmjet dy kanaleve. E para, dhe me direkte, sa më e fortë të jetë influenca e brendshme politike e ambientalistëve, aq më shumë gjasa ka që ata të jenë të suksesshëm në presionin ndaj qeverisë për të

mbështetur marrëveshje të reja të politikës ndërkombëtare mjedisore. Rruga e dytë është më indirekte: sa më e fuqishme të jetë influenca e brendshme politike e ambientalistëve, aq më shumë gjasa ka që të adoptohen standarde të rrepta të brendshme. Ekzistenca e këtyre të fundit ul koston ekonomike (ose gjeneron incentiva pozitive) për prodhuesit vendas për të mbështetur marrëveshje ndërkombëtare që imponojnë standarde të ngjashme mbi juridiksionin e huaj. Anasjelltas, kur standardet e brendshme janë tolerante, dinamikat e konkurrencës rregullatore ndërkombëtare i bëjnë qeveritë dhe firmat e vendit më të interesuara për të kundërshtuar marrëveshjet ndërkombëtare që do të impononin rregulla shtesë mbi to.

Në fillim të viteve 1970, ambientalistët zotëronin pushtet të madh politik në Shtetet e Bashkuara, duke nxitur adoptimin e rregullimeve të brendshme mjedisore nga më ambiciozet në botë. Me rregulla të brendshme strikte dhe të kushtueshme në fuqi, Shtetet e Bashkuara kërkuan t'i shpërndanin standarde të ngjashëm juridiksioneve të tjera duke marr një rol udhëheqës në arenën ndërkombëtare dhe duke mbështetur marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe (DeSombre, 2000, 2005; Hopgood, 1998; Jacobson, 2002). Ndërkohë, ambientalistët zotëronin shumë më pak pushtet në Europën Perëndimore, dhe rregullimet Europiane ishin përgjithësisht më pak strikte se ato që ishin të vendosura nga Shtetet e Bashkuara (Vogel, 2003). Qeveritë e vendeve anëtare të BE sigurisht që i nënshkruan traktatet e propozuara në këtë periudhë, por nuk luajtën një rol udhëheqës dhe në disa raste punuan për t'i penguar apo dobësuar ato.⁴ Bashkimi European, si një aktor me të drejtat e veta, sapo po fillonte të luante një rol aktiv në rregullimet mjedisore—brenda Europës dhe ndërkombëtarisht.

Që prej 1990, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi European kanë ndërruar vendet. Ambientalistët fituan shumë influencë brenda BE-së, dhe Bashkimi European ka adoptuar shumë rregullime mjedisore që janë nga më ambiciozet dhe striktet. Si rrjedhim, ishte në interesin politik dhe konkurrues të BE të mbështesnin qëllimin e qeverisjes ndërkombëtare mjedisore. Ndërkohë, fuqia e ambientalistëve në SHBA u zbeh: Zhvillimi i iniciativave të politikës së brendshme mjedisore u ngadalësua

⁴ Disa vende Nordike (veçanërisht Suedia), luajtën një rol kryesor mbi një sërë çështjesh si rrjedhja e acidit; gjithsesi ato nuk ishin atëherë anëtare të EEC. Shtete anëtare të fuqishme të EEC si Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar ishin më pak mbështetëse, duke i rezistuar fillimisht marrëveshjeve ndërkombëtare mbi rrjedhjen e acidit dhe shterimin e ozonit.

dukshëm pas 1990. Me miratimin e më pak rregullimeve të reja të brendshme, nuk ishte më në interesin konkurrues të Shteteve të Bashkuara të merrte një rol udhëheqës në çështjet mjedisore ndërkombëtare; përkundrazi ishte më në interes të kundërshtonte përhapjen e rregullimeve mjedisore që kryesoheshin nga Bashkimi Europian.

Ky artikull ngrihet mbi dhe plotëson literaturën e politikave ndërkombëtare mjedisore në shumë mënyra. Vogel (2003) dhe Vig and Faure (2004) kanë eksploruar shkallën në të cilën SHBA dhe BE kanë tregtuar vendet në lidhje me rreptësinë mjedisore, por fokusi i tyre ishte kryesisht mbi standardet e brendshme. Pra, duke eksploruar dimensionet ndërkombëtare të argumentit “tregtimi i vendeve”, ne shpjegojmë se si ndryshimet në politikën e brendshme inkurajonin një ndryshim në politikën ndërkombëtare mjedisore. Duke punuar mbi studimet e autorëve të tjerë (të cituar) mbi pozicionet e SHBA-së dhe BE-së në traktate të veçanta mjedisore, i përdorim këto studime në një strukturë më të integruar, duke theksuar proceset e zakonshme që fshihen nën dhe lidhin ndryshimin e pozicioneve të tyre në arenën ndërkombëtare mjedisore përgjatë një seri fushash problemore.

Qasjet kryesore teorike

Janë bërë shumë përpjekje për të shpjeguar përgjigjet kombëtare ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare të mjedisit. Një seri argumentesh fokusohet në kombinimin e pasurisë dhe vlerave postmaterialiste. Logjika këtu është që shtimi i pasurisë inkurajon përhapjen e vlerave postmaterialiste, që inspirojnë një mbështetje publike për mbrojtjen e mjedisit. Kjo e fundit përkthehet si një tendencë për të ratifikuar traktate ndërkombëtare mjedisore. Studimi tej-kombëtar thekson se shtetet më të pasura ratifikojnë me shumë traktate, ndërsa studimi i Recchia's (2002) për demokracitë e avancuara parashtron se mbizotërimi i vlerave postmaterialiste në popullatë është një parashikim i fuqishëm i ratifikimit të marrëveshjeve. Në shumë studime që përfshijnë si vendet e zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim, dallimet në pasuri dhe postmaterializëm japin një shpjegim të fortë të ndryshesave në ratifikimin e traktateve ndërkombëtare. Gjithsesi, duke krahasuar Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Europian, këto ndryshime nuk shpjegojnë ndërrimin e pozicioneve në politikën mjedisore ndërkombëtare. Në të kundërt, pasuria dhe argumentet

postmaterialiste parashikojnë që ShBA do të qëndronte lideri mjedisor, duke lënë pas BE-në në angazhimet e veta ndërkombëtare.

Sociologë që punojnë në traditën e konstruktivizmit social argumentojnë se mbështetja kombëtare për traktatet ndërkombëtare mjedisore ndërtohet nga shoqëria në botë. Argumentet e kësaj shoqërie botërore parashtrojnë se preferencat e politikës kombëtare nuk përcaktohen nga interesat e brendshme por formohen nga “një regjim mjedisor botëror (Meyer et al., 1997) që ndërton preferencat kombëtare. Nisur nga kjo perspektivë, shtetet kërkojnë të “miratojnë” sjelljet legjitime të pritshme prej tyre, të cilat në fushën e politikës mjedisore përfshijnë ratifikimin e traktateve ndërkombëtare (Frank, 1999, pp. 527-529). Frank (1999, p. 534) gjen që shtetet me lidhjet më të dendura me shoqërinë botërore, të matura në kuadër të anëtarësimit në shoqatat joqeveritare ndërkombëtare “ratifikojnë në mënyrë domethënëse më shumë traktate ndërkombëtare”. Por kjo qasje nuk mund të shpjegoj çështjen kryesore që ky studim adreson, sepse variablet e pavarura nuk dallojnë Shtetet e Bashkuara nga Bashkimi Europian ose vendet e tij anëtare.

Sprinz and Vaahtoranta (1994) propozojnë një shpjegim që bazohet mbi interesin e politikës ndërkombëtare mjedisore që fokusohet në një analizë ekonomike dhe mjedisore kosto-përfitim. Analiza e tyre parashtron që qëndrimi i një vendi mbi marrëveshjet ndërkombëtare të mjedisit ndikohet nga perceptimi publik mbi interesat mjedisore dhe ekonomike të një vendi. Megjithatë, përkufizimi i tyre i interesave kombëtare, që kombinon indikatorët e vulnerabilitetit ekologjik me rënën e kostos, është problematik nga shumë këndvështrime. Në raste të shumë marrëveshjeve ndërkombëtare, shkalla e vulnerabilitetit ekologjik është më shumë politikisht e ndërtuar se sa objektivisht e përcaktuar (Beck, 1992). Gjithashtu, siç pranojnë vetë Sprinz dhe Vaahtoranta (1994, p. 105) pakësimi i kostove mund të formësohet nga vetë tregtia ndërkombëtare, për shembull, kostot kompensuese duke eksportuar vijueshmërisht teknologji pakësuese. Gjithsesi, analiza e tyre mundohet të shpjegoj pozicionet e SHBA-së dhe BE-së. Kostot amerikane të pakësimit ishin thellësisht më të larta se ato të çdo shteti Europian. Megjithatë, Shtetet e Bashkuara ishin proponentet kryesore të një marrëveshje ndërkombëtare për të luftuar shterimin e ozonit, ndërsa vendet si Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania dhe Italia ishin pjesëmarrëse ngurruese.

Së fundi, shumë studiues të politikës së jashtme të SHBA dhe

BE kanë sugjeruar që pozicionet e SHBA-së dhe BE-së në çështjet mjedisore ndërkombëtare janë përcaktuar jo kryesisht nga shqetësime të caktuara të arenës politike mjedisore por nga rritja e unilateralizmit të SHBA-së dhe përqafimi korrespondues i multilateralizmit nga BE (Ikenberry, 2003; Kagan, 2003). Nga kjo perspektivë, kundërshtimet e kohëve të fundit të SHBA-së ndaj traktateve mjedisore ndërkombëtare përfaqëson një tjetër manifestim të mbrojtjes së sovranitetit kombëtar dhe rritjes së mosdëshirës për të mbështetur traktatet shumëpalëshe. Ka një evindecë të dukshme që Shtetet e Bashkuara janë bërë më pak mbështetëse të traktateve multilaterale pas Luftës së Ftohtë (Malone & Foong Khong, 2003; Prestowitz, 2003). Në këtë kuadër, SHBA që ka përkrahur multilateralizmin përgjatë shumicës së Luftës së Ftohtë, ka refuzuar të nënshkruaj dhe/ose ratifikoj një numër të madh konventash ndërkombëtare gjatë dekadave të fundit. Por nëse kundërshtimi për traktatet mjedisore multilaterale në vitet 1990 buron kryesisht nga rritja e unilateralizmit, atëherë ne do të prisnim që Shtetet e Bashkuara të vazhdonin të zhvillonin qëllimet e tyre mjedisore në nivel ndërkombëtar, si për shembull në kufizimet e tregtisë ose sanksionet, ose në kuadre ligjore ndërkombëtare të cilat mund t'i kontrollonte. Dhe në fakt, ka bërë kështu në një masë të caktuar (Kormos, Grosko, & Mittermeier, 2001). Por me gjithë disa masa unilaterale për të zgjeruar mbrojtjen ndërkombëtare të mjedisit, këto përpjekje kanë qenë të limituara në qëllim dhe në intensitet. Rritja e unilateralizmit mund të ndihmoj për të shpjeguar vullnetin amerikan për të mos ndjekur drejtimin e Bashkimit Europian në lidhje me disa marrëveshje multilaterale ndërkombëtare të kohëve të fundit, por rritja e unilateralizmit nuk shpjegon në vetvete politikën e fundit të SHBA-së.⁵ Nocioni që mbështetja e BE-së për traktatet ndërkombëtare mjedisore është e rrënjosur, të paktën pjesërisht, në një angazhim më të përgjithshëm në multilateralizmin ka shumë besueshmëri. Që prej 1970, studiuësit

⁵ Një vullnet më i madh i SHBA-së për të vepruar unilateralisht ndihmon në shpjegimin pse ndërrimi i vendeve që po studiohet në këtë artikull nuk është simetrik. Gjatë viteve 1970 dhe 1980, vendet Europiane dhe/ose Bashkimi Europian ndoqi udhëheqjen rregullatore të brendshme dhe ndërkombëtare të SHBA-së, duke ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare të mjedisit që SHBA-ja i kishte iniciuar dhe duke adoptuar shpesh standardet e brendshme të SHBA-së. Kohët e fundit, e kundërta nuk ka ndodhur. Në fusha që variojnë nga riciklimi elektronik, te rregullimi kimikateve, në çlirimin e gazeve serrë, Bashkimi Europian ka adoptuar politika ambicioze ndërsa Shtetet e Bashkuara kanë refuzuar plotësisht të ndjekin drejtimin e BE-së.

kanë argumentuar se nën dritën e një kapaciteti ushtarak të limituar të BE-së dhe ndarjet e rëndësishme ndërmjet vendeve anëtare mbi çështjet e sigurisë, Bashkimi European fokusohet në afirmimin e vet si një “fuqi civile” në fusha përfshirë dhe mjedisin ku ka një kapacitet për të vepruar (Duchêne, 1972). Gjatë projektimit të fuqisë së saj civile ose normative, Bashkimi European ka theksuar vazhdimisht një angazhim ndaj multilateralizmit (Farrell, 2007).

Nga fillimi i viteve 1990, një seri amendimesh të traktateve, direktivash, dhe vendimesh të Gjykatës Europiane të Drejtësisë kanë nxitur kapacitetin e Bashkimit European për të vepruar në emër të vendeve anëtare në negociatat mjedisore ndërkombëtare, duke forcuar aftësinë për të luajtur një rol lidërshipi botëror (Jupille & Caporaso, 1998; Sbragia & Hildebrand, 2000). Bashkimi european e vuri në përdorim këtë fuqi në Samitin e Rios 1992, dhe që atëherë ka përkrahur vazhdimisht traktatet multilaterale ndërkombëtare dhe është përpjekur të vendosi qartësisht një reputacion si një lider në qeverisjen mjedisore multilaterale. Disa studiues e kanë shpjeguar këtë sjellje si një pasojë të angazhimit të BE-së drejt multilateralizmit ose e dëshirës së tij për të zhvilluar një identitet si fuqi civile (Scheipers & Sicurelli, 2007; Vogler & Stephan, 2007).

Pavarësisht se këto argumente kanë disa fuqi shpjeguese, nuk i japin rëndësi rolit të interesave ekonomike. Në argumentojmë se një llogari që rrjedh nga politika ekonomike-që fokusohet në ndërveprimin midis politikës së brendshme dhe konkurrencës rregullatore ndërkombëtare- siguron një shpjegim më të fuqishëm mbi shfaqjen e lidërshipit të BE-së për mjedisin.

Një qasje e politikës rregullatore

Qasja e politikës rregullatore sugjeron që mbështetja e një shteti (ose, në rastin e Bashkimit European, një njësie mbikombëtare) për marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore është një funksion i një force relative politike të avokatëve të mjedisit dhe ndryshimeve përkatëse në interesin ekonomik të prodhuesve vendas. Ndryshimet midis 1970 dhe 1990 në politikat e brendshme të rregullimeve politike mjedisore dhe ndryshimet përkatëse se si marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore kishin gjasa të ndikonin prodhuesit vendas shpjegojnë pse Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi European “ndërruan vendet” në politikën ndërkombëtare mjedisore. Nga fillimi i viteve 1970 deri në fillim të viteve 1990, politikat rregullatore rreth çështjeve

mjedisore në Shtetet e Bashkuara ishin më të favorshme për lidershipin e SHBA-së mbi marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore, ndërsa ato në Europë ishin më pak të përshtatshme. Në kundërshtim, nga fillimi i viteve 1990 dhe në vazhdim, politikat rregullatore në Bashkimin European e inkurajuan atë të përkrahte një seri marrëveshjesh ndërkombëtare mjedisore, ndërkohë që kushtet e politikës së brendshme në Shtetet e Bashkuara e çuan të adoptonte një qëndrim më obstrukcionista.

Politika e Brendshme

Ndryshime në politikën e brendshme si të Shteteve të Bashkuara ashtu edhe të Bashkimit European kanë luajtur një rol kryesor në ndërtimin e pozicioneve të tyre në marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore. Nga fundi i viteve 1960 deri rreth 1990, përkrahës të rregullimeve mjedisore kanë ushtruar një influencë të madhe politike në Shtetet e Bashkuara. Presidentët republikan Richard Nixon dhe Gerald Ford dhe një kongres i kontrolluar nga demokratët iu përgjigjën fuqisë politike të lobeve të gjelbërta dhe mbështetësve të tyre duke miratuar një seri statutesh rregullatore midis 1969 dhe 1976. Ndërkohë, megjithëse Presidenti Ronald Reagan fillimisht u përpoq të zvogëlonte kufizimet e rregullimeve mjedisore mbi industrinë, ai u detyrua menjëherë të abandononte këto përpjekje, duke qenë se interesi publik mbi dhe mbështetja për mbrojtjen e mjedisit u rritën ndjeshmërisht përgjatë 1980 duke arritur nivele në fund të këtyre viteve që krahasoheshin, në mos më të larta, me fillimin e viteve 1970 (Dunlap & Scarce, 1991). Në përgjigje të shqetësimeve politike të spikatura mjedisore kandidati republikan për president në 1988 George Bush u mundua ta distancoonte veten nga reputacioni anti-ambientalist i Ronald Reagan duke bërë fushatë për një platformë të fortë mjedisore. Roli i lidershipit ndërkombëtar mjedisor që luanin Shtetet e Bashkuara gjatë 1970-1980 ishte në përputhje me modelin e politikave të brendshme amerikane. Standardet mjedisore amerikane ishin në mënyrë tipike më inovative dhe të rrepta se çdo shtet tjetër industrial, dhe Shtetet e Bashkuara luajtën një rol të ngjashëm në nivel ndërkombëtar.

Pas 1990, politika mjedisore e brendshme dhe e jashtme e Shteteve të Bashkuara filloi të ndryshoj (Hopgood, 1998, pp. 153, 202). I lodhur nga mungesa e mbështetjes nga ambientalistët në lidhje me iniciativat e politikës së tij ambientaliste dhe duke u përballur me një kritikë të fortë nga komuniteti i biznesit për

zgjerimin e rregullimeve qeveritare që ndodhën në dy vitet e para të administratës së tij, Bush u bë më pak mbështetës për ndonjë rregullim mjedisor të ri.

Influenca e dobët politike e lobeve ambientaliste në Shtetet e Bashkuara u bë edhe më e dukshme pas zgjedhjes së Bill Klintonit në 1992. Ai i propozoi Kongresit një numër politikash ambientaliste të rëndësishme. Por megjithëse Demokratët ishin në maxhorancë në të dyja Dhomat, Kongresi i 103-të i refuzoi të gjitha propozimet legjislative të kongresit.

Zaptimi republikan i të dyja dhomave të Kongresit në zgjedhjet e mesme e uli më tej gjasat për rregullime të reja mjedisore. Megjithëse çështjet e mjedisit nuk luajtën një rol kritik në triumfin republikan dhe fjala mjedis nuk u shfaq fare në Kontratën me Amerikën, maxhoranca e re republikane ishte më pak simpatizante ndaj shqetësimeve mjedisore se sa shumë legjislatorë të rëndësishëm republikan kishin qenë dy dekada me parë.

Gjithsesi, preferencat anti-gjelbra të Republikanëve në Kongres nuk ishin faktori i vetëm në ngadalësimin dramatik të shkallës së përhapjes së rregullimeve mjedisore që ndodhën në 1994. Presioni publik për zgjerimin e rregullimeve gjithashtu ishte zvogëluar. Megjithëse sondazhet e opinionit publik shfaqën një rritje të qëndrueshme në shqetësimin publik mbi kualitetin e mjedisit nga fillimi i viteve 1980 deri rreth 1990, në fillim të 1990 publiku ngeli më i kënaqur me përpjekjet rregullatore të vendit (Guber, 2003, pp. 57-60). Sipas një sondazhi të vitit 1993, 52% e Amerikanëve ishin të kënaqur me përpjekjet mjedisore të vendit; në 1999 kjo shifër vajti në dy të tretat. Përqindja e atyre që e konsideronin shumë të madh progresin në adresimin e çështjeve të mjedisit u rrit nga 14% në 1990 në 24% në 1995 në 36% në 1999 (Saad, 1999). Njëlloj e habitshme, numri i amerikanëve që e rendisnin "ndotjen e ajrit dhe ujit" si ndër çështjet më të rëndësishme që i shqetësonte, pas kulmit me 23% në 1991, u ulën në vetëm 12% në 1994 (Ladd & Bowman, 1995, p. 19). Në 1995, vetëm 5% e të anketuarve rendisnin mjedisin si ndër problemet e para apo të dyta më presionuese të vendit (Morin, 1995). Këto qëndrime ndihmojnë në shpjegimin pse administrata e Klintonit ishte e paaftë të mbledhë një mbështetje të mjaftueshme publike për të ushtruar presion mbi Kongresin për të nxjerrë ligje të reja mbi mjedisin.

Administrata e George W. Bush që erdhi në fuqi në 2001, ashtu si Partia Republikane në Kongres, ishte kundra vendosjes së kërkesave të reja mjedisore mbi bizneset. Shtëpia e Bardhë nuk ofroi asnjë legjislacion që forconte standardet mjedisore të brendshme dhe nxori një sërë urdhëresash administrative që

dobësonin ose standardet ekzistuese ose zbatimin e tyre (Barringer, 2004). Megjithëse, të dhënat e sondazhit që prej vitit 2000 tregojnë një rritje të pakënaqësisë publike për status quo-n rregullatore, duket qartë që kjo nuk ishte e mjaftueshme për të ndikuar mbi politikat publike (Saad, 2005, 2006). Përsëri çështjet mjedisore nuk spikatën as në gjysmën e parë të viteve 2000.

Preferencat politike të administratës së Bushit u dëgjuan në nivel ndërkombëtar, më qartë gjatë qëndrimit të tij në përpjekjet ndërkombëtare për adresimin e ndryshimit klimaterik. Edhe pse administrata e Klintonit nënshkroi Protokollin e Kyotos, megjithëse asnjëherë nuk e dorëzoi formalisht në Kongres, administrata e Bushit e ndali pjesëmarrjen e Amerikës në negociatat ndërkombëtare mbi ndryshimet klimaterike dhe lajmëroi se ishin kundra çdo kufizimi ligjor të detyrueshëm mbi çlirimin e karbonit. Në 2007, kur ajo më në fund propozoi një strukturë për veprim ndërkombëtar për ndryshimin klimaterik mbas 2012, kritikën e cilësuan si me hile, duke vënë në dukje se qasja vullnetare e Bushit kishte gjasa të minonte përpjekjet e BE-së për të siguruar ndërprerje të detyrueshme të çlirimit nëpërmjet një strukture të Kombeve të Bashkuara (Cornwell, 2007).

Megjithëse influenca e lobeve ambientaliste në Shtetet e Bashkuara u dobësua ndjeshëm në fillim të viteve 1990, e kundërta ndodhi në Europë. Lëvizje masive ambientaliste u shfaqën në Europën Perëndimore në 1970, pak pas lëvizjes ambientaliste të SHBA-së. Ashtu si dhe në Shtetet e Bashkuara qeveritë në Europën Perëndimore u përgjigjën duke vendosur ligje të reja për kontrollin e ndotjes. Gjithsesi, ligjet e tyre ishin përgjithësisht më pak të rrepta dhe më pak ambicioze se ato të vendosura në Shtetet e Bashkuara (Vogel, 2003), dhe spikatja e çështjeve të mjedisit u zvogëlua në fund të viteve 1970. Influenca e forcave pro-ambientaliste u forcua ndjeshëm nga fillimi i viteve 1980 dhe në vazhdim. Nga fundi i viteve 1980, sondazhet e Eurobarometer e konstatuan mjedisin të ishte një ndër çështjet politike në krye të listës në të gjitha shtetet e Bashkimit Europian, me një mesatare prej 77.6% të qytetarëve në 1989 që i shikonin problemet e mjedisit si "shumë serioze" (krahasuar me 56.9% në 1978; Hofrichter & Reif, 1990). Duke u munduar t'i përgjigjeshin këtij shqetësimi të lartë publik, qeveritë në një numër shtetesh anëtare mbështetën një numër të madh standardesh të brendshme të rrepta dhe forcuan angazhimet e tyre për një bashkëpunim më të madh ndërkombëtar në fushën e mjedisit.

Sensibiliteti i qeverive ndaj këtyre ndryshimeve në opinionin publik u shtua nga shfaqja e partive të gjelbra. Nisur nga

mundësia për shfaqjen e partive të vogla nga shumica e sistemeve elektorale europiane (veçanërisht të atyre që përdorin përfaqësimin proporcional) aktivistët ambientalist në Europë filluan të përfshiheshin në politikën elektorale në 1980. Fillimisht në Gjermani në 1983 dhe pastaj në një seri vendesh si Suedia, Franca dhe Belgjika, partitë e gjelbra u shfaqën si një forcë politike dhe ngritën profilin e çështjeve mjedisore në debatet politike kombëtare (Mair, 2001). Në fillim në skaje të politikës, këto parti u bënë një rrymë qendrore gjatë viteve 1990 dhe filluan të hynin në koalicionet e qeverive kombëtare me social demokratët në disa vende anëtare, kryesisht në Gjermani. Në fund të viteve 1990 partitë e gjelbra përfaqësoheshin në parlamentet kombëtare të 11 nga 15 vende të BE dhe në Parlamentin Europian (EP; Vogel, 2003). Kështu, ndërkohë që po binte ndikimi politik i ambientalistëve në Shtetet e Bashkuara, ai po rritej në Europë. Influenca e forcave proambientaliste në nivel kombëtar u zmadhua nga dinamikat e politikave rregullatore në nivel të Bashkimit Europian. Të dyja, si incentivat politike të institucioneve të BE-së dhe konkurrenca rregullatore midis vendeve të BE-së, e inkurajoi Bashkimin Europian të adoptonte standarde të rrepta të përbashkëta mjedisore. Komisioni Europian dhe PE kishin incentiva të forta për Bashkimin Europian që të merrte një rol më aktiv në forcimin e standardeve rregullatore europiane. Nga fillimi i viteve 1970, Bashkimi Europian kishte bërë një progres të madh drejt vendosjes së një tregu të përbashkët duke eliminuar tarifatat. Ndërsa disa vende anëtare filluan të adoptonin standarde mjedisore më të rrepta në fillim të viteve 1970 dhe 1980, kjo rrezikoi të krijonte “barriera jo-tarifore” që do të frakturonin tregun e përbashkët. Komisioni dhe PE kërkuan të “harmonizonin” standardet për të mbrojtur tregun e vetëm. Gjithashtu, nisur nga shqetësimi i madh publik mbi çështjet ambientale, ata besonin se duke përkrahur një politikë të fortë ambientaliste, kjo do të rriste legjitimitetin e Bashkimit Europian. Parlamenti Europian, roli i të cilit në politikëbërjen e BE-së po forcohej progresivisht, u bë një përkrahës i kauzave të përhapura të interesit publik si mbrojtja e mjedisit (Pollack, 1997).

Komisioni dhe PE gjetën mbështetës të fuqishëm në shtetet anëtare më të gjelbra- Holanda, Danimarka, dhe mbi të gjitha Gjermania. Këto shtete ishin të shqetësuara se standardet e tyre strikte do t'i vinin ato në disavantazhe konkurruese përkundërt shteteve të tjera anëtare më elastike dhe e shikonin Bashkimin Europian si një forum nëpërmjet të cilit do të eksportonin të prapambeturve standardet e tyre strikte. Ato

përkrahën propozimet e komisionit për harmonizim dhe kërkuan që Bashkimi Europian të adoptonte politika mjedisore më të rrepta (Vogel, 2003). Urdhëresat e Gjykatës Europiane të Drejtësisë nga 1991 dhe në vazhdim dhe rishikimet e bëra nga Traktati i Maastrihit e ndryshuan rregullin e politikëbërjes për masat mjedisore nga votimi me unanimitet në maxhorancë të kualifikuar, duke ndihmuar shtetet e gjelbra të fuqishme të kalonin kundërshtimet nga të prapambeturit (Jupille, 1999). Pas hyrjes së Suedisë, Austrisë dhe Finlandës në 1995, blloku i qeverive të gjelbra në Këshillin e Ministrave u bë më i fortë. Si rezultat i dinamikave elektorale në shtetet anëtare me preferenca të forta të gjelbra dhe dinamikave të politikëbërjes së BE-së, politika ambientaliste europiane u zgjerua thellësisht dhe adoptoi standarde më të rrepta, një dinamikë që filloi në fund të viteve 1980 dhe u shpejtua në 1990. Ky ndryshim përbën pikën fillestare për të shpjeguar pse shtetet e BE-së dhe vet Bashkimi Europian, të cilët kishin ngelur disi mbrapa Shteteve të Bashkuara gjate 1970, u bënë mbështetësit më në zë të politikës ndërkombëtare mjedisore në vitet 1990. Qeveritë kombëtare që kërkonin të apelonin ndaj elektoratit ambientalist të tyre dhe Bashkimi Europian që përpiqej të vendoste legjitimitetin demokratik me një publik europian proambientalist ishin të paduruar të demonstronin angazhimin e tyre ndaj mjedisit në skenën botërore. Këto dinamika krijuan shtytjen politike të mbështetjes së vazhdueshme të Bashkimit Europian për traktate ndërkombëtare mjedisore të reja në vitin 1990, nga Protokollit i Kyotos, te Konventa e Bazelit, te CBD dhe Protokollit i Kartagjenës mbi Biosigurinë (shiko e.g., Schreurs & Tiberghien, 2007).

Ndryshimi i pozicioneve të BE-së dhe SHBA-së në skenën ndërkombëtare ka rrënjët e veta në ndryshimet dramatike në politikën e brendshme ambientaliste. Shkurt, politika e brendshme ambientaliste në të dyja anët e Atlantikut ka ndjekur rrugë divergjente (Vig & Faure, 2004, p. 1). Megjithëse politika e brendshme e SHBA-së ka stimuluar iniciativa mjedisore ambicioze në vitin 1970 dhe 1980, zhvillimi i shumicës së iniciativave të reja të brendshme u ngadalësua ndjeshëm pas 1990. Në të kundërt, në Bashkimin Europian, mbështetja e brendshme për politika mjedisore u rrit në 1990, dhe kompetenca rregullatore në rritje e Bashkimit Europian stimuluan avancime të mëtejshme në politikat e “brendshme” ambientaliste.

Konkurrenca Rregullatore

Mbështetja e qeverisë për marrëveshjet ndërkombëtare të mjedisit formësohet gjithashtu nga fakti se sa këto marrëveshje ndikojnë mbi pozicionin konkurrues të prodhuesve vendas. Ky impakt konkurrues, gjithsesi, varet vetë nga konteksti i politikave të brendshme mjedisore. Me fjalë të tjera, interesat ekonomik të bizneseve ndërtohen në vetvete nga politikat e brendshme. Sa me e fuqishme të jetë influenca e grupeve vendase të gjelbra të presionit ose partive, aq më të rrepta bëhen standardet e brendshme rregullatore, dhe si rrjedhojë ka më shumë gjasa që firmat vendase të mbështesin standarde ndërkombëtare të krahasueshme për të krijuar një nivel fushe loje. Në disa raste, firmat mund të sillen reaktivisht, duke kërkuar të eksportojnë drejt juridiksioneve të tjera një standard që ato kanë adoptuar në juridiksionin vendas. Në raste të tjera, firmat mund të sillen proaktivisht, duke pranuar pashmangshmërinë e standardeve të rrepta vendase dhe mund të nxisin për një marrëveshje ndërkombëtare që do të vendoste njëkohësisht standarde të ngjashme mbi konkurruesit e huaj. Kur standardet e brendshme mbi një çështje janë strikte ose premtojnë të bëhen më strikte, prodhuesit kanë më pak gjasa të kundërshtojnë traktate të rëndësishme ndërkombëtare dhe kanë më shumë mundësi të bashkohen me ambientalistët. Në të kundërt, kur standardet e brendshme rregullatore janë të dobëta, ato kanë më pak gjasa për të kundërshtuar marrëveshjet ndërkombëtare të mjedisit.

Duke u kthyer te Shtetet e Bashkuara, standardet e tyre të mjedisit ishin përgjithësisht më striktet në botë nga fillimi i viteve 1970 deri në fillim të 1990, dhe ato kishin një incentivë të fortë për të parë vendet e tjera të adoptonin standarde të njëjta. Zyrtarët e administratës së Nixonit ishin të shqetësuar se vendosja e standardeve strikte në SHBA mund ta vendoste industrinë amerikane në pozita të disfavorshme kundrejt kompetitorëve të huaj, dhe ata shpresonin të nivelonin fushën rregullatore të lojës ndërkombëtarisht. Së dyti, përhapja e standardeve të stilit amerikan premtoi t'i siguronte tregjeve për eksportet e teknologjive amerikane kontrolluese të ndotjes që po zhvilloheshin për t'iu përgjigjur rregullimeve të brendshme. Kështu në 1970, shumë udhëheqës të të dyja partive panë që duke promovuar lidhësin e SHBA-së në politikat ndërkombëtare të mjedisit mund të fitonin mbështetjen e ambientalistëve, të punonin për të niveluar fushën ndërkombëtare të lojës për industrinë amerikane dhe të siguronin potencialisht përfitime

ekonomike nëpërmjet eksportit të teknologjisë amerikane të uljes së ndotjes (Hopgood, 1998; Jacobson, 2002; Porter, 1990).

Nga një perspektivë e konkurrencës rregullatore, interesat e Bashkimit Europian kanë qenë të kundërtat e atyre të Shteteve të Bashkuara. Siç u përmend dhe më sipër, shtetet e BE-së ishin mbrapa Shteteve të Bashkuara në rregullimet mjedisore në vitet 1970 por gradualisht i arritën dhe në shumë fusha i kaluan në fund të viteve 1980. Përgjatë viteve 1990 dhe duke vazhduar në shekullin e 21, ndërsa rrjedha e politikave të reja ambientaliste u ngadalësua, Bashkimi Europian vazhdoi të vendoste standarde të rrepta në shumë fusha duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve, kontrollin e GMO (organizmat gjenetikisht të modifikuara) dhe çlirimet e gazit serrë.

Perspektiva e konkurrencës rregullatore sugjeron që edhe pse shumë qeveri europiane mund të kenë qenë ngurruese për të adoptuar angazhime substanciale në vitet 1970, nga 1990 ata do të ishin të paduruara të eksportin standardet e rrepta të BE-së drejt sa më shumë juridiksioneve të mundshme. Ne mund t'i vëzhgojmë dinamikat e gjeneruara nga konkurrenca rregullatore midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian në një numër fushash duke përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare për pakësimin e ozonit, diversitetit biologjik, ndryshimit klimaterik dhe POPs. Në rastin e protokollit të Montrealit për substancat e shterimit të ozonit, interesat ekonomike të ShBA-së dhe BE-së ishin në rrezik. Kjo marrëveshje ishte në interesin ekonomik të shumicës së prodhuesve amerikanë të CFC (klorofluorocarbonit), përkatësisht DuPont, sepse politikat rregullatore të brendshme dhe presionet që filluan në 1970 kishin vendosur më shumë kufizime mbi DuPont sesa mbi kompetitorët e tij europian. Industria amerikane po përballej ndërkohë me kosto që homologët europian nuk i kishin, dhe nisur nga shqetësimet e vazhdueshme mbi CFCs në Shtetet e Bashkuara, DuPont dhe prodhues të tjerë amerikanë, të përfaqësuar nga një grup industrial, Aleanca për Politikën Përgjegjëse të CFC, panë kufizime të tjera mbi CFCs në Shtetet e Bashkuara si të pashmangshme. Ngaqë nuk donin të vendoseshin në disavantazh kundrejt konkurruesve të tjerë, ata mbështetën rregullimet ndërkombëtare të CFCs gjatë negociatave të Protokollit të Montrealit në 1986 (Falkner, 2001). Rregullimet ndërkombëtare premtuan jo vetëm të nivelonin fushën e lojës por edhe të krijonin mundësi eksporti: si rrjedhojë e rregullimeve të brendshme të mëparshme të CFCs, DuPont kishte eksperience në zhvillimin e zëvendësuesve për ca përdorime të CFC dhe DuPont dhe prodhues të tjerë amerikanë

panë potencialin për të marr drejtimin në zhvillimin dhe eksportimin e një sërë substancash zëvendësuese dhe teknologjive (DeSombre, 2001, p. 58). Në të kundërt, një ndalim ndërkombëtar i kimikateve të shterimit të ozonit i vunë në disavantazh prodhuesit europian të cilët nuk kishin zhvilluar zëvendësues të CFC pjesërisht sepse ata ishin përballur më parë me kufizime të brendshme më të dobëta.

Konkurrenca rregullatore ndihmon gjithashtu për të shpjeguar mbështetjen e BE-së për dhe kundërshtimin e SHBA-së ndaj Protokollit të Kartagjenës mbi Biosigurinë, një marrëveshje e adoptuar në kuadër të CBD 1992 (Konventës mbi Shumëllojshmërinë Biologjike).⁶ Bashkimi Europian përkrahu Protokollin e Kartagjenës në një përpjekje për të “institucionalizuar” qasjen e vet ndaj rregullimeve të GMO. Në vitet 1990, në përgjigje të vendosjes së shëndetit, sigurisë konsumatore dhe shqetësimeve mjedisore në Europë, Bashkimi Europian vendosi një regjim rregullator të rreptë për autorizimin dhe etiketimin e GMOs (Pollack & Shaffer, 2005). Protokollin e Kartagjenës e bëri më të lehtë për shtetet të bllokoni importet e farave dhe të mbjellave gjenetikiisht të modifikuara, pjesërisht duke lejuar shtetet të kërkonin “principin parandalues” si një justifikim për të kufizuar importet. Interesat komerciale europiane kishin pak për të humbur nga një traktat ndërkombëtar që kufizonte tregtimin e GMOs, ndërkohë që prisnin të fitonin nëse këto kufizime do t'i ngrinin kostot e kompetitorëve amerikanë ose të reduktonin kërkesën e huaj për farat dhe ushqimet bujqësore gjenetikiisht të modifikuara. Firmat amerikane, po humbnin shumë nga ky protokoll sepse duke operuar në mjedisin rregullator mbështetës të SHBA-së, ato u bënë prodhuese të mëdha dhe eksportuese të farave dhe të mbjellave gjenetikiisht të modifikuara. Duke e bërë më të lehtë për shtetet të përjashtonin këto produkte, Protokollin e Kartagjenës disavantazhonte si fermerët amerikanë ashtu dhe prodhuesit e bioteknologjisë, dhe ata me sukses presionuan qeverinë amerikane të kundërshtonte këtë protokoll (Bernauer, 2003; Schreurs, 2005).

Në mënyrë të ngjashme, dinamikat e konkurrencës rregullatore inkurajuan Bashkimin Europian për të marr një rol udhëheqës dhe Shtetet e Bashkuara një pozicion të prapambetur, në lidhje me ndryshimin klimaterik global. Përballë një politike

⁶ Megjithëse në fokusohemi në Protokollin e Kartagjenës 2000, shqetësime mbi konkurrencën rregullatore- veçanërisht në lidhje me industrinë bioteknologjike- ka luajtur gjithashtu një rol kryesor në përcaktimin e pozicioneve të SHBA-së dhe BE-së në Konventën mbi Shumëllojshmërinë Biologjike. Shiko Hopgood (1998, p. 168), Raustiala (1997), Falkner (2001), and Schreurs (2005).

rregullatore të brendshme aspak presionuese për të ulur çlirimin e karbonit, ishte në interesin ekonomik të industrisë amerikane që të kundërshtonte një marrëveshje ndërkombëtare që do t'i detyronte ta bënin këtë gjë. Anasjelltas, përpara një politike mjaft presionuese në këtë drejtim, ishte në interesin e prodhuesve europian të favorizonin një marrëveshje ndërkombëtare në mënyrë që kufizimet të vendoseshin edhe mbi konkurruesit e tyre amerikanë. Konventa Kuadër mbi Ndryshimin Klimaterik e 1992 nuk vendosi objektiva detyruese për pakësimin e çlirimit të gazit serrë. Megjithëse Shtetet e Bashkuara nënshkruan Konventën nuk miratuan ndonjë legjislacion të brendshëm thelbësor për të adresuar ndryshimin klimaterik. Kundërshtimi i ShBA-së nuk i atribuohet vetëm Partisë Republikane: shumica e cilësuar e anëtarëve të Kongresit nga të dyja partitë i kanë kundërshtuar politikat që do të kufizonin çlirimin e gazit serrë duke rritur koston e karburantit.

Protokolli i Kyoto 1997, i cili kërkonte reduktime detyruese në çlirimet e gazit serrë, rrezikonte të vendoste më shumë kosto mbi Shtetet e Bashkuara se sa mbi partnerët e tyre tregtarë. Protokolli i Kyotos vendosi vitin 1990 si vitin bazë nga i cili do të fillonte matja e reduktimit të çlirimit dhe kërkoi reduktime të njëjta nga Bashkimi Europian (8%) dhe Shtetet e Bashkuara (7%) deri në 2012. Gjithsesi, SHBA kishte pasur një rritje më të madhe ekonomike sesa BE-ja në 1990, dhe një sërë shtetesh të BE-së e kishin reduktuar çlirimin e CO2 për arsye ideosinkretike. Si pasojë, në kohën që u nënshkrua Kyoto, Shtetet e Bashkuara duhet të reduktonin çlirimin nga 30% në 35% nga nivelet e planifikuara për 2012 në mënyrë që të arrinin objektivat e Kyotos, ndërsa Bashkimi Europian duhej të bënte vetëm ulje nga 15% në 20% (Yandle & Buck, 2002). Shtetet e Bashkuara ishin gjithashtu të shqetësuara për impaktin e Kyotos mbi konkurrueshmërinë e saj vis-à-vis shteteve në zhvillim si Kina, duke qenë se bisedimet e Kyotos i përjashtonin këto vende nga çdo reduktim detyrues i çlirimeve.

Në rastin e ndryshimi klimaterik global, interesat e firmave amerikane ishin një shkak dhe pasojë e politikës së brendshme. Në princip, çështja e ndryshimit klimaterik global mund të ishte spikatur politikisht njëlloj si në ShBA ashtu dhe në Europë, dhe kështu do të kishte qenë në interesin e firmave amerikane të mbështesnin protokollin e Kyotos me termat e tij të negociueshme dhe t'i bënin ato më të përputhshme me interesat amerikane. Megjithatë, në mungesë të çdo presioni thelbësor për rregullimet e brendshme të çlirimit të gazeve serrë, industria amerikane nuk

kishte asnjë incentivë të mbështeste pjesëmarrjen e ShBA-së në strukturat rregullatore ndërkombëtare.⁷

Krahasimisht, ndërprerja e politikës së brendshme dhe konkurrencës rregullatore ka inkurajuar Bashkimi European të merrte një rol udhëheqës në adresimin e ndryshimit klimaterik. Ndërsa ndërgjegjësimi për kërcënimin që vjen nga ndryshimi klimaterik u rrit gjatë 1990, presioni i politikës së brendshme për veprim për të frenuar gazet serrë u rrit në Europë. Llogaritja për politikë-bërësit europian ishte e qartë: duke qenë se votuesit do të kërkonin gjithsesi veprim nga BE-ja mbi ndryshimin klimaterik, ishte më e preferueshme të veprohej në nivel ndërkombëtar që do i detyronte kompetitorët e BE-së të ndërmerrnin gjithashtu masa të kushtueshme. Ndërsa disa argumentuan se ngaqë BE-ja kishte taksa energjie më të larta, që e vendoste në disavantazh konkurrues me Shtetet e Bashkuara, shpresonin që të përdornin levën e angazhimeve ndërkombëtare për ndryshimin klimaterik për të presionuar Shtetet e Bashkuara të ngrinin taksat e energjisë (Yandle & Buck, 2002, p. 197).

Ne nuk pretendojmë që mbështetja e Bashkimit European ndaj Kyotos ishte fillimisht e motivuar vetëm nga interesi për të rritur kostot energjitike për kompetitorët. Në fakt, Kyoto imponoi kosto më të larta mbi Bashkimi European sesa për vendet në zhvillim, dhe angazhimet e Kyotos e detyruan Bashkimin European të ndërmarr masa më të kushtueshme se sa kishte marr më parë. Ndërkohë ne pohojmë se, ngaqë presioni i brendshëm politik do ta çonte gjithsesi Bashkimin European të vepronte për çlirimet e gazit serrë, liderët e BE-së preferuan qartësisht të presiononin shtetet e tjera që të bashkoheshin me ta në luftën kundër ndryshimit klimaterik—ndonëse fakti që kostot për të zbatuar Kyoton ishin më pak për Bashkimin European sesa për disa juridiksione të tjera sigurisht e bënë marrëveshjen më të pëlqyeshme.

Së fundmi, këndvështrimi i konkurrencës rregullatore ndihmon në shpjegimin e pozicioneve të ShBA-së dhe BE-së mbi Konventën e Stokholmit për Ndotësit e Qëndrueshëm Organik 2001 (POPs). Ky traktat përmban dy artikuj kryesor: Së pari, ai ndalon prodhimin e 12 POPs- kimikateve që lidhen me kancerin, dështimin e riprodhimit dhe defekteve në lindje- dhe së dyti vendos mekanizma për vendet nënshkruese për të rënë dakord në shtimin e POPs të reja listës së eliminuar.

⁷ Nëse SHBA-ja adopton rregullime për çlirimin e gazit serrë-atëherë ne mund të prisnim që vullneti i saj për të nënshkruar marrëveshjen ndërkombëtare mbi ndryshimin klimaterik do të rritej.

Mbështetja e administratës së Bushit për Konventën e Stokholmit nuk reflekton forcën politike të grupeve të gjelbra në Shtetet e Bashkuara. Por, buron nga fakti që kimikatet që u ndaluan nga Konventa ose ishin ndërkohë të ndaluara ose nuk ishin prodhuar në Shtetet e Bashkuara prej shumë vitesh, pjesërisht për shkak të presionit të brendshëm të mëparshëm në vitet 1970 dhe 1980. Rrjedhimisht, konventa nuk vendosi kosto të reja dhe kufizime rregullatore mbi firmat amerikane dhe premtoi të ndihmonte përhapjen e standardeve të ShBA-së ndërkombëtarisht (George, 2001). Megjithatë, konventa krijoi mekanizma për shtimin e POPs të tjera, të cilat Shtetet e Bashkuara i kundërshtuan. Në kohën kur u nënshkrua Konventa e Stokholmit kishte pak presion për rregullime të mëtejshme të brendshme për POPs. Kështu që, ishte në interesin ekonomik të industrisë amerikane të kundërshtonte çdo angazhim ndërkombëtar që mund të impononte rregullime të reja.

Si Shtetet e Bashkuara, Bashkimi European kishte kufizuar ndërkohë “dozat e pista” të POPs të rregulluara nën Konventën e Stokholmit dhe kishin pra një interes ekonomik në vendosjen e standardeve të ngjashme ndërkombëtarisht. Gjithsesi, ndryshe nga SHBA-ja që i rezistoi mekanizmave për shtimin e POPs të reja konventës, Bashkimi European e ka përkrahur këtë aspekt të saj. Shqetësimet e konkurrencës rregullatore inkurajuan mbështetjen e BE-së për “shtimin e mekanizmave”. Në këtë periudhë kur Konventa e Stokholmit po negociohej, Bashkimi European u përballë me një presion të brendshëm të fuqishëm për forcimin e rregullimeve të kimikateve toksike, dhe Komisioni European po përgatiste një letër të bardhë që do të propozonte një ngushtim dramatik të regjimit rregullator për kimikatet duke përfshirë POPs. Publikimi letrës së bardhë në 2001 mbi politikën e kimikateve (COM (2001) 88 final) inicioi një betejë të gjatë legjislativë që rezultoi në adoptimin e rregullit REACH (Regjistrimi, Vlerësimi dhe Autorizimi i Kimikateve) të Bashkimit European në 2006 (EC 1907/2006; Fisher, 2008). Dukë qenë se Bashkimi European kishte shumë gjasa të impononte kufizime të tjera mbi përdorimin e POPs-eve të ndryshme, ishte në interesin ekonomik të industrisë së BE-së për kufizime të ngjashme mbi kompetitorë të huaj nëpërmjet Konventës së Stockholmit. Në fakt, kur ajo hyri në fuqi në 2004, Komisioni kishte mbushur një listë me nëntë POPs të reja për t’ia dorëzuar për shtesë konventës (Environmental News Service, 2004).

Konkluzione

Ky artikull ka kërkuar të shpjegoj pse Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian kanë ndërruar vendet në lidhje me çështjet mjedisore ndërkombëtare; me Bashkimin Europian që zëvendëson Shtetet e Bashkuara si një lider ndërkombëtar i mjedisit në vitet 1990. Ne demonstruam se shpjegimet ekzistuese për pjesëmarrjen kombëtare në marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore, edhe pse të dobishme për shumë studime nuk mund të shpjegojnë ndryshimet në pozicionet e SHBA-së dhe BE-së. Gjithashtu, ne diskutuam që pozicionet e ShBA-së dhe BE-së në këto marrëveshje nuk janë thjesht produkt i angazhimeve të tyre respektive drejt unilateralizmit apo multilateralizmit. Në eksploruam më pas rolin e luajtur nga dy faktorë ngushtësisht të ndërlidhur: fuqinë relative politike të zgjedhësve të gjelbër dhe impaktin konkurrues të marrëveshjeve ndërkombëtare. Ne përfunduam që një model i politikës rregullatore që lidh efektet e politikës së brendshme dhe konkurrencës rregullatore ndërkombëtare jep shpjegimin më të fuqishëm për ndryshimin e pozicioneve të ShBA-së dhe BE-së në politikat mjedisore ndërkombëtare. Sa më e fortë të jetë influenca politike e presionit të gjelbër, aq më shumë të rrepta janë standardet e brendshme dhe aq më shumë është në interesin konkurrues të ekonomisë vendase të mbështes marrëveshje ndërkombëtare multilaterale që i ndërkombëtarizojnë këto lloj standardesh. Në të kundërt, kur presioni i grupeve ambientaliste dhe partive të gjelbra është relativisht i dobët, mbështetja politike e brendshme për marrëveshjet ndërkombëtare të mjedisit gjithashtu dobësohet. Kur forcat e brendshme ambientaliste janë më të dobëta dhe standardet e brendshme më tolerante, firmat vendase dhe qeveritë kanë një interes ekonomik për të kundërshtuar marrëveshjet ndërkombëtare që do t'i detyronin ato të rrisnin standardet e brendshme.

Referencat

Barringer, Felicity. (2004, September 14). New priorities in environment. *New York Times*, p. A1.

Beck, Ulrich. (1992). *Risk society*. London: Sage.

Benedick, Reinhard. (1991). *Ozone diplomacy*. Cambridge, MA: Harvard University Press.

Bernauer, Thomas. (2003). *Genes, trade and regulation*. Princeton, NJ: Princeton University Press.

Cornwell, Rupert. (2007, June 1). Bush sidesteps G8's climate change agenda. *Independent*, Retrieved November 16, 2009, from <http://www.independent.co.uk>.

DeSombre, Elizabeth. (2000). *Domestic sources of international environmental policy*. Cambridge, MA: MIT Press.

DeSombre, Elizabeth. (2001). The experience of the Montreal Protocol. *UCLA Journal*

DeSombre, Elizabeth. (2005). Understanding United States unilateralism. In Regina

Axelrod, David Downie, & Norman Vig (Eds.), *The global environment* (pp. 181-199). Washington, DC: CQ Press.

Duchêne, Francois. (1972). Europe in world peace. In R. Mayne (Ed.), *Europe tomorrow* (pp. 32-47). London: Fontana/Collins.

Dunlap, Riley, & Scarce, Rik. (1991). Environmental problems and protection. *Public Opinion Quarterly*, 55, 651-672.

Environmental News Service. (2004, November 19).

Europe gets new leadership, ratifies

POPS Treaty. Retrieved November 16, 2009, from <http://www.ens-newswire.com>

Falkner, Robert. (2001). Business conflict and US international environmental policy.

In Paul Harris (Ed.), *The environment, international relations and US foreign policy* (pp. 157-177). Washington, DC: Georgetown University Press.

Farrell, Mary. (2007). From EU model to external policy? In Sophie Meunier & Kathleen

McNamara (Eds.), *Making history: The state of the EU* (Vol. 8, pp. 299-315). Oxford,

UK: Oxford University Press.

Fisher, Elisabeth. (2008). The "perfect storm" of REACH. *Journal of Risk Research*, 11, 541-563.

Frank, David John. (1999). The social bases of environmental treaty ratification, 1900-1990. *Sociological Inquiry*, 69 (4), 523-550.

George, Nicholas. (2001, May 23). Top pollutants treaty to be signed. *Financial Times*, p. 14.

Guber, Deborah L. (2003). *The grassroots of a green revolution*. Cambridge, MA: MIT Press.

Hofrichter, Jürgen, & Reif, Karlheinz. (1990). Evolution of environmental attitudes in the European Community. *Scandinavian Political Studies*, 13(2), 119-146.

Hopgood, Stephen. (1998). *American foreign environmental policy and the power of the state*. Oxford, UK: Oxford University Press.

Ikenberry, John. (2003). Is American multilateralism in decline? *Perspectives on Politics*, 1, 533-550.

Jacobson, Harold. (2002). Climate change, unilateralism, realism and two-level games. In Shepard Forman & Patrick Stewart (Eds.), *Multilateralism and US foreign policy* (pp. 415-436). Boulder, CO: Lynne Rienner.

Jupille, Joseph. (1999). The EU and international outcomes. *International Organization*, 53 (2), 409-425.

Jupille, Joseph, & Caporaso, James. (1998). States, agency, and rules. In Carolyn Rhodes (Ed.), *The European Union in the world community* (pp. 213-230). Boulder, CO: Lynne Rienner.

Kagan, Robert. (2003). *Of paradise and power: America and Europe in the new world order*. New York: Alfred A. Knopf.

Kormos, Cyril, Grosko, Brett, & Mittermeier, Russell. (2001). US participation in international environmental law. *Georgetown International Environmental Law Review*, 13(3), 661-693.

Ladd, Everett, & Bowman, Karlyn. (1995). *Attitudes toward the environment: Twentyfive years after Earth Day*. Washington, DC: American Enterprise Institute.

Mair, Peter. (2001). The green challenge and political competition. *German Politics*, 10(2), 99-116.

Malone, David, & Foong Khong, Yuen. (2003). *Unilateralism and US foreign policy:*

International perspectives. Boulder, CO: Lynne Rienner.

Meyer, John, Frank, David John, Hironaka, Ann, Schofer, Evan & Tuma, Nancy.

(1997). The structuring of a world environmental regime, 1870-1990. *International Organization*, 51, 623-651.

Morin, Richard. (1995, June 5-11). A lighter shade of green. *Washington Post National Weekly Edition*, p. 17. Oh no, Kyoto. (2001, April 7). *Economist*, p. 23.

Pollack, Mark. (1997). Representing diffuse interests in EC policy-making. *Journal of European Public Policy*, 4(4), 572-590.

Pollack, Mark, & Shaffer, Greg. (2005). Agricultural biotechnology policy in the

EU. In Helen Wallace, William Wallace, & Mark Pollack (Eds.), *Policy-making in the European Union* (5th ed., pp. 329-352). New York: Oxford University Press.

Porter, Michael. (1990). *The competitive advantage of nations*. New York: Free Press.

Prestowitz, Clyde. (2003). *Rogue nation*. New York: Basic Books.

Raustiala, Kal. (1997). Domestic institutions and international regulatory cooperation.

Recchia, Steven. (2002). International environmental treaty engagement in 19 democracies. *Policy Studies Journal*, 30 (4), 470-494.

Saad, Lydia. (1999, April). 1999 Earth Day poll. *Gallup Poll Monthly*, pp. 38-44.

Saad, Lydia. (2005, April 21). Public's environmental outlook grows more negative. *Gallup News Service*. Retrieved November 16, 2009, from <http://www.gallup.com>

Saad, Lydia. (2006, April 20). Americans see environment as getting worse. *Gallup News Service*. Retrieved November 16, 2009, from <http://www.gallup.com>

Sands, Philippe. (1994). The "greening" of international law. *Indiana Journal of Global Legal Studies*, 1, 293.

Sbragia, Alberta, & Damro, Chad. (1999). The changing role of the EU in international environmental politics. *Environment & Planning C: Government and Policy*, 17 (1), 53-68.

Sbragia, Alberta, & Hildebrand, Philipp. (2000). The EU and compliance. In Edith Brown Weiss & Harold Jacobson (Eds.), *Engaging countries* (pp. 215-252). Cambridge, MA: MIT Press.

Scheipers, Sibylle, & Sicurelli, Daniela. (2007). Normative power Europe: A credible utopia? *Journal of Common Market Studies*, 45 (2), 435-457.

Schreurs, Miranda. (2005). Global environment threats in a divided northern community. *International Environmental Agreements*, 5, 349-376.

Schreurs, Miranda, & Tiberghien, Yves. (2007). Multi-level reinforcement: Explaining European Union leadership in climate change mitigation. *Global Environmental Politics*, 7(4), 19-46.

Skodvin, Tora, & Andresen, Steinar. (2006). Leadership revisited. *Global Environmental Politics*, 6(3), 13-27.

Sprinz, Detlef, & Vahtoranta, Tapani. (1994). The interest-based explanation of international environmental policy. *International Organization*, 48 (1), 77-105.

Vig, Norman, & Faure, Michael. (Eds.). (2004). *Green giants?* Cambridge, MA: MIT Press.

Vogel, David. (2003). The hare and the tortoise revisited. *British Journal of Political Science*, 33 (4), 557-580.

Vogler, John, & Stephan, Hannes. (2007). The European Union in global environmental governance. *International Environmental Agreements*, 7, 389-413.

Weiner, Jonathan. (2004). Convergence, divergence, and complexity in US and European risk regulation. In Norman Vig & Michael Faure (Eds.), *Green giants* (pp. 73-109). Cambridge, MA: MIT Press.

Yandle, Bruce, & Buck, Stuart. (2002). Bootleggers, Baptists, and the global warming battle. *Harvard Environmental Law Review*, 26, 177-229.

Young, Oran. (1991). Political leadership and regime formation. *International Organization*, 43(3), 349-375.

Bios

David Vogel

është profesor në Shkollën e Biznesit Haas dhe Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Kalifornisë, Berkeley në Berkeley, CA.

R. Daniel Kelemen

është profesor i asociuar në Departamentin e Shkencave Politike dhe drejtor i Qendrës për Studime Europiane në Universitetin Rutgers në Neë Brunswick, NJ.

Rita Floyd *

DEBATI PËR SIGURINË MJEDISORE DHE RËNDËSIA E TIJ PËR NDRYSHIMET KLIMATERIKE

Siguria mjedisore u shfaq si koncept dhe njëkohësisht si grup politikash si rrjedhojë e fundit të Luftës së Ftohtë. Për pasojë, njëherazi u hapën debate të reja rreth natyrës së kërcënimit, objektit të sigurisë të referuar duhur dhe gjithashtu kuptimit të vetë sigurisë. Në të njëjtën kohë dhe për të njëjtën arsye, nevojitej një grup i ri 'ligjërimesh për rrezikun' nga ana e sistemit të sigurisë së Shteteve të Bashkuara. Siguria mjedisore u bë shpejt një nga çështjet më të njohura në këtë periudhë të re të studimeve të sigurisë. Megjithëse aktualisht është anashkaluar nga 'lufta mbi terrorin', lidhja e mundshme ndërmjet ngrohjes globale dhe sigurisë i jep një intensitet të ri debatit mbi sigurinë mjedisore. Ky artikull e rishikon këtë debat dhe njëkohësisht merr në konsideratë rëndësinë e tij për sigurizimin (*securing*) e klimës; që do të thotë t'i bësh ndryshimet klimatike një çështje sigurie.

Përkrahësit e hershëm

Në kuadër të nën-disiplinës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare të studimeve të sigurisë, siguria konsiderohet si një 'koncept thellësisht i kundërshtuar'.¹ Kundërshtia ndaj konceptit të sigurisë del në funksion të faktit se kuptimi i sigurisë nuk është i dhënë ontologjikisht, por ndryshon në kohë.² Meqë siguria nuk ka një kuptim të qëndrueshëm, koncepti nënkupton diçka të ndryshme për çdo traditë brenda studimeve të sigurisë. Si rrjedhojë, traditat e ndryshme në studimet e sigurisë e konceptojnë shumë ndryshe sigurinë mjedisore; duke ndryshuar shumë në kuptimin se kush

* Rita Floyd është Post-Doktorante e në Universitetin e Warwick dhe Studiuese e Asociuar në Institutin për Sigurinë Mjedisore. Autorja dëshiron të falenderojë dy kritikë anonimë për komentet e tyre të dobishme, si dhe Jonathan Floyd për bisedat e shumta të vlefshme për këtë artikull

¹ Walter B. Gallie cituar në Buzan, *People, States and Fear*, 7.

² Wæver, "Peace and Security".

ose çfarë duhet siguruar, kundër çfarë duhet të sigurohet dhe gjithashtu natyra e vetë kërcënimit. Si rezultat, siguria mjedisore nuk është aq shumë një koncept se sa një debat, me qasje të ndryshme ndaj sigurisë mjedisore në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Megjithëse siguria mjedisore lindi me fundin e Luftës së Ftohtë, një sërë shkrimtarësh të zgjedhur bënë thirrje shumë më parë për ripërkufizimin e sigurisë kombëtare për të përfshirë çështjet mjedisore. Në shkrimin e vitit 1983, për shembull, studiuesi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Richard Ullman argumentoi që ripërkufizimi i sigurisë kombëtare të përfshijë pamjaftueshmërinë e lëndëve të para si dhe fatkeqësitë natyrore.³

Megjithëse sipas Ullman kishte pak dyshim për vendin e duhur të çështjeve mjedisore në agjendën e sigurisë kombëtare, ai kuptoi se në klimën ushtarake të Luftës së Ftohtë një ripërkufizim i tillë do të që i vështirë për t'u arritur dhe duhet të fillojë me rritjen e edukimit të publikut rreth potencialit kërcënues të një keqfunksionimi të mjedisit. Ndoshta ky edukim i publikut ishte ofruar nga punët kryesisht përshkruese të shkencëtarit të njohur ambientalist Norman Myers⁴ dhe pastaj nga Zv. Presidentja e Institutit të Burimeve Botërore Jessica Tuchman Mathews⁵, e cila përshkroi peizazhe të zymta për gjendjen e mjedisit madje edhe më të zymta për skenarët e ardhshëm dhe e bazuar mbi këtë bëri thirrje për zgjerimin e konceptit të sigurisë kombëtare duke përfshirë çështjet mjedisore. Ky fokusim mbi sigurinë kombëtare është veçanërisht interesant sepse këta shkrimtarë në fakt ishin kaq të gjerë në interpretimin e tyre të sigurisë mjedisore sa që ata mund të pozicionohen lehtësisht brenda diskurseve të sigurisë njerëzore mbi sigurinë mjedisore. Arsyet se pse ata zgjodhën për të përkrahur sigurinë mjedisore si një çështje e sigurisë kombëtare, është së shumica e tyre kuptuan që zërat e tyre do të dëgjoreshin më shumë nëse ata qëndronin brenda leximit shtet-centrik të sigurisë.⁶

Siguria ushtarake dhe mjedisore

Një tjetër shkrimtar i njohur për çështjet mjedisore që e kuptoi qartë nevojën për të mbetur brenda traditës është Arthur Westing. Westing, i bindur që siguria mjedisore është një prej komponentëve të sigurisë njerëzore (tjetri është siguria politike)⁷ përqendrohet

³ Ullman, "Redefining Security", 19.

⁴ Myers, "Environment and Security", përgjatë librit

⁵ Tuchman Mathews, "Redefining Security", përgjatë librit

⁶ Dabelko, *Tactical Victories and Strategic Losses*.4.

⁷ Westing, "The Environmental Component of Comprehensive Security", 129.

në shumicën e shkrimeve të tij për rolin negativ të ushtrisë mbi mjedisin natyror, si gjatë luftës ashtu edhe gjatë përgatitjes për luftë. Krahasuar me historinë e shkurtër të sigurisë mjedisore, kjo qasje ka një traditë të gjatë dhe daton që nga viti 1960 dhe angazhimi i SHBA-ve në luftën mjedisore në konfliktin me Vietnamin. Lufta mjedisore i referohet shkatërrimit të planifikuar të mjedisit natyror - qoftë kjo përmes herbicideve, bombave/agentëve kimikë, granatë hedhësve, zjarrvënies së pyjeve ose kripëzimi i tokës së punueshme ose rezervuarve të ujërave të ëmbla, për shembull, duke prishur digat si një pjesë e rëndësishme e strategjisë së përgjithshme të ushtrisë. Përtej luftës, kjo qasje kritikon sjelljen e keqe mjedisore të ushtrisë gjatë trajnimeve ose përgatitjeve për luftë e cila, gjatë Luftës së Ftohtë çoi në ndotjen toksike të bazave ushtarake dhe zonave përreth tyre, si dhe burimet e ujit dhe liqenet në të gjithë Amerikën. Fokusimi i Westing në rolin e institucionit të sigurisë tradicionale në shkatërrimin sistematik të mjedisit natyror është pra jo vetëm i ngushtë në fokusin e tij, por ka ndikim të konsiderueshëm si një kritikë e forcave të armatosura.

Kjo nuk ka qenë kurrë më e qartë se sa në fundin e Luftës së Ftohtë kur si Departamenti i Energjisë së SHBA-ve (DIE) ashtu dhe Departamenti i Mbrojtjes (DiM) u vunë nën një presion të jashtëzakonshëm nga opinioni publik për sjelljen e keqe ndaj mjedisit. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, anëtarët e zgjedhur të kongresit, përfshirë Al Gor, u bënë jashtëzakonisht të interesuar në ndryshimin e rolit negativ të ushtrisë dhe filluan të promovonin ushtrinë si një kujdestare e mirë e mjedisit. Kjo lëvizje nuk ishte aq altruiste sa mund të duket, DiM ishte më i interesuar për krijimin e kushteve mjedisore që mund të dëmtonin aftësinë e tij për të përgatitur ose për të zbatuar Strategjinë e Sigurisë Kombëtare.⁸ Përveç kësaj, me përfundimin e konfliktit të superfuqive, të gjitha institucionet e sigurisë ishin nën presionin e gjetjes së 'ligjërimëve të reja të rrezikut'⁹ që do t'i pajiste ato me *të drejtën për ekzistencë* dhe si rrjedhojë të siguronin financim.¹⁰ Rrjedhimisht, ideja që kapacitetet unike ushtarake, si mjetet e komunitetit informativ të mbrojtjes, mund të përdoren për të 'analizuar, parashikuar dhe përmirësuar problemet mjedisorendërkombëtare'¹¹ ishte një propozim i mirëpritur dhe siç e ka emërtuar Ronald J. Deibert, me të lindi 'kompleksi i sigurisë mjedisore ushtarake'.¹²

⁸ Goodman, *Military capabilities related to Environmental Security*, 98.

⁹ Campbell, *Writing Security*, 170.

¹⁰ Floyd, "Typologies of securitisation and desecuritisation".

¹¹ Dabelko and Simmons, "Environment and Security", 137.

¹² Dabelko and Simmons, "Environment and Security", 137.

Duke pasur parasysh këtë, nuk ka dyshim që strategjia amerikane e mbrojtjes për sigurinë mjedisore (gjithashtu e njohur si ambientalizimi i mbrojtjes) ka pasur një sërë pasojash pozitive, duke përfshirë ndër të tjera, krijimin e një buxheti vjetor të qëndrueshëm prej 5 miliardë dollarësh (nga 1994-2000), prezantimin e një strategjie për parandalimin e ndotjes në vitin 1994 dhe misionet e suksesshme të pastrimit të mjedisit jashtë vendit. Vlen për t'u përmendur, misioni nën drejtimin e amerikanëve për pastrimin dhe magazinimin e karburanteve nukleare të përdorura në zonën e Murmansk-ut në kuadrin e programit të Bashkëpunimit Ushtarak Mjedisor të Arktikut (AMEC). Nga ana tjetër, nuk ka dyshim që në sferën e brendshme siguria e mjedisore e mbrojtjes ishte gjerësisht e barazvlefshme me të vepruarit në përputhje me legjislacionin ekzistues federal, shtetëror dhe ndërkombëtar për mjedisin çka ofronte pak vlera të reja.¹³ Pjesërisht për shkak se kjo strategji e sigurisë mjedisore është kritikuar shumë, ambientalistët dhe shumë brenda komunitetit të sigurisë, qysh në fillim, ishin kundër lidhjes së ushtrisë me mjedisin, me argumentin standard që një lidhje e tillë mund të çonte në militarizimin e mjedisit, proces përmes të cilit siguria mjedisore i referohet thjesht kapacitetit të ushtrisë 'për t'u adaptuar në fushën e çështjeve mjedisore'.¹⁴ Në lidhje me këtë, është argumentuar që institucionet që garantojnë siguri nga degradimi mjedisor (për shembull, Agjencia e Mbrojtjes Mjedisore) dhe institucionet që garantojnë siguri nga dhuna (ushtria) janë krejtësisht të papërputhshme. Mënyra se si ato punojnë dhe mjetet që ato përdorin janë në kundërshtim të njëri-tjetrit: ushtria vepron në mënyrë të fshehtë, ndërsa puna e agjencive të mbrojtjes mjedisore është e hapur dhe qëllimisht e aksesueshme pasi ata kërkojnë në mënyrë aktive që të informojnë dhe edukojnë publikun.¹⁵ Në përgjithësi, të gjitha kritikën e sigurisë mjedisore të mbrojtjes bien dakord se ky koncept zbeh faktin që ushtritë e botës janë një nga shkaqet kryesore të degradimit të mjedisit.¹⁶ Një tjetër kritikizëm i tillë unifikues do të ishte i diskutueshëm nëse diçka cilësohet si një çështje sigurie thjesht për shkak të të qenit me interes për agjencitë e strukturave të sigurisë.

¹³ Floyd, "Towards a consequentialist evaluation of security", 345-6.

¹⁴ Käkönen, *Green security or Militarised environment*, 2.

¹⁵ Deudney, "The Case against Linking Environmental Degradation and National Security", 465.

¹⁶ Finger, "The military, the nation state and the environment".

Konflikti mjedisor

Ekuacioni i sigurisë është më i dukshëm në rastin e tezës së konfliktit mjedisor, veçanërisht nëse ne pranojmë që 'ka dy mënyra të zgjerimit të konceptit të sigurisë'. Ose fushat e tjera *lidhen* me ushtrinë, ose ato janë *ekuivalente* me problemet ushtarake'.¹⁷ Ideja që çështjet mjedisore mund të çojnë në konflikte të dhunshme hidhet poshtë në përkufizimin e parë, ku ne gjejmë ende një rol tjetër për ushtrinë në debatin për sigurinë mjedisore.

Ideja që çështjet mjedisore mund të çojnë në konflikte të dhunshme ka marrë vëmendje të veçantë në literaturën e sigurisë mjedisore dhe sot ekzistojnë disa qasje konkurruese ndaj konfliktit mjedisor. Më e përhapura nga këto përqendrohet në rolin e pamjaftueshmërisë mjedisore si një variabël i pavarur në konflikt të dhunshëm. Kjo tezë është zhvilluar më shumë nga të ashtuquajturit Grupi i Torontos nën drejtimin e Thomas Homer-Dixon. Që nga viti 1989, ky grup ka ndërmarrë një seri rastesh studimore (duke përfshirë Meksikën, Pakistanin, Ruandën dhe Afrikën e Jugut), dhe zhvilluan tezën se kur mungesa e burimeve të rinovueshme (si tokat dhe uji i liqenit) ndërvepron me efekte të ashpra sociale (për shembull, zhvendosjen e popullsisë ose rënien ekonomike) mund të çojë në konflikt ndërshtetëror.¹⁸ Në këtë formulim, koncepti i pamjaftueshmërisë mjedisore është formuluar shumë gjerë. Kështu Homer-Dixon e interpreton "të gjitha llojet e varfërimit ose dëmtimit mjedisor si forma të ndryshme të pamjaftueshmërisë së burimeve të rinovueshme. Shpyllëzimi rrit pamjaftueshmërisë e burimeve pyjore, ndotja e ujit rrit pamjaftueshmërisë e ujit të pastër, dhe ndryshimet klimaterike rrisin pamjaftueshmërinë e regjimit të reshjeve dhe temperaturës në të cilat mbështeten fermerët."¹⁹ Një koncept kryesor në punën e Homer-Dixon-it mbi pamjaftueshmërinë që nxit konflikt mjedisor është ai i 'kapjes së burimit', ideja është që 'pamjaftueshmëria mjedisore inkurajon grupet e fuqishme për të kapur burimet e çmuara mjedisore dhe shtyn grupet marxhinale për të emigruar në zonat ekologjikisht të ndjeshme. Këto dy procese nga ana tjetër përforcojnë pamjaftueshmërinë mjedisore dhe rrisin potencialin për destabilitet social.'²⁰

Teza e pamjaftueshmërisë e Grupit të Torontos ka pasur ndikim si brenda ashtu edhe jashtë botës akademike. Në vitin 1994,

¹⁷ Wæver, "Concepts of security", 45 (theksi tek origjinali).

¹⁸ Homer-Dixon, *Environment, Scarcity, and Violence*, 177.

¹⁹ *Ibid.*, 9.

²⁰ Homer-Dixon, "The Project on Environment, Population and Security", 46.

pasi shkrimtari i njohur Robert Kaplan përdori tezën e Grupit të Torontos në një ese për *The Atlantic Monthly* në të cilën e shpall mjedisin si 'çështje të sigurisë kombëtare në fillim shekullit të njëzet e një',²¹ Homer-Dixon u ftua dy herë për të informuar shkurtimisht Zëvendës Presidentin Gore.²² Përmbledhja e parë ishte për tezën e pamjaftueshmërisë në përgjithësi, e dyta u fokusua veçanërisht në problemet mjedisore në Kinë. Edhe pse Gore kishte interes afatgjatë në çështjet e mjedisit dhe, ashtu si të tjerët, nevojë për të shpjeguar dhe kuptuar karakteristikat e konflikteve ndërshtetërore të fillim viteve 1990, në mungesë të retorikës së implementimit të argumenteve të pamjaftueshmërisë, u bë pak sa i përket politikëbërjes aktuale në përgjigje të tezës së konfliktit mjedisor.²³

Në botën akademike të sigurisë mjedisore, megjithatë, angazhimi me tezën e pamjaftueshmërisë së Grupit të Torontos është një proces në vazhdim. Që kur u shpall për herë të parë, teoria e Grupit të Torontos është kritikuar se ofron pak risi për rolin dhe përkufizimin e pamjaftueshmërisë si një variabël i pavarur dhe për zgjedhjen e rasteve studimore.²⁴ Lista vazhdon. Dëshmi të kundërshtisë së tezës janë edhe debatet midis Homer-Dixon dhe kritikëve të tij në faqet e revistës më të njohur për sigurinë mjedisore, raporti vjetor i *Projektit Ndryshimi mjedisor dhe Siguria* i Qendrës Woodrow Wilson. Mbi të gjitha, kundërshtia është e dukshme në faktin se u shfaqën një sërë tezash rivale të konfliktit mjedisor, të cilat janë zhvilluar në kundërshtim të hapur ndaj tezës së pamjaftueshmërisë mjedisore.

Një nga këto teza rivale është ideja se nuk është pamjaftueshmëria e burimeve që çon në konflikt civil, por e kundërta, tepria e tyre. E ashtuquajtura teza e "kavanozit me mjaltë" pretendon se ka një

²¹ Kaplan, "The Coming Anarchy", 190.

²² Duhet të theksohet se Homer-Dixon ka qenë në kontakt me politikëbërësit në Uashington para shkurtit të vitit 1994. Për shembull, që në vitin 1992, ai mbajti një takim për sigurinë kombëtare nën kujdesin e P.J. Simmons (i cili punonte në atë periudhë në Drejtorinë e Çështjeve Mjedisore Globale në Këshillin për Sigurinë Kombëtare dhe në Arkivin e Sigurisë Kombëtare dhe, në vjeshtë të vitit 1994, vazhdoi të drejtonte Qendrën për Ndryshime Mjedisore dhe Siguria, e krijuar pranë Qendrës për Studime Woodrow Wilson). Megjithatë, Homer-Dixon u kontaktua nga stafi i Al Gore vetëm pas publikimit të 'Anarkisë që po troket' të Kaplan. Ky informacion është marrë nga një intervistë e autorit me Homer-Dixon në Korrik 2005.

²³ Floyd, "Typologies of Securitisation and Desecuritisation", 339.

²⁴ Levy, "Is the Environment a National Security issue?"; Peluso and Watts, "Violent Environments"; Gleditsch, "Armed Conflict and the Environment"

tepri të burimeve të vlefshme (të tilla si minerale, gurë të çmuar apo të naftës) që i bën njerëzit të luftojnë.²⁵ Ndërsa teza e kavanozitet me mjaltë duket mjaftueshëm bindëse, përkrahësit e tezës së pamjaftueshmërisë së mjedisit theksojnë se teza e teprisë së burimeve në fund të fundit bie në kundërshtim me tezën e pamjaftueshmërisë pasi burimet me tepri në nivel lokal janë të vlefshme vetëm për shkak se ato janë të pakta në shkallë globale.²⁶ Në lidhje me këtë, ata theksojnë se 'logjika e kavanozitet me mjaltë qartazi vlen më shumë për situatat në të cilat burimet me tepri në fillim bëhen gjithnjë e më të pakta me kalimin e kohës. [...] Ndërsa burimet natyrore konsumohen apo degradohen me ritme të paqëndrueshme, vlera e tyre rritet dhe grupet sociale rivale nxiten më shumë për t'i marrë ato.'²⁷

Një tjetër teori rivale vjen nga ekologjistët politikë të cilët argumentojnë se "në vend që të prezumojmë ose fillojmë me pamjaftueshmërinë apo teprinë, analiza e këtyre rasteve të dhunës duhet të fillojë pikërisht me marrëdhëniet dhe ndryshimin ndërmjet ekonomisë politike dhe mekanizmave të aksesit, kontrollit dhe luftës për burimet mjedisore. Pamjaftueshmëria dhe tepria janë shprehje të prodhuara historikisht prej marrëdhënieve të tilla, dhe për këtë arsye nuk duhet të jenë pikënisja e analizës".²⁸ Këta studiues nuk janë dakord me interpretimin e pamjaftueshmërisë mjedisore të Grupit të Torontos pasi është aq gjithëpërfshirës sa bashkon procese të ndryshme në një fenomen.

Sipas njërit prej përkrahësve, "duke i shtuar përkufizimit të pamjaftueshmërisë së mjedisit shpërndarjen sociale të burimeve, Homer-Dixon *de facto* krijon një lidhje me konfliktin, meqenëse konflikti politik vërtitet shpesh rreth çështjeve të kontrollit të burimeve. Ky është mjeti kryesor me anë të të cilit ai është në gjendje të nxisë situata konfliktuale shumë të ndryshme në modelin e tij universalizues por rezultati është një model aq gjithëpërfshirës sa duket i rëndomtë".²⁹ Është e kotë për t'u përmendur që teoricienët e pamjaftueshmërisë i kanë kundërshtuar këto pretendime.³⁰

Ajo që vihet re për këtë qasje të fundit është që, ndryshe nga teori të tjera të konfliktit mjedisor, kjo nuk ka të bëjë me gjetjen e

²⁵ De Soysa, "The Resource Curse"; Collier and Hoeffler, *Greed and Grievance in Civil War*.

²⁶ Kahl, *States, Scarcity and Civil Strife in the Developing World*, 18.

²⁷ *Ibid*, 19.

²⁸ Peluso and Watts, *Violent Environments: Responses*, 93.

²⁹ Hartmann "Population, Environment and Security: A new Trinity" 117

³⁰ Kahl, *Review of Violent Environments*; Homer-Dixon, *Debate on Violent Environments*.

shkaktarëve të konfliktit mjedisor; më tepër ekologjistët politikë janë të interesuar për ‘prodhimin, miratimin dhe pasqyrimin e dhunës kundër njerëzve në lidhje me mjedisin’.³¹ Pra, këta analistë i largohen interesit për sigurinë e shteteve dhe drejt një interpretimi të sigurisë mjedisore me qendër njeriun, duke theksuar se shteti nuk është gjithmonë ofruesi i duhur i sigurisë, por përkundrazi mund të jetë burim i pasigurisë dhe dhunës për qeniet njerëzore - një bindje e përbashkët e një sërë të ashtuquajturash qasje kritike ndaj sigurisë.

Qasja e sigurisë njerëzore ndaj sigurisë mjedisore

Raporti për Zhvillim Njerëzor i vitit 1994 që vuri themelet për konceptin e sigurisë njerëzore duke vendosur individin në fokusin e sigurisë. Siguria njerëzore mund të thuhet se ka dy aspekte kryesore. Së pari, ajo nënkupton siguri nga kërcënime të tilla kronike si uria, sëmundjet dhe represioni. Dhe së dyti, ajo do të thotë mbrojtje nga trazirat e papritura dhe që dëmtojnë modelet e jetës së përditshme.³² Në këtë përkufizim pra, siguria njerëzore ka të bëjë me pasigurinë e përditshme të njerëzve e shkaktuar jo vetëm nga konflikti, por edhe nga kushtet e këqija të jetesës të atyre në pozita të pafavorshme. Në literaturën akademike, ekziston një debat i madh nëse siguria njerëzore duhet të lidhet vetëm me të parën më sipër, “liri nga frika”, apo nëse ajo duhet të përfshijë edhe “lirinë nga të dëshiruarit”. Raporti i UNDP-së identifikon shtatë “fusha” të ndryshme të sigurisë njerëzore – siguria mjedisore (shpesh në formën e pasojave të katastrofës mjedisore) është një prej tyre. Këtu, qartazi, ekuacioni i sigurisë nuk përfshin çështje që lidhen me ushtrinë, por më tepër situata aq të vështira sa ato janë ekuivalente me luftën.

Në literaturën e sigurisë mjedisore ka shumë proponent që përkrahin idenë që individi është objekti referent i përshtatshëm (ai që është për t’u siguruar) për sigurinë e mjedisit. Këto proponent zakonisht e pozicionojnë veten në kundërshtim të drejtpërdrejtë ndaj tezave të ndryshme të konfliktit mjedisor dhe gjithashtu të ‘ambientalizimit të mbrojtjes’ dhe argumentojnë që, për shkak se kërcënimet e mjedisit nuk njohin kufij territorialë, siguria e vërtetë e mjedisit mund të arrihet vetëm nëse siguria mjedisore largohet nga kërcënimi shtet-centrik dhe lidhjes me mbrojtjen. Përkrahësit e qasjes së sigurisë njerëzore për sigurinë

³¹ Peluso and Watts, “Violent Environments”, 26.

³² UNDP, *Human Development Report 1994*, 23.

mjedisore pra fokusohen në çështje të tilla si ndërvarësia ekologjike, të drejtat e njeriut, impakti i globalizimit dhe efekti i modelit të konsumit të Veriut ndaj Jugut global.³³ Për ata, natyra e kërcënimit rrjedh nga rreziqet e degradimit afatgjatë të mjedisit, të tilla si ngrohja globale, zmadhimi i ozonit, zhdukja e specieve të rralla, ndotja e ajrit dhe ujit, dhe humbja e biodiversitetit të cilat janë nga natyra jo të dhunshme. Në këtë qasje, siguria mjedisore mund të përcaktohet më mirë si: “Procesi i reduktimit në mënyrë paqësore të vulnerabilitetin të njeriut në nxitjen prej tij të degradimit të mjedisit duke adresuar shkaqet e degradimit të mjedisit dhe pasigurisë njerëzore”.³⁴ Zhvillimi në mënyrë të qëndrueshme është një çështje kryesore me interes për përkrahësit e kësaj qasjeje.

Pavarësisht apelit të qasjes së sigurisë njerëzore ndaj sigurisë mjedisore, kjo qasje – ashtu si siguria njerëzore në përgjithësi - mund të kritikohet se është shumë gjithëpërfshirëse dhe që ofron pak rekomandime të realizueshme për hartimin e politikave, prandaj duke u bërë pak më tepër se një kritikë e shumë qasjeje të kryesore.

Një kritikë tjetër akoma më ashpër mund të nxirret nga puna e Ole Wæver dhe zhvillimin nga ana e tij e qasjes me ndikim të madh të sigurizimit, bashkë me konceptin e de-sigurizimit (*de-securitization*). Qasja e sigurizimit thotë se siguria është një akt ligjërimit, që vetëm duke shqiptuar “siguri”, diçka është duke u bërë. Një aktor që artikulon procesin e sigurisë, duke deklaruar që një objekti i caktuar që i referohet është kërcënuar në ekzistencën e tij, pretendon të drejtën për marrjen e masave të jashtëzakonshme për të siguruar mbijetesën e objektit që i referohet. Çështja kështu zhvendoset nga sfera e politikave normale në fushën e politikave emergjente, ku nuk trajtohet sipas rregullave normale dhe rregulloreve të hartimit të politikave. Në këtë kuptim pra siguria është parë si një praktikë vetë-referuese që nuk i drejtohet kërcënimeve objektive të sigurisë jashtë vetes. Për shkak të kësaj, Wæver kundërshton të gjitha formulimet alternative të sigurisë që lidhen me kërcënime të sigurisë të supozuara objektive dhe na kërkon të “heqim dorë nga supozimi që siguria është, detyrimisht, një fenomen pozitiv”.³⁵ Theksi duhet të vihet më tepër tek de-sigurizimi, procesi i kundërt i sigurizimit dhe çështjet e sigurizuara më parë bëhen edhe një herë çështje të politikës normale. Për të kuptuar këtë theks të veçantë në

³³ See, for example, Dalby, *Environmental Security*.

³⁴ Barnett, *The Meaning of Environmental Security*, 129.

³⁵ Wæver, “Securitization and Desecuritization”, 57.

de-sigurizimin, është thelbësore që të kuptohet se për Wæver prania e sigurisë nuk do të thotë mungesë e pasigurisë; më saktë “pasiguria është situata kur kemi një kërcënim dhe nuk jemi të mbrojtur kundër tij; siguria është një situatë me një kërcënim dhe mbrojtje kundër tij “. ³⁶ Me fjalë të tjera, si siguria ashtu dhe pasiguria janë të lidhura pazgjidhshmërisht me binomin mbrojtje-kërcënim dhe *maksimizimi i sigurisë nuk do të thotë më pak pasiguri*. E vetmja mënyrë për t'i shpëtuar lidhjes mbrojtje-kërcënim është që të arrihet “a-siguria (një situatë që ka nuk ka qenë asnjëherë de-sigurizuar ose sigurizuar) “. ³⁷

Paqja mjedisore/bashkëpunimi mjedisor

Argumentet për de-sigurizimin kanë qenë pjesë e debatit për sigurinë mjedisore që në fillim. Ekonomisti dhe futuristi i shquar Julian L. Simon, për shembull, pohon se debati i sigurisë mjedisore mbështetet në premisa të pavërteta pasithjesht nuk ka pamjaftueshmëri të burimeve natyrore, të paktën asnjë (e tillë) që nuk mund të kapërcehet nga gjenialiteti njerëzor dhe inovacioni teknologjik. Një citim nga deklarata e tij përmbyllëse në një debat të botuar me Myers i vitit 1994 e jep mirë qëndrimin e tij:

Standardi i jetesës është rritur së bashku me numrin e popullsisë botërore që nga fillimi i kohës tonë. Nuk ka asnjë arsye bindëse se përse këto tendenca drejt një jete më të mirë nuk duhet të vazhdojnë për një periudhë të papërcaktuar kohe. Ideja teorike kryesore është kjo: Rritja e popullsisë dhe e të ardhurave krijojnë pamjaftueshmëri reale dhe të pritshme dhe kështu çojnë në rritjen e çmimeve. Një rritje e çmimit paraqet një mundësi për sipërmarrësit që synojnë të rrisin fitimet për të kërkuar mënyra të reja që të plotësojnë pamjaftueshmërinë. Disa dështojnë, duke marrë përsipër edhe koston. Pak dalin me sukses, dhe rezultati përfundimtar është se ne përfundojmë më mirë nëse problemi fillestar i pamjaftueshmërisë të mos kishte dalë ndonjëherë ³⁸.

Përveç kësaj, Simon ishte një skeptik i njohur i ngrohjes globale dhe të tjera, siç i emërtoi ‘kushërinjtë e frikshëm’, duke

³⁶ Wæver, “Securitisation: Taking stock of a research programme in Security Studies”, 13.

³⁷ “A-siguria ... thjesht nuk është shprehur në këtë mënyrë, nuk ka të bëjë më faktin nëse është e sigurtë apo jo dhe nuk ka një perceptim që të ekzistojnë kërcënimeve ekzistenciale’. *Ibid* , 13.

³⁸ Simon, “Closing statement by Julian Simon”, 159.

përfshirë edhe shiun acid dhe shkatërrimin e shtresës së ozonit. Jo vetëm që ai vuri në dyshim të dhënat shkencore që i mbështetësin këto dhe/ose pasojat e dyshimta të tyre për mirëqenien e njerëzve (për shembull, ai vë në dyshim korrelacionin mes rritjes së rrezikut të kancerit të lëkurës dhe rritjes së niveleve të ozonit), ai ishte gjithashtu i bindur se “[...] ne tani kemi kapacitete të mëdha dhe gjithnjë në rritje për të ndryshuar tendenca të tilla, nëse ato rezultojnë të jenë të rrezikshme, dhe me kosto që janë të menaxhueshme.”³⁹ Megjithëse Simon vetë vdiq në vitin 1998, idetë e tij vazhdojnë në debatin rreth ngrohjes globale. Në mënyrë të veçantë, puna e Simonit ka qenë e dobishme për të vetë-quajturin ‘ambientalist skeptik’ Asistent Profesor në Copenhagen Business School Bjørn Lomborg, i cili në vitin 2004 ishte pjesë e listës së 100 njerëzve më me ndikim në botë në Revistën *Time*.⁴⁰

Në vitet e fundit, ka dalë një qasje e ndryshme ndaj sigurisë mjedisore që ka të bëjë me de-sigurizimin. Kështu një numër i madh studiuesish janë fokusuar në potencialin e degradimit të mjedisit për të çuar në bashkëpunim mjedisor dhe në fund të fundit në paqe, në vend të rolit të tij për të shkaktuar konflikt të dhunshëm.⁴¹ Ka tre mënyra me të cilat bashkëpunimi mjedisor

³⁹ Simon, “*Pre-Debate Statement: Julian Simon*”, 19.vjeshtë të vitit 1997 ai organizoi një grup studimi me studentët e tij më të mirë për të provuar që Simon e kishte gabim. Për çudinë e të gjithëve, shumë (megjithëse jo gjithçka) që Simon tha ishte e drejtë. Kështu grupi shkroi për rezultatet e studimit në një gazetë të njohur Daneze, *Politiken*. Ata botuan katër artikuj me pesëdhjetëburime secili, duke nxitur një debat të ndezur të shtrirë në mbi 400 artikuj në gazetata më të mëdha metropolitane. Artikujt çuan në publikimin e një libri në danisht pas atij viti dhe në lëvizjen e *Ambientalistëve Skeptikë* në 2001.’

⁴⁰ Sipas faqes së internetit të Lomborg-ut, (<http://www.lomborg.com/faq?PHPSESSID=3a0ea70f8f278f3052997758b1645a6f>), lidhja e tij me Simon filloi si më poshtë: ‘Gjithçka nisi në vitin 1997, kur Bjorn Lomborg lexoi në një revistë një intervistë të çuditshme me ekonomistin Julian Simon i cili pohonte se mjedisi, në kundërshtim me mendimin e përgjithshëm, po përmirësohej, jo keqësohej. Lomborg-u mendoi se kjo duhet të ishte e pasaktë (‘propaganda amerikane e krahut të djathtë’). Duke kërkuar për mënyra të reja për të përfshirë studentët, në vjeshtë të vitit 1997 ai organizoi një grup studimi me studentët e tij më të mirë për të provuar që Simon e kishte gabim. Për çudinë e të gjithëve, shumë (megjithëse jo gjithçka) që Simon tha ishte e drejtë. Kështu grupi shkroi për rezultatet e studimit në një gazetë të njohur Daneze, *Politiken*. Ata botuan katër artikuj me pesëdhjetë burime secili, duke nxitur një debat të ndezur të shtrirë në mbi 400 artikuj në gazetata më të mëdha metropolitane. Artikujt çuan në publikimin e një libri në danisht pas atij viti dhe në lëvizjen e *Ambientalistëve Skeptikë* në 2001.’

mund të lidhet me vendosjen e paqes. E para prej tyre lidhet me mundësinë e bashkëpunimit mjedisor në zonat me konflikte mjedisore. Ideja është që konflikti i nxitur për mjedisin të mund të kthehet nëpërmjet menaxhimit të burimeve natyrore ndërkufitare / iniciativa të ruajtjes ndërkufitare. Një shembull, ku një zonë e mbrojtur ndërkufitare (e njohur edhe si “Parku i Paqes”) ka amortizuar me sukses konfliktin e nxitur për mjedisin dhe ka zhvilluar mbrojtjen, është ajo e Cordillera del Cóndor Peace Park i themeluar në vitin 1998 midis Perusë dhe Ekuadorit.⁴²

Mënyra e dytë me të cilën bashkëpunim mjedisor ka qenë i lidhur me vendosjen e paqes është ideja se interesat e përbashkëta mjedisore mund të çojnë në dialog ndërmjet qeverive në konflikt, të cilat pastaj mund ta përhapin këtë edhe në zona të tjera. Një rast për përkrahësit e kësaj teorie është propozuar “Parku i Paqes i Siachen” në Siachen Glacier në rajonin verior të Kashmirit ku India dhe Pakistani kanë qenë në luftë që prej 1984. Zona e konfliktit Siachen është zona më e lartë e luftës në botë, e cila përbën një sforcë të paparë logjistike, financiare dhe fizike për të dyja ushtritë. Vetë konflikti, së bashku me praninë e ushtrisë në këtë zonë, përbën një shkatërrim të paprecedentë në këtë ekosistem unik. Sipas Amir Ali alpinisti indian që ka dalë në pension, i pari që sugjeroi këtë ide, një Park të Paqes në Siachen [...] do të mundësojë që të dy ushtritë të tërhiqen me nder dhe dinjitet, kjo nuk do të paragjykonte pozicionet e tyre mbi Kashmirin si një e tërë, ajo do të ndalonte degradimin e mëtejshëm të një zone malore të mrekullueshme; ajo do të shpëtonte mijëra jetë dhe miliarda rupje, ajo do të shëronte një plagë të vazhdueshme në situatën e vështirë të Kashmirit.⁴³

Teza e tretë e bashkëpunimit mjedisor pretendon se zhvillimi i qëndrueshëm është një kërkesë e domosdoshme për paqe. Ideja është se edhe në konfliktet ku problemet mjedisore ndërkufitare nuk janë burimi i konfliktit, nuk mund të vendoset paqja e qëndrueshme, pa zgjidhjen e këtyre çështjeve me rëndësi

⁴¹ Conca and Dabelko, *Environmental Peacemaking*; Ali, *Peace Parks: Conservation and Conflict Resolution*; Matthew, Halle and Switzer, *Conserving the Peace: Resources, Livelihoods and Security*. 37 Carius, *Environmental Peacebuilding: Conditions for Success*, 61-4. Protected Area”. http://www.tbpa.net/case_01.htm

⁴² UNEP, Global Transboundary Protected Areas Network, “Cordillera del Cóndor Transboundary Protected Area”. http://www.tbpa.net/case_01.htm

⁴³ Ali, “Siachen Peace Park: Solution to Half-Century of International Conflict”, 318.

jetike. Shembulli empirik i përmendur shpesh në lidhje me këtë tezë të tretë është ai i ujit në konfliktin Izrael/Palestinë, ku besohet se pa një politikë të qëndrueshme dhe të përbashkët të ujit paqja e qëndrueshme në këtë rajon me ku mungon uji nuk mund të arrihet.⁴⁴

Ajo që vihet re në lidhje me literaturën e bashkëpunimit mjedisor është se megjithëse përkrahësit janë qartazi të entuziazmuar në lidhje me mundësitë e bashkëpunimit mjedisor që çon në paqe, të gjithë duken të kujdesshëm në mbivlerësimin e lidhjes shkakësore ndërmjet bashkëpunimit mjedisor dhe paqes. Pjesa më e madhe e literaturës për bashkëpunimin mjedisor është konceptuar pra si një përpjekje normative. Sipas një përkrahësi:

Si studiues, ne duhet të identifikojnë pjesët që mungojnë nga enigma e konfliktit dhe bashkëpunimit dhe të shqyrtojmë mangësitë që pengojnë përgjigjet politike. Ne duhet të shkojmë përtej dikotomisë së rreme ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe teprisë. Ne duhet të ecim përpara dhe të rrisim përpjekjet për të ndryshuar tezën e konfliktit dhe të kërkojmë rrugë ambientaliste për ndërtimin e besimit dhe të paqes. [...] Në vend që vetëm të reagojmë ndaj simptomave të lidhjeve mjedis-konflikt, ata duhet të stabilizojnë në mënyrë aktive zonat e konfliktit duke forcuar besimin dhe duke vendosur bashkëpunimin.⁴⁵

Megjithëse, rasti i paqes mjedisore sugjeron që de-sigurizimi mund të jetë një zgjidhje më e përshtatshme për problemet e mjedisit se sa sigurizimi, ky nuk është gjithmonë dhe detyrimisht rasti, në fund të fundit, de-sigurizimi nuk çon gjithmonë në politizimin e çështjeve mjedisore. Në vend të kësaj, pasi de-sigurizohen, çështjet mjedisore mund të hiqen krejtësisht nga rendi i ditës së politikëbërjes. Një rast i ngjashëm do të jetë fati i sigurisë mjedisore të SHBA-ve nën administratën aktuale të Presidentit Bush, e cila pa zbrapsjen e iniciativave të sigurisë mjedisore të paraardhësit të tij, pa asnjë politizim të çështjeve të lartpërmendura.⁴⁶

Siguria klimaterike

Lidhja ndërmjet ngrohjes globale dhe sigurisë i ka dhënë një shtysë të re debatit të sigurisë mjedisore. Larg nga arritja e një efekti unifikues, megjithatë, mbeten ndarjet ndërmjet mbështetësve të sigurisë mjedisore dhe 'siguria klimatike' thjesht është integruar në qasjet e ndryshme të sigurisë mjedisore. Në vitin 2007, për

⁴⁴ Carius, "Environmental Peacebuilding: Conditions for Success", 62.

⁴⁵ Dabelko, "Next steps for Environment, Population, and Security", 4.

⁴⁶ Floyd, "Towards a consequentialist evaluation of security", 47-8.

shembull, njëmbëdhjetë gjeneralë të ushtrisë amerikane që kishin dalë në pension, plus ish Nënsekretari i Mbrojtjes për Sigurinë Mjedisore (1993-2000) Sherri W. Goodman, nxorën një raport të quajtur *Siguria kombëtare dhe kërcënimi i Ndryshimit Klimaterik*. Ky publikim është në të njëjtën linjë me qasjen e vjetër ‘ambientalizimi i mbrojtjes’. Kështu, nga njëra anë, ai thekson rolin e mbrojtjes dhe komunitetit të inteligjencës në këtë zonë të re, për shembull, përmes parandalimit dhe ndihmës gjatës fatkeqësisë mjedisore; madje ai sugjeron lidhjen ndërmjet ndryshimit klimaterik dhe shfaqjes së terrorizmit. Nga ana tjetër, ai përqendrohet mbi pasojat e ndryshimit klimaterik në kuadrin e sigurisë kombëtare amerikane, për shembull, është i interesuar për bazat e DiM të vendosura në zonat që do të preken nga rritja e nivelit të detit. Mesazhi është i qartë, siguria klimaterike duhet të njihet si një kërcënim për sigurinë kombëtare dhe ushtria ka për të luajtur një rol të rëndësishëm në të.

Ndryshimi i klimës gjithashtu është i njohur në literaturën e konfliktit mjedisor dhe në kuadër të qasjes së sigurisë njerëzore ndaj sigurisë mjedisore. Kjo e fundit ka të bëjë me potencialin e ndryshimit klimaterik për të nxitur konflikte të dhunshme. Homer-Dixon, për shembull, paralajmëron se, ‘Ndryshimi i klimës do të ndihmojë për të prodhuar ato sfida ushtarake që janë të vështira për t’u përballuar nga forcat e sotme konvencionale: kryengritjet, gjenocidin, sulmet guerilase, luftën ndërmjet bandave dhe terrorizmin global.’⁴⁷ Përkrahësit e qasjes së sigurisë njerëzore, nga ana tjetër, e vënë theksin tek ndërvarësia ekologjike dhe potenciali i ndryshimit klimaterik për të penguar zhvillimin, duke rritur në këtë mënyrë pabarazinë. Për shembull, Raporti për Zhvillim Njerëzor 2007-08 i OKB-së, *Lufta ndaj ndryshimit klimaterik: Solidariteti njerëzor në një botë të ndarë*, argumenton sendryshimi klimaterik është një kërcënim i madh për zhvillimin e njeriut dhe në disa vende ajo tashmë është duke dëmtuar përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të reduktuar varfërinë ekstreme. [...] Pra, ne duhet ta shohim luftën kundër varfërisë dhe luftën kundër efekteve të ndryshimeve klimatike si përpjekje të ndërlidhura. Ato duhet të përforcojnë njëra-tjetrën dhe suksesi duhet të arrihet për të dyja.⁴⁸

Pavarësisht nga ndryshimet në opinion, përkrahësit e të gjithë këtyre qasjevepa dyshim i promovojnë ndryshimet klimatike si një çështje të sigurisë. Por, a kanë të drejtë ta bëjnë

⁴⁷ T. Homer-Dixon, “*Terror in the Weather Forecast*”, *The New York Times*, 24 April 2007; see also Schwartz and Randall “*An Abrupt Climate Change Scenario*”, Walker and King, *The Hot Topic*, 47-8.

⁴⁸ UNDP, *Human Development Report 2007/2008*, v & vi.

këtë gjë? Në qoftë se kalojmë nga shembujt rajonal të analizuar nga përkrahësit e bashkëpunimit mjedisor në nivelin e analizës globale, atëherë (shumë e nevojshme) bashkëpunimi për aksionin klimaterik duket me shumë gjasa në mungesën e sigurizimit dhe artikulimi i ndryshimeve klimaterike jashtë kufijve demokratike humbet vëmendjen e saj. Në mënyrë që të marrin në konsideratë të gjitha aspektet e debatit të sigurisë mjedisore, mund të jetë e dobishme të shohim rastin kundër sigurisë klimaterike.

Një mënyrë për ta bërë këtë është të vësh në dukje se ndryshimet klimaterike nuk janë vetëm një shqetësim i sigurisë mjedisore, por edhe një çështje e sigurisë ekonomike. Si një shqetësim i sigurisë ekonomike, ndryshimi i klimës është etiketuar si “siguria e energjisë”. Përkrahësit, sidomos administrata e Presidentit Bush, janë interesuar për furnizimin me energji ndryshe nga pamjaftueshmëria e burimeve (p.sh. burimet e shterueshme të naftës) dhe me tepinë e vazhdueshme të energjisë në një botë më pak tolerante ndaj karbonit. Megjithatë këto çështje lidhen me të kuptuarin se diçka duhet të bëhet kundër ndryshimeve klimaterike, në të vërtetë motivimi për këtë nuk lind nga një interes për mjedisin apo për mirëqenien njerëzore, por ai bazohet në interesat ekonomike.

Për këtë arsye, zgjidhjet e propozuara janë shpesh shumë larg të qenit pro ambientit dhe disa, të tilla si biokarburantet, kundërpeshojnë madje reduktimet në prodhimin e gazit me efektin serë (GES). Ky kundërpeshim mund të jetë i drejtpërdrejtë në atë që “ndryshimet në përmbajtjen karbonike të tokës, apo rezervat karbonike në pyje dhe tokat e pasura në lidhje me prodhimin bioenergjitik, mund të kompensojnë disa ose të gjitha të mirat e GES”⁴⁹, ose i tërthortë, për shembull, nëpërmjet prerjes së pyjeve të për t’i hapur rrugën plantacioneve të biokarburanteve.⁵⁰ Përveç kësaj, është njohur që kërkesa në rritje e Veriut Global për biokarburante ka pasur ndikim të kundërt në sigurinë ushqimore në Jugun Global dhe se ky, i shoqëruar me efekte sociale, rrit gjatat për nxitjen e konfliktit mjedisor.⁵¹

⁴⁹ UN-Energy, “Sustainable Bioenergy a Framework for Decision Makers”.

⁵⁰ Friends of the Earth Netherlands, “Policy, Practice, Pride and Prejudice”, July 2007. http://www.foeeurope.org/publications/2007/Wilmar_Palm_Oil_Environmental_Social_Impact.pdf

⁵¹ *Ibid* and Oxfam Briefing Note “Bio-fuelling poverty: Why the EU renewable-fuel target may be disastrous for poor people”, November 2007. http://www.oxfam.org.uk/resources/policy/tradedownloads/bn_biofuels.pdf?m=234&url=http://www.oxfam.org.uk/resources/policy/trade/downloads/bn_wdr2008.pdf

Në mënyrë të përmbledhur, sigurizimi i ndryshimeve klimaterike është një thikë me dy presa. Nga njëra anë, adresimi i ndryshimeve klimaterike në formën e sigurisë vendos një nga çështjet më të rëndësishme të kohës tonë në krye të axhendës së politikëbërjes dhe në ndërgjegjet e individëve. Nga ana tjetër, ajo mund të ketë efekte negative si mbi mjedisin natyror ashtu dhe për anëtarët më të pa favorizuar të shoqërisë ndërkombëtare.

Përfundime

‘Siguria mjedisore’ ka një mori kuptimesh. Qasjet ndaj sigurisë mjedisore mund të plotësojnë njëra-tjetrën, siç bëjnë tezat mbi sigurinë mjedisore të mbrojtjes dhe konflikti mjedisor, kur kapacitetet e shërbimit informativ të tilla si satelitët spiun përdoren për të siguruar të dhëna mjedisore në zonat me rrezik konflikti. Por ato mund të jenë edhe në kundërshtim me njëra-tjetrën, për shembull, siç janë siguria mjedisore e mbrojtjes me fokusin e saj mbi sigurinë kombëtare dhe gatishmërinë ushtarake dhe qasjes së sigurisë njerëzore ndaj sigurisë mjedisore e përqendruar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe vështirësitë e më të pafavorizuarve.

Lidhja ndërmjet ndryshimeve klimaterike dhe sigurisë u integrua lehtësisht në dikotomitë ekzistuese të debatit të sigurisë mjedisore. Si rezultat, për të gjithë ata të interesuar për sigurinë klimaterike, është e rëndësishme të jenë në dijeni për konotacionet e këtij debati. Nuk është vetëm kjo, sepse literatura mund të përmbajë disa nga përgjigjet e pyetjeve mbi pasojat e ndryshimeve klimaterike, të tilla si, a çojnë pasojat e ndryshimeve klimaterike (thatësisht, emigrim mjedisor, etj.) në konflikt të dhunshëm? Kjo për shkak se literatura tregon gjithashtu se ato që lidhin sigurinë me ndryshimet klimaterike shpesh nënkuptojnë gjëra krejtësisht të ndryshme, madje të kundërta, dhe nga një perspektivë mjedisore siguria klimaterike nuk është gjithmonë një koncept i dëshirueshëm pasi mund të pengojë bashkëpunimin shumë të domosdoshëm ndërmjet vendeve.

Referencat

Ali, A. “A Siachen Peace Park: The Solution to Half-Century of International Conflict”. *Mountain Research and Development* 22, no. 4 (2002): 316-9.

Ali, S.H., ed. *Peace Parks: Conservation and Conflict Resolution*. Cambridge: MIT Press, 2007.

Barnett, J. *The Meaning of Environmental Security*. London: Zed, 2001.

Buzan, B. *People, States and Fear*. 2nd edition. London: Harvester Wheatsheaf, 1991.

Campbell, D. *Writing Security*. 2nd edition. Minneapolis: The University of Minnesota

Press, 1998. Carius, A. *Environmental Peacebuilding: Conditions for Success*, Environmental

Change and Security Program Report 12, Washington DC: Woodrow Wilson Center, 2006-07: 59- 75.

CNA Corporation, *National Security and the Threat of Climate Change*. Alexandria, VA: CNAC, 2007.

Collier, P. and A. Hoeffler. *Greed and Grievance in Civil War*. Centre for the Study of African Economies Working Paper. Oxford: Centre for the Study of African Economies, 2002-01.

Conca, K., A. Carius, and G.D. Dabelko. "Building Peace through Environmental

Cooperation". In *State of the World 2005: A Worldwatch Institute Report on Progress Toward a Sustainable Society*, edited by M. Renner, H. French, and E. Assadourian. New York: W.W. Norton & Company, 2005.

Conca, K. and G.D. Dabelko, eds. *Environmental Peacemaking*. Washington: Woodrow Wilson Center Press, 2002.

Dabelko, G.D. *The Next Steps for Environment, Population, and Security*.

Environmental Change and Security Project Report 10. Washington DC: Woodrow Wilson Center, 2004: 4.

Dabelko, G.D. *Tactical Victories and Strategic Losses: The Evolution of Environmental Security*. Unpublished Doctoral Thesis, Graduate School of the University of Maryland, 2003.

Dabelko, G.D. and P.J. Simmons. "Environment and Security: Core Ideas and US

Government Initiatives". *SAIS Review Winter-Spring (1997)*: 127-46.

Dalby, S. *Environmental Security*. Minneapolis: Minnesota Press, 2002.

Deibert, R.J. *From Deep Black to Green? Military Monitoring of the Environment*,

Environmental Change and Security Program Report no. 2. Washington DC: Woodrow Wilson Center, 1996: 28.

De Soysa, I. "The Resource Curse: Are Civil Wars Driven by Rapacity or Paucity?"

In *Greed & Grievance: Economic Agendas in Civil War*, edited by M. Berdal and D.

Malone: 113-35. Boulder: Lynne Rienner, 2000.

Deudney, D.H. "The Case against Linking Environmental Degradation and National Security". *Millennium: Journal of International Studies* 19, no. 3 (1990): 461-76.

Finger, M. "The military, the nation state and the environment". *The Ecologist* 21, no.5, 1991.

Floyd, R. "Towards a consequentialist evaluation of security: Bringing together the Copenhagen School and the Welsh School of Security Studies". *Review of International Studies* 33, no. 2 (2007): 327-50.

Floyd, R. "Typologies of Securitisation and Desecuritisation: The case of US environmental security 1993 – 2006". Unpublished Doctoral thesis, University of Warwick, 2007.

Gleditsch, N.P. "Armed Conflict and the Environment" In *Environmental Conflict* edited by P.F. Diehl and N.P. Gleditsch: 521-72. Oxford: Westview Press, 2000.

Goodman, S. W. *Military Capabilities and Possible Missions Related to Environmental Security*. Environmental Change and Security Project Report no. 2.

Washington DC: Woodrow Wilson Center, 1996.

Hartman, B. "Population, Environment and Security: A New Trinity". *Environment and Urbanization* 10, no. 2 (October 1998).

Homer-Dixon, T. *Debating Violent Environments*, Environmental Change and

Security Project Report no. 9. Washington DC: Woodrow Wilson Center, 2003: 89-

Homer-Dixon, T. and V. Percival. "The Case of South Africa". In *Environmental Conflict*, edited by P.F. Diehl and N.P. Gleditsch: 13-35. Oxford: Westview Press, 2001.

Homer-Dixon, T. *Environment, Scarcity, and Violence*. Princeton: Princeton University Press, 1999.

Homer-Dixon, T. *The Project on Environment, Population and Security: Key Findings of Research*, Environmental Change and Security Project Report no. 2.

Washington DC: Woodrow Wilson Center, 1996: 45-8.

Homer-Dixon, T. "On the threshold: Environmental changes as causes of acute conflict". *International Security* 16, no. 4 (1991): 76-116.

Kahl, C. *States, Scarcity, and Civil Strife in the Developing World*. Princeton: Princeton University Press, 2006.

Kahl, C. *Review of Peluso and Watts: Violent Environments*, Environmental Change and Security Project Report no. 8. Washington DC: Woodrow Wilson Center, 2002:135-43.

Käkönen, J. "Green security or militarized environment: An introduction" In *Green security or Militarised environment*, edited by Jyrki Käkönen. Aldershot: Dartmouth Publishing Company, 1994

Kaplan, R. "The Coming Anarchy." Reprinted in *The Geopolitics Reader*, edited by

G.O. Tuathail, S. Dalby and P. Routledge. London: Routledge, 1998.

Levy, M. "Is the Environment a National Security Issue?" *International Security* 20, no. 2 (1995): 35-62.

Lomborg, B. *The Skeptical Environmentalist*. Cambridge: Cambridge University Press, 2001.

Matthew, R.A., M. Halle and J. Switzer. *Conserving the Peace: Resources, Livelihoods and Security*. Winnipeg: International Institute for Sustainable Development, 2002.

Myers, N. "Environment and Security". *Foreign Policy* 74 (1989): 23-41.

Peluso, N. L. and M. Watts. *Violent Environments: Responses, Environmental Change and Security Project Report no. 9*. Washington DC: Woodrow Wilson Center, 2003:93-6.

Peluso, N. L. and M. Watts. "Violent Environments". In *Violent Environments*, edited

N. L. Peluso and M. Watts: 3-38. New York: Cornell, 2001.

Schwartz, P. and D. Randall. "An Abrupt Climate Change Scenario and Its

Implications for United States National Security". Washington: Global Business Network, October 2003. http://www.edf.org/documents/3566_AbruptClimateChange.pdf

Simon, J. L. "Pre-debate Statement: Julian Simon". In *Scarcity or Abundance? A debate on the Environment*, edited by N. Myers and J.L. Simon. New York: Norton, 1994.

Simon, J. L. "Closing Statement by Julian Simon". In *Scarcity or Abundance? A debate on the Environment*, edited by N. Myers and J.L. Simon. New York: Norton, 1994.

Tuchman Mathews, J. "Redefining Security". *Foreign Affairs* 68, no. 2 (1989): 162-

Ullman, R. "Redefining Security", *International Security* 8, no. 1 (1983): 129-53.

United Nations, *Human Development Report: Fighting climate change: Human solidarity in a divided world, 2007-08*. New York: UNDP, 2008. http://hdr.undp.org/en/media/hdr_20072008_en_complete.pdf

United Nations, *Human Development Report: New dimensions of human security* 1994. New York: UNDP, 1994. http://hdr.undp.org/en/media/hdr_1994_en.pdf

United Nations-Energy, "Sustainable Bioenergy: A Framework for Decision Makers".

New York, United Nations-Energy, April 2007. <http://esa.un.org/un-energy/index.htm>

UNEP, World Commission on Protected Areas, Global Transboundary Protected

Areas Network, "Cordillera del Cóndor Transboundary ProtectedArea".http://www.tbpa.net/case_01.htm

Walker, G. and D. King. *The Hot Topic: How to tackle global warming and still keep the lights on*. London: Bloomsbury Publishing, 2008.

Westing, A. H. "The Military Sector vis-à-vis the Environment". *Journal of Peace Research* 25, no. 3 (1988): 257-64.

Westing, A. H. "The Environmental Component of Comprehensive Security". *Security Dialogue* 20, no. 2 (1989): 129-34.

Wæver, O. "Peace and Security – Two concepts and their relationship". In *Analysis and Copenhagen Peace Research*, edited by S. Guzzini and D. Jung: 51-65. London: Routledge, 2004.

Wæver, O. "Securitisation: Taking stock of a research programme in Security

Studies". Unpublished manuscript, University of Copenhagen, 2003.

Wæver, O. "Concepts of Security". PhD Thesis, Copenhagen University, 1997.

Wæver, O. "Securitization and Desecuritization". In *On Security*, edited by R.D.

Lipschutz. New York: Columbia University Press, 1995.

ABSTRACTS

Ilir Kalemaj

How far is Albania in fulfilling standards according to environmental acquis and international conventions?

The alignment of the environmental legislative framework with the *acquis communautaire* is a fundamental and integral part of the whole Albanian EU integration process. It constitutes a very sensitive and important issue due to the emergence of specific environmental threats deriving from climate change and from other manmade activities which need to be regulated by law. This study aims to analyse the progress of the alignment of the Albanian environmental legislation with the *acquis communautaire*. It strives to understand the level of incorporation of international and European law in the environmental area into the domestic legislation by giving a detailed analysis on the dynamics of environmental law in Europe and beyond, referring to international treaties and conventions as well as the status quo of the Albanian domestic environmental legislation. The purpose is to address the environmental issue in Albania, to describe the process of environmental *acquis* incorporation and to drive accurate conclusions and possible recommendations on the issue.

Eranda Gjomema

Energy security and environmental protection: two sides of the same coin?

The concept of energy security is strongly related to the environment and security; and environmental policies may often have a negative impact on environment. The energy policies context in the last two decades has changed, therefore, for countries with a weak energy system like Albania, a clear and long term vision in terms of drafting these policies is very important. At the local context, securing stable energy supplies

raises concerns over the ability of Albanian government to overcome energy crisis which can generate into environmental crisis and represent a threat to the citizens. This article aims firstly to analyze the evolution of the energy security concept emphasizing its environmental dimension; and secondly to contribute to the missing debate so that these issues do not remain isolated but take comprehensive dimensions. In other words, the article argues the necessity for an all inclusive inter-institutional dialogue that would make the decision-making process more transparent and help drafting energy policies according to standards of developed countries.

Alexandra Nastase

The role of organized civil society in addressing environmental security

Climate change is part of environmental security that can only be tackled at global level, with contribution of every citizen, government, business and civil society. The gaps between all these actors are decreasing nevertheless, due to the efforts made by the civil society.

In recent years, civil society has been filling the gaps between government, business and individuals. Furthermore NGOs closely collaborate with international organizations such as United Nations, being actively involved in the process of decision making.

We examine the role of civil society in addressing environmental security and especially climate change, which has become a top priority on political and social international agenda. We analyze its methods and instruments, from research, expertise and monitoring to information campaigns and lobby and the influence on public opinion and decision makers.

Understanding the progress made and the role of civil society in encouraging a corroborated effort for real solutions can provide a sustained vision upon what global responsibility really means.

Alizadeh, E. and Pishgahi Fard, Z.
**The Position of Environmental Threats in Creating
Different Models of Regional Integration**

After the Cold War, the concept of international security underwent a modification. Among the most important components of such a transformation, the consolidation of 'environmental security', a topic in international security, can be taken into account. Environmental security deal with threats that are not only the unintentional result of social and economic activities but are very slow in comparison with military threats and thus, the timing horizons for necessary political planning to confront them are significantly extensive. This article also reviews the status and role of the environmental threats in creating regional integration using the content analysis method and surveying them. The results indicate that 33/4% of regional integration was created according to the non-geographical variables yet and environmental threats don't play any roles in the so organizations.

R. Daniel Kelemen and David Vogel
**Trading Places: The Role of the United States and the
European Union in International Environmental Politics**

When environmental issues emerged on the international agenda in the late 1960s and early 1970s, the United States was of one of the strongest and most consistent supporters of international environmental treaties and agreements. The member states of the European Union subsequently ratified all the international treaties created in this period, but U.S. leadership was crucial and European states were laggards in many cases. Since the 1990s, the political dynamics of international environmental policy have shifted, with the European Union emerging as a global environmental leader and the United States repeatedly opposing multilateral environmental agreements. The authors argue that a "regulatory politics" model that synthesizes the effects of domestic politics and international regulatory competition provides the most powerful explanation of why the United States and European Union have "traded places" with respect to their support for international environmental agreements.

Rita Floyd
**The Environmental Security Debate and Its Significance
for Climate Change**

Environmental security emerged as both a concept and a set of policies as a consequence of the end of the Cold War. As a corollary of this, new debates were simultaneously opened up regarding the nature of the threat, the appropriate referent object of security and also the meaning of security itself. There was, at the same time and for the same reason, a need for a new set of “discourses of danger” on the part of the United States security establishment. Environmental security quickly became one of the more prominent issues in this new era of security studies. Although currently sidelined by “the war on terror”, the possible linkage between global warming and security gives renewed fervour to the environmental security debate. The present article both revisits this debate and considers its significance for securitising the climate; that is, making climate change a security issue.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË - 18

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: + 355 4 22 40 116
Tiranë, 2010